



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**“Analizë komparative e sistemeve pensionale, Maqedoni,
Shqipëri dhe Kosovë**

KANDIDATI:

Riza Junuzi

MENTOR:

Doc. Dr. Jonuz Abdullai

Tetovë, 2021

Deklaratë

Unë, Riza Junuzi deklaroj me përgjegjësi të plotë se punimi i titulluar ''Analizë komparative e sistemeve pensionale, Maqedoni, Shqipëri, Kosovë është punim i imi original.

Të njëjtin nuk e kam kopjuar nga studentë tjerë apo nga ndonjë burim tjetër, përveç atyre burimeve dhe literaturave të cituara në referenca.

Nga fillimi deri në përfundim të këtij punimim kam respektuar dhe jam mbështetur në të gjithë rregulloren për hartimin e temës së magistraturës të përcaktuar nga Universiteti i Europes Jug-Lindore.

Me respekt,
Riza Junuzi

VËRTETIM PËR KORREKTURË

Unë, Kujtim Ramadani, korrektor i autorizuar, vërtetoj se ky punim i magjistraturës është korrigjuar nga ana ime dhe të gjitha mangësitë janë eliminuar. Punimi në fjalë i plotëson të gjitha standardet gjuhësore të një punimi shkencor të magjistraturës.

Kujtim Ramadani



Falënderim

Falënderoj Zotin për arritjen e deri tanishme.

Falënderoj familjen për përkrahjen e pakursyer.

Falënderoj Universitetin e Europës Jug-Lindore dhe në veçanti mentorin tim Prof.dr.Jonuz Abdullahu me komisionin në përbërje: Prof.dr.Hasan Jashari dhe Prof.dr.Agron Rrustemi.

PËRMBAJTJA

1. Lista e shkurtesave	4
2. Hyrje	5
3. Lënda e hulumtimit	6
4. Qëllimi i hulumtimit	7
5. Hipoteza.....	8
6. Metodologjia e hulumtimit.....	9
7. Rëndësia e hulumtimit.....	10
8. Struktura e Hulumtimit	11

1. KAPITULLI - KUPTIMI I PENSIONIT DHE LLOJET E PENSIOEVE

1.1. Koncepti i pensionit.....	12
1.2. Sistemi Pensional i RM-së.....	16
1.3. Detyrat dhe funksionet e sistemit pensional.....	18
1.4. Shtylla e parë si formë e mbështetjes së pleqërisë	20
1.5. Skemat pensionale me përfitime të përcaktuara	22
1.6. Shtylla e dytë si formë e mbështetjes së pleqërisë	23
1.7. Skemat pensionale me përfitime të përcaktuara	23
1.8. Skemat pensionale me kontribute të përcaktuara	23
1.9. Skemat pensionale hibride (me origjinë të përzier)	24
1.10. Shtylla e tretë si formë e mbështetjes së pleqërisë	25
1.11. Struktura dhe organizimi i funksionit për menaxhim me rreziqe.....	25
1.12. Për sigurim pensional dhe invalidor	31
1.13. Të drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor janë:	32

2. KAPITULLI II- SISTEMI I PENSIONEVE DHE REFORMAT E TYRE

2.1. Reformat e pensioneve në Evropë	42
2.2. Sistemet e pensioneve në Evropën Perëndimore.....	42
2.3. Reforma e pensioneve në disa shtete	45
2.4. Zhvillimi historik i fondeve investuese tek ne dhe në botë	50
2.5. Nevoja për reforma në sistemin pensional në vendet tranzicion	53
2.6. Reformat pensionale.....	54
2.7. Sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë: reformat dhe struktura e tij	54
2.8. Sistemi pensional Pay As You Go	56
2.9. Shkaqet e reformës së Sistemit Pensional	57
2.10. Reforma e Sistemit Pensional në Kosovë	58
2.11. Reforma e pensioneve në Shqipëri	64

3. KAPITULLI - ANALIZË KOMPARATIVE E SISTEMEVE TË PENSIONEVE

3.1. Sistemi i pensioneve - analizë komparative në Kosovë	72
3.2. Sistemi i pensioneve - analizë komparative në Shqipëri	81
3.3. Përfundimi	86
3.4. Rekomandime	88
3.5. Bibliografia.....	90

LISTA E SHKURTESAVE

RMV-Republika e Maqedonisë së Veriut

FP-Fondi Pensional

BE-Bashkimi Evropian

PV-Pension Vullnetar

PD-Pension i detyrueshëm

KM- Kompania Menaxhuese

PAYG -Skemë Pensioni e mbështetur në parimin Pay- as- you- go

ILO O-Organizata Ndërkombëtare e Punës

OECD - Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

FMN -Fondi Monetar Ndërkombëtar

Abstrakti

Vetë fjala “Pension” nënkupton një rrjedhje të pagesave për sigurimin e të ardhurave që fillojnë në momentin kur individ del në pension derisa të jetojë. Pensioni ka dy qëllime thelbësore: t’ju sigurojë individëve të dalë në pension, kur ata nuk punojnë më, një nivel minimal jetese; dhe së dyti, të ofrojë sigurim, që lidhet me rrezikun ose pasigurinë e jetëgjatësisë së individit.

Në këtë punim të magjistraturës jepet një pasqyrim i reformave të sistemit të pensioneve; këtu njihemi po ashtu me një historik të shkurtër të sistemit të pensioneve në Maqedoni. Rëndësia – Gjendja në të cilën gjendet RMV, sfidat me të cilat ajo përballlet sot dhe do të përballlet në perspektivë e bëjnë shumë të domosdoshëm një rishikim të sistemit të sigurimeve në përgjithësi, e të sistemit të pensioneve në veçanti.

Të gjithë ata të punësuar që shfrytëzojnë stazh të beneficuar të kthehen dhe të shfrytëzojnë pension vetëm nga shtylla e parë. Futja e pensionit social, që do t’i përfshijë qytetarët që kanë të paktën një ditë stazh pune dhe kanë mbushur 65 vjet.

Qëllimi i këtij punimi është të kryejë një analizë të hollësishme të sistemit të pensioneve duke filluar nga reformat që ka pësuar Republika e Maqedonisë së Veriut, e drejta për përfitimin e pensionit të pleqërisë, mosha e daljes në pension, vlerësimin e sistemeve të pensioneve, etj.

Kjo tezë është një përpyetje për të shqyrtuar zhvillimin e sistemit të pensioneve, në veçanti, praktikata, problemet dhe perspektivat e planit të pensioneve në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri; ky studim i analizon çështjet teorike. Qëllimi kryesor i një sistemi pensioni duhet të jetë sigurimi i përfitimeve, të përshtatshme, të përballueshme dhe të qëndrueshme gjatë pleqërisë. Lënda e këtij punimi është “Analiza komparative e sistemeve pensionale në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë”.

Gjithashtu në këtë temë do të mundohem të bëjë krahasimin e sistemit të pensioneve të Kosovës dhe Shqipërisë. Fakti se përballemi me shumë paqartësi lidhur me qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve, nënkupton nevojën për një studim më të thelluar mbi këtë problematikë

Së fundmi, punimi i përmbledh rezultatet dhe jep rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjet kryesore dhe diskutimet e ngritura gjatë kësaj teze.

Hyrje

Sistemi pensional përfaqëson një sfidë të vazhdueshme si për ligjvënësit, rregullatorët, ashtu edhe për shfrytëzuesit e pensioneve. Madje, edhe dilema kyçe e shume shteteve të zhvilluara dhe atyre në tranzicion mbetet pikërisht drejtimi i zhvillimit të sistemit pensional, respektivisht struktura dhe performanca e tij. Sistemi pensional që nga themelimi e deri më sot funksionon në bazë të parimit të solidaritetit mes brezave dhe ka për qëllim krijimin e fondeve për pensionistët dhe ruajtjen e nivelit pothuajse të njëjtë të jetesës.

Sigurimi pensional zakonisht siguron mbrojtjen nga rreziqet: pleqëria, invaliditeti dhe vdekja, përmes një serie pagesash periodike (zakonisht mujore) të personit të siguruar deri në fund të jetës së tij ose të familjes së tij. Ekzistojnë mënyra dhe parime të ndryshme të financimit të pensioneve (faza e akumulimit të mjeteve për pensione) dhe mënyra të ndryshme të përlllogaritjes dhe pagesës së tyre (faza e de-akumulimit të mjeteve për pensione). Mënyrat e financimit dhe pagesës së pensioneve të një shteti varen nga struktura e sistemit të pensioneve të shtetit përkatës, që në fakt varet direkt nga gjendja socio-ekonomike dhe demografike e vendit.

Për rrjedhojë, nevoja për reformimin e sistemeve pensionale në shtetet në tranzicion vijoi si domosdoshmëri për t'u gjetur zgjidhje vështirësive të shumta pensionale, si dhe për t'i krijuar instrumentet dhe strukturat e nevojshme ekonomike që do t'u siguronin pensione të gjithë atyre që derdhin kontribute mbi pagën e punës së tyre.

Reformat pensionale vazhdojnë të paraqesin një kategori dinamike dhe të vazhdueshme që haset jo vetëm në shtetet e zhvilluara (Gjermani, Austri, Itali, Suedi etj.), por edhe në shtetet në tranzicion (Shqipëri, Serbi, Mali Zi, Kosovë, Slloveni, Sllovaki etj.). Republika e Maqedonisë përgjatë periudhës transitore po ashtu pësoi në reforma pensionale dhe të sistemit pensional, me qëllim të konsolidimit të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor dhe sigurimit të mjeteve për pagesat e pensioneve.

Struktura e këtij punimi konsiston në 3 kapituj. Kapitulli i parë i referohet qasjes teorike; në këtë punim të magjistraturës jepet një pasqyrim i reformave të sistemit të pensioneve, këtu prezantohemi po ashtu me një historik të shkurtër të sistemit të pensioneve në Maqedoni. Përpos kësaj, nëpërmjet këtij hulumtimi gjenerohen edhe njohuri shtesë të nevojshme për qeverinë dhe politikë-bërësit, duke mos anashkaluar edhe mundësinë për t'u bërë një burim i mirë

informacioni për të gjithë punonjësit, qoftë të sektorit publik apo privat mbi atë se si do jetë cilësia dhe standardi i jetesës së tyre pas periudhës së daljes në pension.

Kapitulli i dytë u referohet reformave të pensioneve. Në këtë punim të magjistraturës jepet një pasqyrim i reformave të sistemit të pensioneve, këtu prezantohemi po ashtu me një historik të shkurtër të reformave në Maqedoni. Reformat në përgjithësi janë një çështje shumë e rëndësishme për ekonominë e vendeve në të gjithë botën dhe pensionet nuk bëjnë përjashtim po të kemi parasysh që ato luajnë një rol parësor për reduktimin e varfërisë në moshën e pleqërisë. Pensionet si skemë mirëqenieje janë krijuar në fillim për eliminimin e problemeve sociale që vinin si pasojë e moshës. Reforma e pensioneve zgjoi një interesim të madh si në fushën e menaxhimit të fondit të pensioneve ashtu edhe në marrëdhënien midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Kapitulli i tretë i dedikohet analizës komparative të sistemeve pensionale në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë.

Pjesa e fundit e studimit përmban përfundime dhe rekomandime.

1. KUPTIMI I PENSIONIT DHE LLOJET E PENSIONEVE

1.1. Koncepti i pensionit

Në përgjithësi pensioni është një marrëveshje për të bërë të mundur që njerëzit të marrin të ardhura në moshën e pleqërisë, kur ata nuk mund t'i sigurojnë këto të ardhura përmes punësimit. Është një mjet kursimi që lejon akumulimin pa paguar taksa (tax free) të një fondi parash me qëllim përdorimin e tij më vonë si një e ardhur nga pensioni. Pensioni, sipas Williams (1997:2) është tërësia e procedurave të planifikuara dhe një proces ligjor për krijimin e një fondi të sigurt, për të përmbushur detyrimin e mbrojtjes sociale, për të cilin punëdhënësit iu detyrohen punonjësve të tyre në momentin e daljes në pension. Pensionet janë pjesë e sigurimit social të cilët sigurojnë një mbështetje financiare për popullatën e moshuar dhe për ata të cilët janë të paaftë për punë.¹

Sigurimi pensional zakonisht siguron mbrojtjen nga rreziqet: pleqëria, invaliditeti dhe vdekja, përmes një serie pagesash periodike (zakonisht mujore) të personit të siguruar deri në fund të jetës së tij ose të familjes së tij.²

Skemat që financohen nga punëdhënësi, por që e përfitojnë punëmarrësit, zakonisht janë quajtur skema profesionale të pensioneve. Sipas Okotoni dhe Akeredolu (2005:1), qëllimi i pensioneve profesionale është që t'u sigurojë të ardhura të rregullta dhe të qëndrueshme punonjësve pas daljes së tyre në pension. Ata shkruajnë se kjo është një marrëveshje që punëdhënësi bën për të siguruar përfitime për punonjësit kur ata të arrijnë moshën e pensionit. Më tej ata thonë se këto skema janë të financuara vetëm nga punëdhënësit ose nga të dy bashkë si punëdhënësit ashtu edhe punëmarrësit.

Sindikatat e punës, qeveria apo organizata të tjera gjithashtu mund të krijojnë fonde pensionesh. Skemat e pensioneve profesionale janë një formë kompensimi e shtyrë në kohë. Në përgjithësi

¹¹ Vjollca-Sulejmani-Asani –Teformat e pensionit në RM-së Tiranë 2018 fq.6.

² Dr. Bulent Dervishi-Agjensioni për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional Republika e Maqedonisë-Shkup, Prill 2017.fq.8

paraqesin avantazhe si për punëdhënësin ashtu edhe për punëmarrësin, sepse nuk taksohen. Shumë skema pensionesh kanë edhe një tjetër komponent, sigurimi që lidhet me përfitime që mund të kenë persona të tjerë në rast të humbjes së jetës të personit që ka derdhur kontributet, apo përfitime në rast invaliditeti. Pensionet paguhen në intervale të rregullta kohore, në mënyrë që t'i mundësojë individit përballimin e jetesës pas daljes në pension. Kjo pagesë me masë të njëjtë dhe e dhënë periodikisht mundëson individin të maksimizojë të ardhurat nga pensioni.

Maksimizimi i të ardhurave nga pensioni i referohet një strategjie për zgjedhjen e një opsioni pagese në momentin e daljes në pension. Personat që janë afër moshës së pensionit në këtë rast vihen përballë dilemës se, cila është zgjedhja më e mirë. Ata kanë dy mundësi zgjedhjeje. E para që njihet si "single life", që do të thotë masë më e madhe pensioni, por vazhdon për aq kohë sa personi jeton dhe më pas ndërpritet, duke mos i dhënë asnjë mundësi për përfitim bashkëshortit. Mundësia e dytë njihet si "joint life". Në këtë rast masa e përfitimit të pensionit është më e vogël, por bashkëshorti mund të përfitojë një pjesë të tij pas vdekjes së personit që ka të drejtën e pensionit. Këto lloj pensionesh janë të zakonshme në ShBA. Plani i pensionit është një term që përdoret në ShBA, ndërsa në Angli kjo quhet skema e pensioneve. Pavarësisht termit të përdorur pensionet e pleqërisë janë një formë të ardhurash të garantuara për të gjithë jetën, për të eliminuar riskun e jetëgjatësisë (Wikipedia, 2010)³

Në rastin e Republikës së Maqedonisë, objektivi kryesor i reformës pensionale mbetet konsolidimi dhe ruajtja e qëndrueshmërisë financiare të sistemit pensional, që nënkupton aftësinë e sistemit për të gjeneruar një situatë të tillë financiare që do të krijojë mundësinë për t'i kënaqur nevojat e përfituesve të sotëm (pensionistëve aktual), pa mos kompromentuar mundësinë për të kënaqur edhe nevojat e përfituesve të ardhshëm. Mirëpo, se cila do kishte qenë forma e duhur sa i përket përzgjedhjes së planit pensional, ndajmë bindjen se fillimisht duhet shqyrtuar arsyet që impenjuan nevojën për një skemë kontributesh në shoqëritë tradicionale dhe moderne, si dhe këndvështrimin korporativ.⁴

³ M.sc Aida Guxho "Skema e pensioneve në Shqipëri dhe parashikimet aktuariale" Tiranë, 2014 fq.12

⁴ Msc. Shpresa Alija Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e sistemit pensionalët RM-së : qasje analitike krahasimore Tetovë, Maj, 2019. fq.18

1.2. Përse shërbejnë sistemet e pensioneve?

Në shumicën e shoqërive tradicionale, janë familjarët që kujdesen për individët të cilët arrijnë në moshë të vjetër, bëhen të paaftë, apo vuajnë nga humbja e një anëtarit të familjes. Megjithatë, edhe në këto raste, jo të gjithë individët kanë fëmijë që të kujdesen për ta ose komuniteti apo familja janë shumë të varfër për të ofruar kujdesin e duhur, ose e thënë ndryshe nuk janë në gjendje apo të gatshëm për të bërë këtë (Schwartz, 2006). Ashtu sikundër shoqëritë modernizohen dhe njerëzit lëvizin nga komunitetet në të cilat ata janë rritur, lidhjet brenda komunitetit dhe familjes dobësohen dhe mund të lënë të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, pa një rrjet sigurie të përshtatshëm. Individët mund të përpiqen për të shpëtuar nga mungesa e kësaj sigurie sociale në mënyra të ndryshme, si grumbullimi i vlerave monetare, i pasurive të ndryshme apo dhe investimeve për të përfituar prej tyre më vonë. Por, në mungesë të tregjeve të sigurta financiare për personat që realizojnë të ardhura, kursimet shpesh investohen në formën e pasurive të patundshme, të cilat vuajnë në sigurinë e tyre nga luhatjet e çmimeve dhe pasiguria afatgjatë. Për këto arsye, qeveritë shpesh ndërtojnë disa lloje të sistemeve të mbrojtjes sociale në dispozicion të individit.

Edhe në vendet e zhvilluara, në të cilat tregjet e sigurta financiare ekzistojnë, qeveritë shpesh mbështetjen ndaj individit e shohin në pensionet e drejtpërdrejtë ose në planet e pensioneve të ofruara nga fondet ose ofruesit e pensioneve private. Schwartz (2006) rendit dy arsyet me të cituara, të cilat zakonisht shtyjnë qeveritë për t'i përfshirë ato në ngritjen e sistemeve të pensioneve për të parashikuar apo dhe detyruar personat për të marrë pjesë në sistemet e mbrojtjes sociale apo thënë ndryshe në skemat e pensioneve shtetërore apo private. Së pari, punëtorët mund të vuajnë nga "miopi" dhe nuk mendojnë për moshën e vjetër, kur ata janë të rinj dhe të shëndetshëm. Deri në kohën që ata të fillojnë të shqetësohen për moshën e vjetër, kjo mund të jetë tepër vonë për ta që të marrin masa për të siguruar për veten e tyre.

Sipas Feldstein (1987), çdo shoqëri duhet të zgjidhë problemin e mbështetjes për ata individë që bëhet shumë të vjetër për të punuar, por nuk kanë bërë përgatitje adekuate për moshën e tyre të vjetër, duke kursyer kur ata ishin të rinj. Gjetja e zgjidhjeve për këtë problem është, në një masë të madhe, e varur nga kushtet specifike të shoqërive të veçanta, faza e tyre në tranzicionin demografik dhe zhvillimin ekonomik, si dhe nga natyra e institucioneve.

Së dyti, punonjësit mund të bëhen subjekt i “pengesave morale (moral hazard)” sepse konsumojnë më shumë kur janë të rinj, me shpresën se shoqëria do të kujdeset për ta, kur ata janë të vjetër. E vetmja mënyrë që qeveritë mund të kufizojnë shpenzimet sociale të kujdesit për të moshuarit është të kërkojnë pjesëmarrje në një plan pensioni për ata individë të cilët mund ta përballojë atë gjatë periudhës së punës dhe me transfertat e drejtpërdrejta të qeverisë për të ata njerëz që janë shumë të varfër dhe nuk kanë qenë në gjendje për të ruajtur nëpërmjet siguracioneve të detyrueshme gjatë viteve të tyre të punës.⁵

⁵ Landi Gashi “Reformimi i sistemit të pensioneve problemet dhe sfidat” Tiranë Tetor, 2018 fq.17

1.3. SISTEMI PENSIONAL I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë, si pjesë e sistemit financiar, ka për detyrë të sigurojë mjete financiare për pensionet adekuate dhe siguri sociale për pensionistët e tanishëm dhe të ardhshëm. Faktikisht, qëllimi kryesor i sistemit pensional është mobilizimi i mjeteve dhe siguria e pagesës së pensioneve personave të cilat i plotësojnë kushtet ligjore për pension.

Duke i ndjekur praktikat ndërkombëtare, sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë është sistem me shumë shtylla, respektivisht ai është i reformuar dhe dizajnuar në përputhje me nevojat e tanishme të popullatës dhe shoqërisë. Nga aspekti historik, sistemi pensional maqedonas ekziston më shumë se 50 vite dhe gjatë tërë periudhës kohore ai përmirësohet dhe zhvillohet. Sistemi pensional vazhdimisht i nënshtrohet ndryshimeve, kryesisht për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare afatgjate të tij dhe në fillim të shekullit 21 ishin realizuar disa reforma të rëndësishme.

Të gjitha këto reforma parametrike kanë për qëllim racionalizimin e sistemit me financim rrjedhës dhe njëkohësisht përgatitje për plotësim të sistemit të tanishëm financiar me komponentë financiare kapitale, para së gjithash, për sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjate të tij. Reformat përfshijnë: rritja e moshës për pensionim, përlllogaritja e pensioneve në bazë të rrogave nga i gjithë stazhi i punës, indeksimi i pensioneve, zvogëlimi i shkallës për ndërrim dhe ngjashëm.

Me reformat që janë kryer është krijuar sistem pensional me shumë shtylla, i cili siguron mënyrë të kombinuar të financimit dhe diversifikimit të rreziqeve ekonomike dhe demografike. Sistemi pensional në R. e Maqedonisë përbëhet nga tre shtylla, edhe atë:

Shtylla e parë – sistem për financim të tanishëm, sigurim i bazuar në solidaritetin e gjeneratave;

Shtylla e dytë – sigurim i detyrueshëm pensional me financim kapital;

Shtylla e tretë – sigurim vullnetar pensional me financim kapital.⁶

Shtylla e parë ka të bëjë me fondin e detyrueshëm pensional shtetëror i cili funksionon sipas principit të solidaritetit të gjeneratave, në bazë të financimit aktual, që do të thotë se kontributet e obliguesve të tanishëm shfrytëzohen për financimin e kontributeve pensionale për pensionistët e tanishëm. Kjo shtyllë funksionon në bazë të pensioneve të definuara, që do të thotë se shumat e rezervimeve për pensione llogaritet sipas formulës së caktuar paraprakisht. Pensionet e pleqërisë, invaliditetit, familjare dhe minimale paguhen nga shtylla e parë. Të gjithë të punësuarit e tanishëm paguajnë kontribute për sigurim pensional dhe invalidor në shtyllën e parë. Respektivisht, shtylla e parë financohet në bazë të tanishme (PAYG), që do të thotë se me kontributet e të siguruarve të tanishëm paguhen pensionet e pensionistëve të tanishëm.

Në këtë sistem nuk ka kursime ose mjete të investuara në tregun financiar. Respektivisht, çdo gjeneratë e pensionistëve varet nga të punësuarit që do e financojnë pensionimin e tyre, respektivisht sistemi funksionon në bazë të principit të solidaritetit të gjeneratave.

Shtylla e dytë dhe e tretë janë risi në sistem dhe kanë domethënie të vendosjes së financimit të sigurimit kapital pensional në të cilin kryhet kapitalizimi i kontributeve të paguara në emër dhe llogari të anëtarit. Këto dy shtylla funksionojnë në bazë të principit të ashtuquajtur kontribute të definuara, respektivisht tek ata që më parë është e caktuar shkalla e kontributit që paguhet, derisa pensioni caktohet në varshmëri të shumës së akumuluar⁷.

Shtylla e dytë është e financuar në bazë të kapitalizimit. Ajo do të thotë se punëtori paraprakisht akumulon kursime, para pensionimit të vetë, të rritura për fitim të caktuar që e merr si pension. Shtylla e dytë është obligative, meqenëse është financim i tanishëm rrjedhës (pay-as-you-go).

Maqedonia me sistem me një shtyllë dhe financim aktual nuk funksionon në mënyrë efikase në kushte të plakjes së popullatës dhe me përkeqësimin e raportit të popullatës në pension dhe e cila është e aftë për punë. Si shtylla e dytë ashtu edhe shtylla e tretë përbëhet nga llogari private

⁶ Goran Naumov “Menaxhimi me rreziqe tek fondet pensionale në Republikën e Maqedonisë” Prilep, Qershor 2015 fq. 6

⁷ Bari, N. Dajmond, P. “Reformat e Pensionit” Shkup, 2013, fq.48,

kursimi të menaxhuara nga individë. Megjithatë, shtylla e tretë është vullnetare, ndërsa e dyta e detyrueshme. Respektivisht, personat që dëshirojnë të i rrisin kontributet e tyre të pensionimit mbi shkallën e siguruar nga sistemi pensional mund të bëjnë atë përmes shtyllës së tretë, si mekanizëm kursimi.⁸

1.4. Detyrat dhe funksionet e sistemit pensional

Sistemet pensionale kanë rrol të madh në shoqëri, meqenëse duhet të sigurojnë mbrojtje të popullatës dhe stabilitet ekonomik në vend. Detyra kryesore e sistemit pensional është që të mundësojë pagesën e mjeteve të akumuluarra e të punësuarve kur ata t'i plotësojnë kushtet ligjore për fitimin e statusit pensionistë.

Përveç asaj, vetë sistemi pensional duhet ta sigurojë sigurinë financiare gjatë investimit, të i parashikojë lehtësimet për familjet që i kanë humbur përkrahësit – për shkak të vdekjes, të sigurojë valorizim të pensionit, sipas inflacionit dhe rritjes së përgjithshme të standardit jetësor.

Sistemi pensional duhet të sigurojë edhe kursim afatgjatë, para së gjithash, përmes rritjes së vazhdueshme të kursimeve. Këtë mundësi e sigurojnë fondet private detyruese dhe vullnetare. Respektivisht, këto fonde mobilizojnë mjete përmes kontributeve të paguara, ndërsa mandej i investojnë në tregun e kapitalit.

Sistemi financiar është specifik dhe ai patjetër duhet të dizajnohet sipas nevojave të popullatës, respektivisht të mundësojë plotësim të këtyre funksioneve:

- Menaxhim me fondet pensionale (menaxhment);
- Grumbullim, shpërndarje dhe mbikëqyrje e të dhënave dhe kontributeve;
- Menaxhim i mjeteve, d.m.th. realizimi i politikave të investimit, zgjedhje e investimeve, menaxhim me portfolios dhe menaxhim me rreziqe;

⁸ Goran Naumov “Menaxhimi me rreziqe tek fondet pensionale në Republikën e Maqedonisë” Prilep, Qershor 2015 fq 7

- Administrimin, respektivisht mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për anëtarësim, administrimin e llogarive individuale, IT sistemeve, pagesën e pensioneve, kontabilitet, resurse njerëzore etj.;
- Ruajtje e mjeteve, autorizim dhe përputhje (ruajte);
- Ekzekutim i transaksioneve (brokerë);
- Vlerësimi i mjeteve, respektivisht llogaritja e vlerës së neto mjeteve, llogaritje të vlerës së njësisë së kontabilitetit, blerje dhe shitje të njësive;
- Pajtueshmëri me regullativën, njoftim dhe shpallje të të dhënave dhe informacioneve, d.m.th. raporte për rregullatorin, për institucione qeveritare apo individë etj.

Përveç sigurimit të aftësisë së pagimit afatgjatë të sistemit pensional dhe mbrojtjes së popullatës, sistemi pensional stabil (drejtpërdrejtë ose tërthorazi) ndikon pozitivisht mbi zhvillimin e tregut të kapitalit, tregut të fuqisë punëtore dhe mbi financat publike. Respektivisht, efektet pozitive të sistemit pensional stabil bazohen në dy nivele edhe atë:

Efekte për individin;

Efekte për sistemin;

Nga aspekti i individit, sistemi pensional siguron siguri më të madhe, meqenëse financimi i pensioneve kryhet nga dy, respektivisht nga tre burime. Në këtë mënyrë arrihet diversifikimi i rreziqeve të cilët çdo sistem i bartë me vete. Respektivisht, faktori demografik ndikon mbi të gjitha fondet financiare aktuale, ndërsa nuk ka ndikim mbi fondet pensionale me financim kapital. Nga ana tjetër, ligjet ekonomike dhe të tregut kanë ndikim të fortë mbi fondet financiare kapitale. Pikërisht ky sistemi pensional i tre shtyllave siguron amortizim të rreziqeve, me çka arrihet shkallë më e lartë e sigurisë. Nga ana tjetër, zbatimi i llogarive individuale (private) në të cilat akumulohen mjetet dhe pastaj investohen, faktikisht mundësohet sigurimi i mjeteve më të mëdha për pagesit në pleqëri.

Për dallim nga sistemi pensional i pagimit aktual, i cili nuk e nxit kursim tek popullata për shkak të solidaritetit të gjeneratave, sistemi i financuar në bazë kapitale kontribuon për rritjen afatgjatë të kursimeve nacionale dhe paraqet instrument për zhvillim të tregut financiar dhe përforcim të kapaciteteve të investimit që do të rezultojë me ngritje ekonomike.

Në afat të gjatë reforma pensionale duhet të sigurojë rritje të efikasitetit të tregut të punës në Maqedoni, i cili sot karakterizohet me disproporcion të madh mes ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore.⁹

1) Shtylla e parë si formë e mbështetjes së pleqërisë

Shtylla e parë si pjesë e sistemit të sigurimeve sociale sigurohet nga shteti. Ekzistojnë dy lloje të sistemeve të sigurimeve sociale: Beveridge dhe Bizmarck. Në vitin 1942, William Henry Beveridge prezantoi përpara parlamentit britanik sistemin Beveridge që ofronte një mbështetje të mjaftueshme (kujdes bazik), e për njerëzit që dëshironin të gëzonin një standard më të lartë jetësor pritej që të bënin një zgjedhje alternative (Britania e Madhe dhe SHBA kanë sistemin e sigurimit social Beveridge). Kurse, sistemi Bizmarck i krijuar në vitin 1883 nga Otto Von Bizmarck ofroi mbështetje shumë më bujare, në një nivel që nuk kërkonte individët të bënin marrëveshje shtesë (Gjermania, Italia dhe Franca posedojnë sistemin e sigurimit social Bismarck-ian).¹⁰

Pra, sistemi Bizmarck synoi të sigurojë një standard jetësor të balancuar përgjatë gjithë jetës së të sigurvearit, ndërkohë që sistemi Beveridge fokusohet në ofrimin e nivelit ekzistencial për të sigurvearit. Mirëpo, edhe përkundër dallimeve në funksionim, prapëseprapë sistemet në fjalë nuk mund të përjashtojnë njëri tjetrin, ngase të dy sistemet kishin për qëllim reduktimin e varfërisë dhe pabarazisë e të ardhurave, rrjedhimisht nxitjen e kohezionit social dhe përmirësimin e efikasitetit të ekonomisë, si dhe përmirësimin e sigurisë individuale dhe lehtësimin e rreziqeve sociale.

Shumica e skemave pensionale të shtyllës së parë janë jofinanciare, të definuara për nga natyra apo skema me kontribute të përcaktuara imagjinare (të njohura ndryshe si pay-as-you-go). Këto

⁹ Goran Naumov "Menaxhimi me rreziqe tek fondet pensionale në Republikën e Maqedonisë" Prilep, Qershor 2015 13,15.

¹⁰ Msc. Shpresa Alija Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e sistemit pensional RM-së : qasje analitike krahasimore Tetovë, Maj, 2019. fq. 30

të fundit paraqesin skema të pa-financuara ku anëtarët kanë llogari individuale të kontributeve të përcaktuara. Për dallim nga skemat me kontribute të përcaktuara - të financuara (Financial Defined Contribution - FDC), kontributet e anëtarëve të vendosura në llogaritë individuale nuk janë të “financuara“, që do të thotë se mjetet e akumuluar në llogaritë individuale të anëtarëve nuk investohen në instrumentet e tregjeve financiare, por, janë të lidhura me një variabël jofinanciare (me normën e rritjes së Bruto Prodhimit të Brendshëm ose me normën e rritjes së të ardhurave mesatare kombëtare). Kurse, mjetet në skemat me kontribute të përcaktuara të financuara investohen në asetet e tregut financiar. Pra, skema pay-as-you-go me llogari individuale të përcaktuara paraqet një skemë imagjinare me kontribute të përcaktuara (si shembull kemi Suedinë dhe Poloninë të cilët eksperimentuan me skemat jo-financiare imagjinare me kontribute të përcaktuara - Notional Defined Contribution).

Për më tej, është e rëndësishme të potencohen dy dallimet esenciale mes skemës me kontribute të përcaktuara imagjinare dhe asaj me kontribute të përcaktuara të financuara, edhe atë (Holzmann & Palmer, 2006):

□ Së pari, ndryshojnë në lidhje në kontributin e tyre potencial në kursimet kombëtare. Një skemë me kontribute të përcaktuara imagjinare (pay-as-you-go) ofron kontribut të drejtpërdrejt në kursim, përderisa skema me kontribute të përcaktuara të financuara kontribuon në kursimet kombëtare nga faza e ndërtimit deri në maturim, e se efekti i mundshëm në kursimin kombëtar do të varet nga demografia e pjesëmarrësve;¹¹

□ Së dyti, ndryshojnë në raport me normën e sistemit të kthimit. Pjesëmarrësit në skemën e parë fitojnë një normë të brendshme të kthimit që përcaktohet nga faktorët që qëndrojnë pas zhvillimit të ekonomisë, ndërkohë që pjesëmarrësit në skemën e dytë fitojnë një normë të kthimit të përcaktuar nga tregu financiar.

Megjithatë, kjo është një karakteristikë me të cilën identifikohet çdo përfitim i varur nga të ardhurat pa mos anashkaluar faktin se formula e pensioneve në këtë skemë nuk përmban rishpërndarje të brendshme të të ardhurave të sistemit, që do të thotë se kjo skemë duhet të

¹¹ Msc. Shpresa Alija Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e sistemit pensional të RM-së : qasje analitike krahasimore Tetovë, Maj, 2019. fq.31

plotësohet me një formë të skemës së mbështetjes me të ardhura të ulëta. Gjenerimi i skemës me kontribute të përcaktuara imagjinare (pay-as-you-go) përfshin kapitalin imagjinar - joreal, anuitetin, normën e brendshme të kthimit dhe ekuilibrin financiar. Sidoqoftë, ajo që është më thelbësore është fakti se pjesëmarrësit në skemën me kontribute të përcaktuara imagjinare financohen me të hyra ekzogjene, rrjedhimisht nga të ardhurat e përgjithshme tatimore (Holzmann and Palmer, 2006)

2) Shtylla e dytë si formë e mbështetjes së pleqërisë

Shtylla e dytë sigurohet nga kompanitë në formën e skemave ose planeve pensionale profesionale. Fondet e pensioneve profesionale financohen nga fondi i mjeteve pensionale të grumbulluara nga kontributet ose shpërblimet e paguara nga punëdhënësi dhe punonjësi, si dhe nga kthimi i investimeve nga kontributet e investuara.¹² Fodi i parë pensional i detyrueshëm përbëhet nga mjetet e paguara nga kontributet e anëtarëve të tij, pas llogaritje dhe pagesës së kontributeve, dhe fitimit nga investimet.¹³

Pensioni paguhet nga fondi i përlllogaritur sapo anëtari pensionohet, edhe pse ndonjëherë fondi i akumuluar i jepet ndonjë shoqërie të sigurimit jetësor që obligohet t'i siguroj pensionistit një pension jetësor. Për më tej, ekzistojnë tre kategori të anëtarëve të skemës, edhe atë: anëtari aktiv që punon për kompaninë dhe kontribuon në të; anëtari në pension që ka dalë nga kompania dhe tërheq një pension; dhe anëtari i shtyrë, gjegjësisht punëtor i cili nuk punon më për kompaninë dhe nuk ka dalë në pension, por, ka fituar të drejtën e pensionit në bazë të shërbimit të tij të mëparshëm për kompaninë dhe anëtarësinë e tij në skemë, e që kjo e fundit bëhet e pagueshëm kur anëtari i shtyrë tërhiqet nga puna e tij e fundit.¹⁴

Ndonëse shumica e skemave pensionale profesionale janë të financuara, prapëseprapë, llogaritja e përfitimeve të pensionit mund të ndryshojë shumë mes llojeve të ndryshme të skemave. Duke u nisur nga kjo, ekzistojnë tre lloje kryesore të skemës pensionale profesionale, edhe atë: skema pensionale me përfitime të përcaktuara, me kontribute të përcaktuara dhe hibride apo me origjinë të përzier.

¹² Po aty fq.31

¹³ <https://www.kbprvo.com.mk/> 15.09.2020

¹⁴ Msc. Shpresa Alija Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e sistemit pensional të RM-së : qasje analitike krahasimore Tetovë, Maj, 2019. fq.32

1. Skemat pensionale me përfitime të përcaktuara

Skema pensionale me përfitime të përcaktuara siguron një “përfitim të përcaktuar”, një pension të paracaktuar qoftë në monedhë absolute ose si një pjesë e një mase të pagës (përqindje e përcaktuar e pagës përfundimtare ose një mesatare e pagës së viteve të fundit). Po ashtu, përfitimi i përcaktuar dhe njëkohësisht i garantuar mund të shprehet në terma real dhe nominal, ndërkohë që pjesëmarrësit dhe sponsorët (ose të dyja), me kalimin e kohës kontribuojnë në mënyra të ndryshme. Raporti i pensionit ose përfitimi për një masë të pagës njihet si "shkalla e zëvendësimit".

Skema më e thjeshtë me përfitime të përcaktuara ofron një pension fiks që varet nga fitimet ose inflacioni pasues. Sidoqoftë, lloji më i zakonshëm i skemës me përfitime të përcaktuara është skema e pagave përfundimtare ku pensionet e paguara lidhen drejtpërsëdrejti me pagën e fituar në vitin e fundit të punësimit, ose mesatarja e tre ose pesë viteve të punës të anëtarit të skemës. Për rrjedhojë, pensioni aktual paraqet një pjesë të pagës përfundimtare ku fraksioni llogaritet si një produkt i normës aktuale (p.sh. 1%) dhe numrit të viteve të shërbimit (Blake, 2006).

2. Skemat pensionale me kontribute të përcaktuara

Në skemat pensionale me kontribute të përcaktuara kontributet mund të jenë shuma fikse vjetore ose përqindje fikse e pagës dhe se pensioni varet nga vlera e fondit të akumuluar deri në kohën e daljes në pension. Nëse vlera e fondit të akumuluar është e ulët (si rrjedhojë e kontributeve të ulëta ose performancës së dobët të investimeve) pensioni do të jetë i ulët, e nëse vlera e fondit është e lartë atëherë pensionet do të jenë në nivel të lartë. Pra, skemat me kontribute të përcaktuara për dallim nga skemat paraprake nuk tregojnë as suficit dhe as deficit.

Po ashtu, kontributet mund të paguhet nga anëtari, punëdhënësi ose nga një kombinim i të dyjave. Nëse punëdhënësi pajtohet të paguajë një pjesë të kontributeve të anëtarit dhe pasi këto të jenë paguar, punëdhënësi nuk ka asnjë detyrim tjetër ndaj anëtarit në lidhje me pensionin. Kjo e fundit na bën me dije se, skemat me kontribute të përcaktuara karakterizohen me mundësi transferi të mirë duke i bërë ata lehtësisht të transferueshme mes vendeve të punës (Blake, 2006).

Ndonëse karakterizohen me mundësi të mirë transferimi, prapëseprapë pensioni përfundimtar është i pasigurt, ngase varet tërësisht nga performanca e aktiveve të kontributeve të grumbulluara. Prandaj, dy individë me kontribute identike, por portofole të ndryshme të investimeve mund të marrin pensione gjerësisht të ndryshme, ashtu sikurse dy individë me histori kontribute identike mund të marrin pensione gjerësisht të ndryshme, përgjatë periudhave të ndryshme kohore.

Mirëpo, si rrjedhojë e ndryshimeve në ligjet tatimore ose si rezultat i kontributeve ekzistuese të cilat sigurojnë një shkallë zëvendësimi të pamjaftueshëm apo të tepërt është e mundur që kontributet me kalimin e kohës të ndryshojnë. Kjo e fundit, çon më tej në një dallim thelbësor mes dy skemave, respektivisht skemës me përfitime të përcaktuara dhe me kontribute të përcaktuara, sikurse: “Në skemën me përfitime të përcaktuara rezultati përfundimtar është i definuar (përqindja e zëvendësimit të synuar që duhet t’u paguhet pjesëmarrësve është artikuluar nga ofruesi - Fondi për sigurim pensional dhe invalidor), përderisa tek skema me kontribute të përcaktuara rezultati përfundimtar është i ndryshueshëm” (Modigliani & Muralidhar, 2005)

3. Skemat pensionale hibride (me origjinë të përzier)

Skemat hibride kanë përmbajtjen e përbërësve të skemës pensionale me përfitime të përcaktuara dhe me kontribute të përcaktuara. Si shembuj kryesor të skemave pensionale me origjinë të përzier mund të numërojmë: skemën sekueniale hibride, hibride të kombinuar, marrëveshjet mbështetëse, skemën e bilancit të parasë, skemën me përfitime të synuar, etj.

4. Shtylla e tretë si formë e mbështetjes së pleqërisë

Shtylla e tretë njihet ndryshe si një kursim shtesë për daljen në pension që individi zgjedh përpos atyre që ofrohen nga shteti ose kompania për të cilën individi punon. Këto të fundit, zakonisht mbahen në llogaritë e depozitave ose në fondet e përbashkëta të investuara në aksione ose në obligacione. Nëse një individ vendosën të kursej nëpërmjet një skeme formale pensionale, mënyra e kursimit do të jetë pothuajse e njëjtë sikurse tek skema me kontribute të përcaktuara, të njohura ndryshe si skema personale pensionale ose si llogari individuale për dalje në pension. (Blake, 2006).¹⁵

1.5. Struktura dhe organizimi i funksionit për menaxhim me rreziqe

Menaxhimi me shoqëri pensionale është proces me të cilin rregullohen: mënyrat, hapat dhe proceset përmes së cilëve organet për mbikëqyrje dhe menaxhim e përcjellin punën me atë. Qëllimi kryesor i menaxhimit me rreziqe të shoqërisë pensionale është krijimi i besueshmërisë mes organeve për mbikëqyrje dhe menaxhim me anëtarët dhe anëtarët e pensionuar të fondeve pensionale, për shkak të rritjes së efikasitetit dhe zvoglimit të rreziqeve gjatë punës. Anëtarët e bordit mbikëqyrës dhe menaxhues, si dhe personat me përgjegjësi dhe autorizime të posaçme, duhet të kenë kompetenca adekuata menaxheriale dhe operative për shkak të realizimit të obligimeve që u janë dhënë dhe gjithmonë të jenë të informuar për pyetjet të cilat kanë të bëjnë me rrethin e tyre të punës. Prandaj, përbërja dhe mënyra e punës së bordit mbikëqyrës dhe menaxhues duhet të sigurojë shprehje të mendimeve dhe qëndrimeve në mënyrë të pavarur, autonome, të pavarur dhe të lirë të çdo anëtari të këtyre organeve. Bordi menaxhues, gjatë vendosjes duhet të i ketë parasysh të gjitha rreziqet relevante për të cilat posedon informacione të siguruar nga personi përgjegjës për menaxhim me rreziqe, ndërsa të fituara në bazë të analizës objektive. Ky organ duhet të e krijojë politikën interne për identifikim, matje dhe menaxhim me rreziqet gjatë punës së shoqërisë pensionale dhe fondit pensional dhe mbanë përgjegjësi për realizimin e saj. Nga ana tjetër, bordi e miraton politikën për identifikim, matje dhe menaxhim

¹⁵ Msc. Shpresa Alija Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e sistemit pensional të RM-së : qasje analitike krahasimore Tetovë, Maj, 2019. fq.33,35

me rreziqe, e kontrollon realizimin e saj dhe e vlerëson se vallë vendimet e bordit menaxhues për investim të mjeteve të fondit pensional janë në interes të anëtarëve.

Bordi mbikëqyrës dhe menaxhues duhet të sjellin procedura dhe rregulla interne me të cilat qartazi do të kufizohet rroli, autorizimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të tyre. Bordi mbikëqyrës dhe menaxhues obligimet nga kompetencat e tyre i realizojnë konform ligjit dhe procedurave dhe rregullave të shkruara dhe qartazi të definuara. Menaxhimi i përbashkët me fondin duhet të ndërtojë sistem efikas për njoftim dhe komunikim që do të mundësojë përfaqësuesit e çdo të punësuar të tërësisht të i kuptojë dhe të i përmbahen procedurave për përgjegjësi dhe kompetenca. Gjithashtu, bordi mbikëqyrës dhe menaxhues duhet të sigurojë proces efikas për realizim efektiv të kontrollit të brendshëm. Kontrolli i brendshëm efikase nënkupton përcjellje e vazhdueshme, identifikim dhe menaxhim me rreziqet ndaj të cilave është i ekspozuar shoqëria pensionale, ndërsa të cilët mund të ndikojnë negativisht mbi realizimin e qëllimeve të vendosura. Kontrolli i brendshëm realizohet nga ana e bordit mbikëqyrës, bordit menaxhues, personave me kompetenca dhe përgjegjësi të posaçme, personave udhëheqës dhe të punësuarve tjerë në shoqëri.¹⁶

Kontrolli i brendshëm nënkupton përshkrim të qartë dhe të kuptueshëm të detyrave të secilit të punësuar edhe atë në formë të: politikave, procedurave, rregullave të shkruara, softuerëve dhe programeve, delegimit të autorizimeve, detyrave të punës, detyrave të parapara në kontratat menaxheriale dhe të tjera, organizimit etj. Gjithashtu, kontrolli i brendshëm, si proces i vazhdueshëm, duhet të sigurojë siguri të arsyeshme për arritjen e këtyre qëllimeve:

- Mbrojtje të vlerës së mjeteve të shoqërisë pensionale dhe fondit pensional me të cilin menaxhon nga mashtrimi, përfitimi i paautorizuar, përdorimi ose shfaqja e gabuar;
- Grumbullim të më shumë të dhënave në lidhje me rrezikun e fondit pensional me të cilin shoqëria pensionale menaxhon;
- Përpunim të raporteve financiare me kohë dhe të sakta dhe evidencë të kontabilitetit të plotë dhe me kohë dhe të besueshëm për shoqërinë pensionale dhe fondin pensional me të cilin ai menaxhon;

¹⁶ Goran Naumov “Menaxhimi me rreziqe tek fondet pensionale në Republikën e Maqedonisë” Prilep, Qershor 2015 fq 61,

- Rritja të efikasitetit për punën e tërësishme të shoqërisë pensionale, avancimin e efikasitetit të menaxhimit, me theks të veçantë në menaxhimin me rreziqe si dhe pajtueshmëri të ligjeve, akteve, procedurave dhe politikave interne të shoqërisë pensionale.

Kontrolli i brendshëm është i strukturuar në bazë të standardeve të cilat i përfshijnë këto pesë komponentë:

- Qarku kontrollues
- Menaxhimi me rreziqe
- Kontrolli
- Informacione dhe komunikime
- Monitorim dhe evaluim (përcjellje dhe vlerësim).

Bordi menaxhues i shoqërisë pensionale është përgjegjës për funksionimin efikas të procesit së kontrollit të brendshëm, si dhe për përcjelljen e saj të vazhdueshme. Efikasiteti i procesit së kontrollit të brendshëm duhet pandërprerë të vlerësohet dhe avancohet. Ndërsa bordi mbikëqyrës vendos njësi organizative të pavarur dhe të veçantë për kontroll të brendshëm, e cila për punën e saj përgjigjet para bordit.

Kontrolli i brendshëm në shoqërinë pensionale duhet të paraqesë aktivitet të pavarur që të kontribuojë në avancimin e punës së shoqërisë pensionale dhe fondit pensional. Të punësuarit në kontrollin e brendshëm duhet të mundohen për arritjen e qëllimeve të shoqërisë pensionale dhe fondit pensional, duke zbatuar qasje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të proceseve të menaxhimit me rreziqe. Ajo i realizon aktivitetet kontrolluese në bazë të planit të vjetër përgatitur për punë, që duhet të jetë në korrelacion të vazhdueshëm me punën e revizionit të brendshëm.

Revizioni i brendshëm ka për detyrë të kryejë vlerësim objektiv dhe të pavarur të efikasitetit dhe përshtatshmërisë së proceseve për menaxhim me rreziqet dhe kontrollet e vendosura të brendshme. Ky shërbim e vlerëson efikasitetin dhe efektivitetin e proceseve për menaxhim me rreziqe, veçanërisht efikasitetin e mekanizmave kontrollues.

Duke e vlerësuar përshtatshmërisë dhe efektivitetin e mekanizmave kontrollues në lidhje me pengimin dhe minimizimin e rreziqeve, revizioni i brendshëm (në raportet dhe gjetjet e veta revizuese) tregon për rreziqet, respektivisht për ngjarjet e padëshirueshme që mund të aktivizohen si rrjedhojë e mekanizmave kontrolluese joefikase ose jo të përshtatshme.

Rekomandimet e revizionit të brendshëm, që gjinden në raportet revizuese, më shpesh janë të drejtuara për përforcimin e mekanizmave kontrolluese ekzistuese ose vënien e kontrolleve të reja. Për realizimin e rekomandimeve është e obliguar struktura menaxhuese, ndërsa realizimi i tyre, strukturës menaxhuese i jepë siguri se të gjitha aktivitetet e nevojshme janë ndërmarrë për zvogëlimin e rreziqeve.¹⁷

Gjatë përgatitjes së planeve vjetore dhe strategjike, revizioni i brendshëm bashkëpunon me strukturën menaxhuese për verifikimin e sistemeve dhe proceseve që duhet të revidohen me prioritet dhe që janë të lidhur me rreziqe të caktuara. Në atë mënyrë revizioni i brendshëm i jep përkrahje strukturës menaxhuese në proceset e menaxhimit me rreziqe, por struktura menaxhuese është ajo e cila është përgjegjëse për menaxhimin e drejtpërdrejtë me rreziqe. Ky shërbim, gjithashtu, duhet të ketë të drejtë të qasjes tek regjistrat e rreziqeve që të vlerësojë funksionimin e tërësishëm të sistemit për kontroll të brendshëm, ndërsa është mirë që edhe përfaqësues të revizionit të brendshëm të marrin pjesë në mbledhjet e udhëheqësisë më të lartë kur bisedohet në lidhje me menaxhimin e rreziqeve. Ajo siguron garanci se resurset e revizionit të brendshëm janë drejtuar drejt vlerësimit të menaxhimit të rreziqeve më domethënës dhe se ajo u jep përkrahje përpjekjeve të udhëheqësisë për avancimin e fushës së menaxhimit me rreziqe. Revizioni realizohet konform rregulloreve dhe akteve ligjore për kryerje të kontrollit të brendshëm duke i respektuar standardet ndërkombëtare dhe Rregulloren për kodeks etik të revizorëve të brendshëm dhe akteve tjera. Gjatë çdo revizioni të kryer përgatitet dokumentacion që paraqet dosje revizuese, kryesisht për shkak të organizimit më të mirë të revidimit.

¹⁷ Goran Naumov "Menaxhimi me rreziqe tek fondet pensionale në Republikën e Maqedonisë" Prilep, Qershor 2015 fq.63

Revizioni i brendshëm është aktivitet i pavarur për dhënien e këshillës dhe bindjes objektive, ndërsa është e themeluar për dhënien e kontributit për rritje të vlerës dhe përmirësimin e punës së subjektit. Ajo ndihmon që subjekti të i plotësojë qëllimet e veta, duke zbatuar qasje sistematike d.m.th. të disiplinuar për vlerësim dhe përmirësim të efektivitetit gjatë procesit të menaxhimit me rreziqe, kontrollit dhe menaxhimit. Shërbimi për revizion të brendshëm funksionalisht dhe organizativisht është i pavarur dhe i drejtpërdrejtë, respektivisht përgjigjet vetëm se para udhëheqësit të shoqërisë. Pavarësia funksionale e revizionit të brendshëm sigurohet përmes pavarësisë së saj nga pjesët tjera organizative të subjektit gjatë planifikimit të punës, realizimit të revizionit të brendshëm dhe njoftimit. Respektivisht, udhëheqësi i shërbimit për revizion të brendshëm dhe revizorët e brendshëm janë të pavarur gjatë realizimit të revizionit, kështu që duhet të kryejnë atë në mënyrë profesionale, duke zbatuar metodologji të bazuar në standarde ndërkombëtare për revizion të brendshëm, principe dhe rregulla për sjellje të verifikuara në kodeksin etik.¹⁸

Gjatë realizimit të aktiviteteve kontrolluese ky revizion duhet të i vënë theks të veçantë procesit të menaxhimit me rreziqe, respektivisht të i kushtojë vëmendje më të madhe zonave më të rrezikshme të punës. Respektivisht, revizioni i brendshëm i realizon aktivitetet kontrolluese në bazë të planit vjetor të përgatitur për punë gjatë vitit në vijim. Ndërsa, bordi mbikëqyrës, bordi menaxhues, personat me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta, si dhe të punësuarit tjerë duhet të kontribuojnë për rritjen e efikasitetit të revizionit të brendshëm në shoqërinë pensionale përmes:

- Sigurimit të pavarësisë së plotë në realizimin e revizionit të brendshëm;
- Sigurimit të kushteve për objektivitet dhe neutralitet gjatë realizimit të revizionit të brendshëm përmes përjashtimit të mundësisë për angazhim të të punësuarve në këtë njësi organizative që të kryejnë tjera detyra pune;
- Sigurimit të kushteve për qasje tek të gjitha dokumentet dhe informacionet që janë të patjetërsueshme për kryerjen e revizionit të brendshëm dhe mundësimin e komunikimit me secilin të punësuar në shoqërinë pensionale;¹⁹

¹⁸ Goran Naumov “Menaxhimi me rreziqe tek fondet pensionale në Republikën e Maqedonisë” Prilep, Qershor 2015 fq.64

- Realizimit efikas dhe me kohë të rekomandimeve të revizionit të brendshëm;
- Angazhimit të revizorëve të brendshëm për vlerësim e efikasitetit të proceseve dhe kontrollit të brendshëm të sistemeve të menaxhimit me rreziqe.²⁰

Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë

Lëvizjet e pashmangshme demografike gjithandej dëshmuar se reforma pensionale ishte një domosdoshmëri ku secili shtet duhej përshtatur, edhe pse ekonomitë e tranzicionit të brishtë vështirë se e tejkalojnë barrën e trashëguar nga sistemi pensional socialist. Në Republikën e Maqedonisë ndërmarrja e reformës pensionale fillimisht synoi uljen e barrës së Fondit pensional shtetëror, e më vonë edhe optimizimin e saj që do të arrihej në momentin e fillimit të pagesës së pensioneve nga shtylla e dytë.

Mirëpo, si pasojë e reformës pensionale dhe uljes së përqindjes së kontributeve për shtyllën e parë, rrjedhimisht të ndara për shtyllën e dytë barra e Fondit pensional shtetëror u rrit edhe më shumë. Në vitin 2006 kontributet arrinin në 21.2% (me reformën e ndërmarrë pensionale 7.42% ndaheshin për shtyllën e dytë) për t'u zvogëluar deri më 18% në vitin 2011 (parimisht 6.3% për shtyllën e dytë). Kjo e fundit na bën me dije për humbjen financiare që ju shkaktua Fondit pensional shtetëror dhe rritjen e pjesëmarrjes së buxhetit shtetëror për financimin e deficitit fiskal i shkaktuar nga ulja e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor (Атанасовска, 2011).

Mbi të gjitha, reforma pensionale parashikonte që pas akumulimit të mjeteve të nevojshme në shtyllën e dytë të fillohet forma e kombinuar e pagesës së pensioneve, gjegjësisht Fondi pensional shtetëror do të ngarkohej me një të tretën, kurse shtylla e dytë me dy të tretën e mjeteve të nevojshme për pagesën e pensioneve (me këtë do të kompensohej kostoja aktuale për transferimin e mjeteve në shtyllën e dytë). Kurse, sa i përket bazës së të dhënave Fondi për sigurim pensional dhe invalidor është në korrelacion me të gjitha parametrat e sistemit pensional, sikurse: të siguruarit, pensionistët, të ardhurat dhe shpenzimet në lidhje me pensionet, etj.

²⁰ Goran Naumov "Menaxhimi me rreziqe tek fondet pensionale në Republikën e Maqedonisë" Prilep, Qershor 2015 fq.65

Pra, baza e të dhënave të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor është një sublimim i treguesve numerikë të elaboruar më parë për numrin e përgjithshëm të të siguruarve dhe pensionistëve dhe konstatimin se, gjendja financiare e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor varet kryesisht nga lëvizja e raportit të këtyre dy parametrave, respektivisht të punësuarve dhe pensionistëve.²¹

1.6. PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR

Parime themelore. Me këtë ligj rregullohet sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor, përfshirja e të siguruarve, të drejtat që realizohen nga ky sigurim, evidenca amë e të siguruarve dhe shfrytëzuesve të të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, bazat e sigurimit pensional me financim kapital, si dhe kushtet e veçanta në të cilat kategori të veçanta të të siguruarve i realizojnë të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor.

Sistemi i sigurimit pensional dhe invalidor përbëhet nga: - sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratës (në tekstin e mëtutjeshëm: shtylla e parë), - sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital (në tekstin e mëtutjeshëm: shtylla e dytë) dhe - sigurimi vullnetar pensional me financim kapital (në tekstin e mëtutjeshëm: shtylla e tretë). (2) Sigurimi pensional i detyrueshëm dhe vullnetar me financim kapital më afërsisht janë rregulluar me ligje të veçanta.

Me shtyllën e parë pensionale, e mbi parimin e drejtësisë sociale dhe solidaritetit të gjeneratës, realizohen të drejta në rast të pleqërisë, invaliditetit, vdekjes dhe dëmtimit trupor, e me shtyllën e dytë pensionale realizohen të drejta në pajtim me ligjin që e rregullon sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital.

Të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor fitohen dhe realizohen varësisht nga mënyra, kohëzgjatja dhe vëllimi i depozitimit të mjeteve për sigurim pensional dhe invalidor në kushte të përcaktuara me këtë ligj.

²¹ Gazeta e RM-Së Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor Nr.98-Gusht 2012 fq.32

Të drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor janë:

- 1) e drejta e pensionit sipas pleqërisë;
- 2) e drejta e pensionit invalidor;
- 3) e drejta e rehabilitimit profesional dhe të drejta të kompensimeve adekuate me para;
- 4) e drejta e pensionit familjar;
- 5) e drejta e kompensimit me para për dëmtim trupor dhe
- 6) e drejta e shumës më të ulët të pensionit.

Të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor janë të drejta të patjetërsueshme personale materiale dhe nuk mund t'u barten personave tjerë.

Të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor nuk mund të parashkruhen, përveç shumave të arritura, ndërsa të papaguara të pensioneve dhe të pranimeve tjera me para, në rastet e përcaktuara me ligj. Shfrytëzimi i të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor të realizuara sipas këtij ligji mund të ndërpritet ose të kufizohet vetëm në rastet dhe në kushtet e parapara me këtë ligj.

Mjetet e nevojshme për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor i sigurojnë të siguarit dhe punëdhënësit nëpërmjet pagimit të kontributit për sigurim pensional dhe invalidor në pajtim me ligjin.

(Mjetet për sigurim pensional dhe invalidor në rastet dhe në kushtet e përcaktuara me këtë ligj, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Mjetet për sigurimin pensional dhe invalidor dhe të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor sigurohen, përkatësisht realizohen në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: Fondi). Fondi ka cilësi të personit juridik. Selia e Fondit është në Shkup. Veprimtaria e Fondit është me interes publik.²²

Kategori të caktuara të të siguarve, me përjashtim, në raste të përcaktuara me dispozitat e këtij ligji, mund të fitojnë dhe realizojnë të drejtë për pension në kushte të posaçme. Kategoritë e caktuara të të siguarve, kriteret më të afërta për realizimin e të drejtave sipas paragrafit të këtij neni, si dhe sigurimi i mjeteve për ato të drejta rregullohen me këtë ligj.

²² Gazeta e RM-Së Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor Nr.98-Gusht 2012 fq.32

Për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor sigurohet procedurë dyshkallëshe dhe mbrojtje gjyqësore e të drejtave.

➤ **Të siguruarit**

Të siguar me sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor janë:

- 1) punëtorët në marrëdhënie pune dhe persona të barazuar me ta, në pajtim me ligje të posaçme;
- 2) personeli ushtarak dhe civil në pajtim me ligjin;
- 3) bartësit e zgjedhur ose të emëruar të funksionit publik ose funksionit tjetër, nëse për kryerjen e funksionit marrin rrogë, përkatësisht realizojnë kompensim të rrogës për kryerjen e atij funksioni;
- 4) shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët në territorin e Republikës së Maqedonisë janë punësuar në organe të huaja dhe ndërkombëtare, organizata dhe institucione, te përfaqësitë e huaja diplomatike dhe konsullore ose janë në shërbim personal të shtetasve të huaj, nëse me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe;
- 5) shtetasit e Republikës së Maqedonisë të punësuar në vend të huaj, nëse gjatë asaj kohe nuk janë siguar në mënyrë të detyrueshme te bartësi i huaj i sigurimit;
- 6) shtetasit e Republikës së Maqedonisë të punësuar te punëdhënësi i huaj në shtetin në të cilin janë siguar në mënyrë të detyrueshme, por në të cilin të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor, që si të drejta janë përcaktuar me këtë ligj, nuk mund t'i realizojnë ose nuk mund t'i shfrytëzojnë jashtë atij shteti;
- 7) personat e vetëpunësuar – persona fizikë që kryejnë veprimtari të pavarur ekonomike ose shërbim profesional dhe shërbim tjetër intelektual nga i cili realizojnë të ardhura, në pajtim me ligjin;
- 8) personat fizikë që kryejnë veprimtari, e nuk kanë bazë tatimore;
- 9) bujqit individualë – detyrës tatimorë nga të ardhurat e veprimtarisë bujqësore që veprimtarinë bujqësore e kanë profesion të vetëm (bujqit individualë); ²³
- 10) personat e papunësuar që marrin kompensim me para më së shumti deri në mbarimin e 15 viteve të stazhit pensional;
- 11) invalidët e punës gjatë kohës së pritjes për dërgim dhe gjatë kohës së rehabilitimit profesional dhe punësimit adekuat;

²³ Gazeta e RM-Së Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor Nr.98-Gusht 2012 fq.33

12) artistët e pavarur të cilët statusin e tillë kanë fituar sipas kriterëve, në procedurë adekuate dhe akt adekuat të ministrit të Kulturës dhe

13) sportistët profesionalë që kanë lidhur marrëveshje për punësim me klubin sportiv profesional.

I siguruari mund të përfshihet në sigurimin e vazhduar për kohën e kaluar:

1) në përsosje ose arsim profesional në vend ose jashtë vendit me pëlqim të punëdhënësit;

2) në qëndrim në vend të huaj si bashkëshort/e i/e punëtorit që është dërguar në punë në vend të huaj në suazat e bashkëpunimit ndërkombëtar teknik ose arsimor kulturor dhe bashkëpunimit shkencor në përfaqësi diplomatike dhe konsullore;

3) pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës të bashkëshortit/es të personit ushtarak aktiv të zhvendosur për nevojë të shërbimit, më së shumti deri në katër vjet;

4) pas ndërprerjes së të drejtës së kompensimit me para në rast të papunësisë, më së shumti deri në tre vjet dhe

5) gjatë kohës së mungesës së papaguar, më së shumti deri në tre muaj.

Për marrje të sigurimit të vazhduar, i siguruari, përkatësisht personi parashtron kërkesë te njësia rajonale e Shërbimit Profesional të Fondit në afat prej gjashtë muajsh nga ndërprerja e sigurimit të detyrueshëm, ndërsa i siguruari nga paragrafi (1) pika 4 të këtij neni, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji. (3) Me kërkesën nga paragrafi (2) i këtij neni i siguruari dorëzon dëshmi për përcaktimin e rrethanave në bazë të të cilave garantohet siguri i vazhduar.

Detyrimisht sigurohen edhe punëtorët nga neni 11 paragrafi (1) pikat 1 dhe 3 të këtij ligji që janë dërguar në punë në vend të huaj dhe gjatë kohës së punës në vend të huaj, nëse nuk janë të siguruar në mënyrë të detyrueshme sipas rregullave të shtetit në të cilin janë dërguar ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe. (2) Detyrimisht sigurohen edhe shtetasit e Republikës së Maqedonisë që kanë themeluar marrëdhënie pune te punëdhënësi i cili kryen veprimtari në vend të huaj.²⁴

²⁴ Gazeta e RM-Së Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor Nr.98-Gusht 2012 fq.33,34

Detyrimisht sigurohen edhe shtetasit e huaj edhe personat pa shtetësi të cilët në territorin e Republikës së Maqedonisë janë:

- 1) të punësuar te punëdhënësi;
- 2) persona të vetëpunësuar;
- 3) në shërbim të personave të huaj fizikë dhe juridikë, nëse me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe, dhe
- 4) në shërbim të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare, të përfaqësive të huaja diplomatike dhe konsullore, nëse sigurimi i tillë është paraparë me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare.

Me sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të invaliditetit dhe dëmtimit trupor të shkaktuara me lëndim në punë ose sëmundje profesionale të siguruar janë:

- 1) nxënësit dhe studentët kur kryejnë punë praktike gjatë kohës së shkollimit, përkatësisht studimit;
 - 2) personat në vuajtje të dënimit me burg, burgut të të miturve dhe në vuajtje të masës edukative në shtëpi edukative – përmirësuese gjatë kohës së punës së rregullt që e kryejnë gjatë vuajtjes së dënimit, përkatësisht masës;
 - 3) punëtorët shëndetësorë me arsim të lartë të cilët fitojnë përvojë pune për dhënien e provimit profesional dhe
 - 4) personat e papunësuar gjatë kohës së aftësimit profesional dhe rehabilitimit profesional. (2)
- Dispozitat nga paragrafi (1) pika 1 të këtij neni kanë të bëjnë edhe me shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët në pajtim me rregullat në fuqi dërgohen për shkollim në vend të huaj.
- Dispozitat nga paragrafi (1) pika 1 e këtij neni kanë të bëjnë edhe me shtetas të huaj që gjenden për shkollim në Republikën e Maqedonisë nëse shteti, shtetas të të cilit janë ata, po ashtu vepron me shtetasit e Republikës së Maqedonisë nëse me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe.

Me sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të invaliditetit dhe dëmtimit trupor të shkaktuara me lëndim, sigurohen edhe personat te të cilët lëndimi ka ndodhur me pjesëmarrje:

- 1) në aksione për shpëtim ose mbrojtje nga katastrofat ose fatkeqësitë elementare;
- 2) në angazhim në punë të shfrytëzuesve të ndihmës sociale;

- 3) në trajnim me ftesë të organeve të mbrojtjes;
 - 4) në dhënien e ndihmës organeve për punë të brendshme në kryerjen e detyrës së tyre zyrtare;
 - 5) në manifestime kulturore artistike dhe gara, të organizuara nga institucionet kulturore dhe institucionet tjera;
 - 6) në gara në kulturë fizike dhe teknike, të organizuara nga institucionet sportive dhe institucionet tjera;
 - 7) në aktivitet vullnetar në pajtim me ligjin;
 - 8) të sportistit amator në pajtim me ligjin dhe
 - 9) të sportistit profesional që ka lidhur marrëveshje profesionale me klubin sportiv profesional²⁵.
- Fondi më afërsisht e përcakton mënyrën e realizimit të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor të personave nga nenet 15 dhe 16 të këtij ligji.

Marrja dhe përcaktimi i të drejtave Pensioni i pleqërisë Neni 18 I siguruari fiton të drejtë për pension të pleqërisë kur do t'i mbushë 64 vjet (mashkull), përkatësisht 62 vjet (femër) dhe së paku 15 vjet stazh pensional. Zvogëlimi i kufirit të moshës.

Të siguarit të cilit stazhi i sigurimit i llogaritet me kohëzgjatje të shtuar, kufiri i moshës për marrjen e të drejtës së pensionit të pleqërisë zvogëlohet varësisht nga shkalla e rritjes së stazhit, edhe atë për nga një vit:

- 1) për çdo shtatë vjet të kaluara në vende të punës në të cilat 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 13 muaj;
- 2) për çdo gjashtë vjet të kaluara në vende të punës në të cilat 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 14 muaj;
- 3) për çdo pesë vjet të kaluara në vende të punës në të cilat 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 15 muaj;
- 4) për çdo katër vjet të kaluara në vende të punës në të cilat 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 16 muaj;
- 5) për çdo tre vjet të kaluara në vende të punës në të cilat 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 17 muaj dhe
- 6) për çdo tre vjet të kaluara në vende të punës në të cilat 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 18 muaj; (2) Të siguarit të cilit 12 muaj stazh të kaluar në

²⁵ Gazeta e RM-Së Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor Nr.98-Gusht 2012 fq.34

mënyrë efektive në sigurim llogaritet si stazh i sigurimit me kohëzgjatje të rritur në vende të punës dhe punë të cilat kryhen nën tokë dhe i cili gjatë sigurimit ka qenë i caktuar në punë dhe vende të punës me shkallë të ndryshme të rritjes së stazhit të sigurimit, kufiri i moshës për marrjen e të drejtës për pension të pleqërisë zvogëlohet për secilën periudhë të kaluar në vendin e punës me shkallë të caktuar të rritjes së stazhit, proporcionalisht me kohën e kaluar në atë vend pune me zvogëlimin e kufirit të moshës nga paragrafi (1) i këtij neni. Zvogëlimi i përgjithshëm i kufirit të moshës përcaktohet si shumë e zvogëlimeve të përcaktuara proporcionalisht për secilën periudhë individuale.²⁶

²⁶ Gazeta e RM-Së Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor Nr.98-Gusht 2012 fq.34

Tabela 1: Sistemi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë

Mbrojtja sociale	Sigurimet sociale
1. Përfshirja sociale 2. Mbrojtja institucionale 3. Mbrojtja jashtë institucionale 4. E drejta për ndihmë sociale	1. Sigurimi pensionale dhe invalidor në bazë të pagesës aktuale 2. Sigurimi i detyrueshëm pensional me financim të plotë 3. Sigurimi i pleqërisë me kohëzgjatje të shtuar 4. Sigurimi shëndetësor 5. Sigurimi në rast të papunësisë

- Në Republikën e Maqedonisë sistemi i mbrojtjes sociale përfshin mbrojtjen sociale dhe sigurimet sociale me nënkategoritë e tyre (Ministria për punë dhe politikë sociale). Duke u nisur nga kjo konstatojmë se, ekzistojnë dallime thelbësore mes pensionit dhe mbrojtjes sociale, edhe atë në dy aspekte: të administrimit
- të financimit
- Në aspekt të administrimit ndonëse disa programe të mbrojtjes sociale mund të ngjasojnë me pensionet, prapëseprapë, asnjë pjesë e mbrojtjes sociale apo e programeve nuk administrohen si skemë pensionale, që do të thotë se mbrojtja sociale ofron një gamë të gjerë përfitimesh ku njëra prej tyre është edhe përfitimi për të moshuarit, përderisa pensionet paraqesin përfitime të cilat sigurohen nga individ duke paguar në një skemë pensionale, apo që paguhen nga punëdhënësi. Për këtë arsye, shpesh herë njerëzit ngatërrojnë përfitimet e të moshuarve me përfitimet pensionale. Po ashtu, kur jemi tek aspekti administrativ vlen të theksohet se përgjegjësia kryesore për organizimin e mbrojtjes sociale publike dhe ndihmës i takon Ministrisë së punës dhe politikës sociale. Institucionet përgjegjëse për ndihmë sociale dhe për dorëzimin e ndihmës sociale janë: Qendrat për çështje sociale, Institucionet për mbrojtje sociale, si dhe Kopshtet e fëmijëve që vetëm i rregullon dhe mbikëqyr Ministria për punë dhe politikë sociale, ndërkohë që operativisht vetë funksionojnë. Kurse, të drejtat dhe shërbimet për sigurim social realizohen nëpërmjet Fondit për sigurim pensional dhe invalidor (përfshirë edhe kompanitë private të pensioneve), si dhe nëpërmjet Fondit për sigurim shëndetësor dhe Agjencisë së punësimit. Në aspekt të financimit mbrojtja sociale paraqet një program qeveritar, e që përgjatë hartimit të buxhetit ndahet vijë buxhetore e posaçme për financimin e programeve të ofruara nga ana e Ministrisë së punës dhe politikës sociale, ndërkohë që pensionet financohen në mënyra të ndryshme, respektivisht përmes kontributit në një skemë pensionale ose hapjes së një llogarie bankare që shërben si formë kursimi, e që luan rolin e pensionit në moshën e pleqërisë. Pra, programet e mbrojtjes sociale financohen nga buxheti, kurse pensionet financohen nga punëdhënësi apo nga qeveria, e në varësi se si është lidhur marrëveshja bëhet edhe shfrytëzimi i këtyre mjeteve - pensionit (kur individ mbush moshën e daljes në pension apo kur i nevojiten individit) Së fundmi, mund të themi se mbrojtja sociale dhe sigurimet sociale administrohen dhe financohen në mënyra të ndryshme, si dhe dizajnohen për kategori njerëzish të ndryshëm.

Tabela 2: Parametrat e skemës së pensioneve në Republikën e Shqipërisë

Përqindja e kontributit	21.6 % për pensionet
Mosha e daljes në pension	Aktualisht për burrat (Instituti i sigurimeve

	shoqërore): Kategoria I - 62 vjeç me 36 vite kontribute të derdhura; Kategoria II - 65 vjeç me 36 vite kontribute të derdhura; Kategoria III - njëjtë si kategoria e dytë. Aktualisht për gratë: Kategoria I - 57 vjeç me 35 vite kontribute të derdhura; Kategoria II - 60v6m me 36 vite kontribute të derdhura; Kategoria III - njëjtë si kategoria e dytë.
Përqindja e përfitimit	Pensioni bazë + 1 % në vit të mesatares jetike të rivlerësuar sipas rritjes së kontributeve mesatare; 0.5% shtesë në muaj për shtyrjen e moshës së daljes në pension përtej moshës së caktuar për dalje në pension (Nr.7703, ndryshuar me nenin 1, të Ligjit nr. 104/2014, datë 31.07.2014); 0.6 % reduktim në muaj për dalje të parakohshme në pension deri 3 vjeç përpara afatit.
Indeksi i pensioneve pas daljes në pension	Indeksohen sipas legjislacionit në përputhje me ndryshimet e çmimeve.
Pensioni për personat me aftësi të kufizuara	Përfitohet vetëm në rast se ka pasur kontribute për gjysmën e periudhës, gjegjësisht nga mosha 20 vjeçare deri në moshën e paaftësisë; Pensioni i barabartë me shumën bazë + 1 % për çdo vit të mesatares jetike të rivlerësuar sipas rritjes së kontributeve mesatare; Pensioni maksimal është ose dyfishi i shumës bazë ose 80 % i pagës së fundit
Pension për personat të mbetur të ve	E ve në moshën 55 vjeçare, mbajtëse e një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit deri në moshën 8 vjeç dhe e paaftë për punë; I ve në moshën 60 vjeçare, mbajtës i një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit deri në 8 vjeç dhe i paaftë për punë.
Burimi : Legjislacioni shqiptar dhe informacione të marra nga faqja zyrtare ISSH (www.isshe.gov.al)	

Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë mundëson realizimin e sigurimit pensional dhe invalidor konform ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, e në mënyrë të veçantë rregullon të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor për të gjithë siguruesit e Republikës së Maqedonisë. Po ashtu, në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor zbatohet politika e zhvillimit të sigurimit pensional dhe invalidor, ndërmerren masat për përmirësimin e të njëjtit, përcaktohen të drejtat për shfrytëzimin e pensionit minimal dhe maksimal, realizimin e pensionit të pleqërisë, invalidor dhe familjar, kompensimin me të holla në rastet e dëmtimeve fizike dhe të drejtat tjera që dalin nga sigurimi pensional dhe invalidor (Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë). Përgjatë realizimit të së drejtës për shfrytëzim të pensionit të pleqërisë, invalidor dhe atij familjar i siguruari paraprakisht duhet t'i plotësoj kushtet sikurse më poshtë:

Tabela 3: Të drejtat dhe kushtet për shfrytëzim të pensionit të pleqërisë, invalidor dhe familjar

Pension pleqërie
Të drejtat dhe kushtet për shfrytëzim të pensionit të pleqërisë: drejtat dhe kushtet për shfrytëzim të pensionit të pleqërisë: 64 vjeç për meshkuj dhe 62 për femra dhe më së paku 15 vjeç përvojë pune; ▪ përcaktimi i pensionit të pleqërisë: mesatarja mujore e pagave gjatë periudhës së sigurimit; ▪ në bazën pensional nuk përfshihen pagat që i siguruari do t'i realizojë gjatë vitit të realizimit të drejtës për ▪ pension; pensioni i pleqërisë përcaktohet nga baza e pensionit në përqindje, varësisht nga lartësia e përvojës ▪ (stazhit).
Pension invalidor
në rastin kur ndryshimet në gjendjen shëndetësore nuk mund të mënjanoen me shërim, rrjedhimisht ♣ zvogëlim të përhershëm të punës (më tepër se gjysma) krahasuar me të siguarin që posedon arsim të njëjtë dhe që është fizikisht apo psikikisht shëndoshë e mire (në rast se i siguruari është mbi moshën 50 vjeç); në rastin kur ndryshimet shëndetësore nuk mënjanoen me shërim, për rrjedhojë i siguruari humb ♣ përjetësisht të drejtën për punë pa marrë parasysh moshën për punë
Pension familjar
Pensioni familjar fitohet në rast të plotësimit të kushteve të veçanta dhe të përgjithshme. Kushtet e përgjithshme: nëse i siguruari nga i cili merret pensioni familjar në ditë e vdekjes ka mbushur më së paku 5 vite stazh ▪ sigurimi ose 10 vite stazh pensional; nëse i siguruari përmbush kushtet për pension të pleqërisë dhe invaliditetit ose ka qenë shfrytëzues i tyre; nëse vdekja e të siguarit vjen si rrjedhojë e lëndimeve në punë ose sëmundjeve profesionale, atëherë ▪ anëtarët e familjes fitojnë pension familjar varësisht nga stazhi i pensionimit të të siguarit; Kushtet e veçanta: ▪ mundësi për shfrytëzim të pensionit familjar nga e veja (nëse ajo ka mbushur 50 vjeç, ka qenë e pa aftë për punë ose paaftësia është shkaktuar brenda 1 vit pas vdekjes së tij dhe në rast të ketë mbetur me një ose me shumë fëmijë ku me ç'rast e veja i kryen obligimet prindërore); e veja fiton pension familjar edhe në rast se: fëmija e të siguarit lind pas vdekjes së tij; ka ekzistuar ▪ shtatëzania në ditën e vdekjes së tij; si dhe nëse fëmija lind i vdekur ose vdes para 45 ditëve, të vesë i takon pension familjar për skadimin e 45 ditëve pas lindjes; mundësi për shfrytëzim të pensionit familjar nga vejani (të ketë mbushur 55 vite me rastin e vdekjes së ▪ bashkëshortes; deri në vdekjen e saj të ketë qenë i paaftë për punë ose pa aftësi të jetë shkaktuar në afat prej 1 viti deri në ditën e vdekjes së saj; si dhe të ketë mbetur me një ose më shumë fëmijë ku me ç'rast duhet t'i kryen obligimet prindërore); mundësi për shfrytëzim të pensionit familjar nga fëmija deri në moshën 15 vjeç dhe deri në moshën 26 ▪ vjeç nëse shkollohet. Mirëpo, nëse fëmija gjatë periudhës së shfrytëzimit të pensionit mbetet i paaftë për punë atëherë ai përgjithmonë e bartën të drejtën e shfrytëzimit të pensionit familjar; ▪ Mundësi për shfrytëzim të pensionit familjar nga ana e prindit (deri në vdekjen e shfrytëzuesit të pensionit e ëma ka mbushur 45 vjeç dhe i ati 55 vjeç).

➤ **Baza e pensionit**

Pensioni sipas pleqërisë përcaktohet nga mesatarja mujore e rrogave që i siguruari i ka realizuar gjatë kohëzgjatjes së përgjithshme të sigurimit, e më herët nga 1 janari 1970 (në tekstin e mëtejme: baza e pensionit). Për caktimin e bazës së pensionit, krahas mesatares mujore të rrogave merret edhe kompensimi i rrogave, përkatësisht kompensimi me para në rast të papunësisë. Si vit i sigurimit nga i cili merret rroga për përcaktimin e bazës së pensionit merret viti kalendarik në të cilin i siguruari ka realizuar rrogë, përkatësisht kompensim me para së paku për gjashtë muaj stazh të sigurimit. Rroga, përkatësisht kompensimi i rrogës së realizuar në vitin në të cilin i siguruari e realizon të drejtën për pension të pleqërisë nuk merret për përcaktimin e bazës së pensionit.

Të siguarit, përkatësisht personit i cili nuk ka realizuar rrogë, përkatësisht kompensim të rrogës pas janarit 1970, baza e pensionit i përcaktohet varësisht nga ndryshimi i rrogës mesatare të të gjithë të punësuarve në Republikë dhe përgatitja profesionale e të siguarit. Bazën nga paragrafi (1) i këtij neni në fillim të vitit e shpall Fondi.

Për përcaktimin e bazës së pensionit merren rrogat, kompensimet me para, përkatësisht bazat e sigurimit që i siguruari i ka realizuar në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive.

Për përcaktimin e bazës së pensionit merret rroga mesatare mujore që i siguruari e ka realizuar me orar të plotë të punës. Rroga që është realizuar me punë më të gjatë ose më të shkurtër se orari i plotë i punës, llogaritet në shumën mesatare mujore që korrespondon me rrogën për orarin e plotë të punës. Të siguarit i cili në vitin kalendarik ka qenë njëkohësisht në marrëdhënie pune me orar të punës më të shkurtër se orari i plotë i punës te më shumë punëdhënës, rroga i llogaritet ashtu që merren rroga e përgjithshme e realizuar dhe orët e kaluara në punë në marrëdhënie pune të të gjithë punëdhënësit me orar të plotë të punës. Rroga e realizuar me punë më të gjatë se orari i plotë i punës, merret për përcaktimin e bazës së pensionit vetëm nëse puna e tillë është kryer në rastet e parapara me dispozitat e rregullave të përgjithshme nga marrëdhëniet e punës.

Gjatë kohës për të cilën i siguruari ka realizuar kompensim të rrogës për orar të shkurtuar të punës për shkak të kurimit të fëmijës me hendikep më të rëndë, për përcaktimin e bazës së pensionit merret kompensimi me para sipas rregullave që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale.

Gjatë përcaktimit të bazës së pensionit, rroga e përgjithshme e realizuar me punë me orar të plotë, më të shkurtër se orari i plotë dhe më të gjatë se orari i plotë i punës në një vit, reduktohet

me shumë mesatare mujore e cila korrespondon me rrogën për orar të plotë të punës. Shuma që korrespondon me rrogën për orarin e plotë të punës sipas paragrafit të këtij neni, llogaritet ashtu që shuma e përgjithshme e rrogave që merret parasysh për përcaktimin e bazës së pensionit, e të cilat i siguruari i ka pranuar për një vit, pjesëtohet me numrin e orëve që ai i ka kaluar në punë me orar të plotë, më të shkurtër se orari i plotë dhe më të gjatë se orari i plotë i punës, ndërsa shuma e fituar në këtë mënyrë për orë shumëzohet me mesataren mujore të numrit të orëve të orarit të plotë të punës të punëdhënësi në periudhën në të cilën është realizuar rroga. Shuma e fituar e rrogës në këtë mënyrë merret për përcaktimin e bazës së pensionit.

Gjatë kohës së pengimit të përkohshëm nga puna për shkak të sëmundjes dhe lëndimit, përkatësisht gjatë kohës së mungesës nga puna për shkak të shtatzënisë, lindjes dhe amësisë, për përcaktimin e bazës së pensionit merret kompensimi i rrogës. Kompensimi i rrogës nga paragrafi i këtij neni valorizohet me koeficientin me të cilin valorizohen rrogat për atë vit.²⁷

Për përcaktimin e bazës së pensionit të personave të papunësuar që marrin kompensim me para në rast të papunësisë, invalidëve të punës në rast të rehabilitimit profesional, merret kompensimi me para. Kompensimi me para valorizohet me koeficientin me të cilin valorizohen rrogat për atë. Për përcaktimin e bazës së pensionit të të punësuarve invalidë të punës që marrin kompensim me para për punën me orar të shkurtuar të punës ose kompensim me para për shkak të rrogës më të vogël, krahas rrogës së realizuar merret edhe kompensim me para i llogaritur me koeficientin e valorizimit nga viti në të cilin është realizuar ai kompensim.

Për përcaktimin e bazës së pensionit për të siguruarit nga neni 11 paragrafi (1) pika 3 të këtij ligji merret rroga, përkatësisht kompensimi për kryerjen e atij funksioni që ka shërbyer si bazë për pagimin e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor.

Për përcaktimin e bazës së pensionit për të siguruarit nga neni 13 i këtij ligji, merret rroga, përkatësisht baza e sigurimit që ka shërbyer si bazë për pagimin e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor.

Për përcaktimin e bazës së pensionit për të siguruarit nga neni 11 paragrafi (1) pikat 4, 5 dhe 6 dhe neni 14 të këtij ligji, merret baza e sigurimit e cila ka shërbyer si bazë për pagimin e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor.

²⁷ Po aty

të punëtorëve në marrëdhënie pune përcaktohet nga rrogat e realizuara në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive. Baza e pensionit të bujqve individualë përcaktohet nga bazat e sigurimit. Të siguruarve nga neni 11 paragrafi (1) pikat 8 dhe 12 të këtij ligji, baza e pensionit u përcaktohet nga bazat nga të cilat është llogaritur dhe paguar kontribut për sigurim pensional dhe invalidor.

Për përcaktimin e bazës së pensionit merret edhe kompensimi i realizuar në bazë të inovacionit, racionalizimit dhe llojeve tjera krijuese në punë, në pajtim me ligjin dhe marrëveshje kolektive, nëse është paguar kontributi për sigurim pensional dhe invalidor. Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni gjatë përcaktimit të bazës së pensionit merret sikur të jetë realizuar në vitin në të cilin është paguar.

Rrogat nga vitet e mëparshme që merren për përcaktimin e bazës së pensionit, valorizohen me koeficientet e llogaritura në bazë të ndryshimit të rrogave të të gjithë të punësuarve në Republikën e Maqedonisë. Valorizimi i rrogave nga vitet e mëparshme sipas të cilave përcaktohet pensioni, kryhet sipas mesatares së rrogave në vitin e fundit kalendarik që i paraprin vitit në të cilin i siguruari e realizon të drejtën për pension. Koeficientet për valorizimin e rrogave nga vitet e mëparshme përcaktohen çdo vit, vetëm për të gjitha rrogat në bazë të të dhënave statistikore për ndryshimin e rrogave të të gjithë të punësuarve në Republikën e Maqedonisë. Koeficientet për valorizim i shpall Fondi.

Lartësia e pensionit të pleqërisë Neni Pensioni i pleqërisë për të siguruarit nga neni 118 i këtij ligji, përcaktohet nga baza e pensionit në përqindje të caktuara varësisht nga kohëzgjatja e stazhit të pensionit që për secilin vit stazh të pensionit është 0,75% (mashkull), përkatësisht 0,86% (femër) nga baza e pensionit, ndërsa për stazhin e pensionit më të shkurtër se një vit, e së paku gjashtë muaj është 0,375% (mashkull), përkatësisht 0,43% (femër) nga baza e pensionit. (2) Pensioni i pleqërisë për të siguruarit nga neni 119 i këtij ligji përcaktohet nga baza e pensionit në përqindje, që për çdo vit stazhi të plotësuar të pensionit deri në pagimin e tyre të kontributit për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital janë 2,33% (mashkull), përkatësisht 2,60% (femër), e për stazh të pensionit më të shkurtër se një vit, e së paku gjashtë muaj është 1,165% (mashkull), përkatësisht 1,30% (femër), por më së shumti 11,65% (mashkull), përkatësisht 13,00% (femër) nga baza e pensionit. Për çdo vit të mëtutjeshëm stazh pensioni të plotësuar pas pagimit të tyre të kontributit për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim

kapital, pensioni përcaktohet në lartësi prej 0,75% (mashkull), përkatësisht 0,86% (femër), ndërsa për stazh pensional më të shkurtër se një vit, e së paku gjashtë muaj është 0,375% (mashkull), përkatësisht 0,43% (femër) nga baza e pensioni.²⁸

Shuma më e ulët e pensionit të pleqërisë

Shuma më e ulët e pensionit të pleqërisë e realizuar nga sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratës dhe pensionit të realizuar nga sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital, nuk mund të jetë më pak se rroga e përcaktuar mesatare e të gjithë të punësuarve në Republikën e Maqedonisë në vitin 2002, si vijon:

shfrytëzuesit që pensionin e kanë realizuar me stazh pensional mbi 35 vjet (mashkull), përkatësisht mbi 30 vjet (femër), në lartësi prej 41%, - për shfrytëzuesit që pensionin e kanë realizuar me stazh pensional mbi 25 vjet (mashkull), përkatësisht mbi 20 vjet (femër), në lartësi prej 38% dhe - për shfrytëzuesit që pensionin e kanë realizuar me stazh pensional deri në 25 vjet (mashkull), përkatësisht deri në 20 vjet (femër), në lartësi prej 35%. Pensioni nga paragrafi (1) i këtij neni harmonizohet me përqindjen me të cilën harmonizohen pensionet tjera. Neni 36 I siguruari që do të realizojë pjesë të pensionit sipas marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare, e fiton të drejtën për shumë më të ulët të pensionit të pleqërisë nëse shuma e pensionit e përcaktuar sipas këtij ligji dhe pensionit të huaj i llogaritur sipas kursit devizor në fuqi, është më e vogël se shuma nga e cila përcaktohet shuma më e ulët e pensioni.²⁹

²⁸ Gazeta e RM-Së Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor Nr.98-Gusht 2012 fq.34

²⁹ Gazeta e RM-Së Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor Nr.98-Gusht 2012 fq.35

2. KAPITULLI SISTEMI I PENSIONEVE DHE REFORMAT E TYRE

2.1.REFORMAT E PENSIONEVE NË EVROPË

Reformat e pensioneve në vendet e Evropës janë përmbledhur nga Hysa (2013). Tre janë grupet kryesore të reformave të ndërmarra. Grupi i parë është grupi i vendeve që kanë ndërmarrë dhe zbatuar reforma të karakterit të parametrave. Një pjesë të aspekteve të këtyre reformave janë ndërmarrë edhe nga Shqipëria. Në grupin e dytë janë vendet që kanë kryer reforma strukturore në pensione, reforma të rikonfigurimit të skemës ekzistuese dhe/ose zhvendosje drejt sistemeve të përziera me skema të detyrueshme private. Ka vende që kanë rikonceptuar skemat e pensioneve në aspektin e mbrojtjes minimale. Ky lloj mbulimi është aplikuar nga Finlanda, Suedia, Italia, Anglia, Belgjika, Franca Spanja dhe Zvicra. Këto vende përfshihen në grupin e tretë të reformave të zbatuara. Duke konsideruar problemet e sistemit të pensioneve në vendin tonë, një mundësi që duhet të konsiderohet për rastin e Shqipërisë është aspekti i formës së detyrueshme të pensioneve private. Me fjalë të tjera, politikë-bërësit do ishte mirë ta fusin në agjendën e tyre kalimin dhe përqafimit gradual të kalimit edhe në formë të detyrueshme në lëmin privat. Sigurisht kjo nuk është e mundur të realizohet në një kohë kur niveli i pagave është i ulët. Përmbledhja e mëposhtme është marrë nga Hysa (2013), e cila nga ana e saj është mbështetur në kontributin e dhënë nga Xhumari (2010). Kjo e fundit sjell me anë të studimit të saj një vështrim krahasues të ecurisë dhe tendencave të sistemeve të pensionit në harkun kohor të 1990 deri në 2010 për tre vende të Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova³⁰

2.2.Sistemet e pensioneve në Evropën Perëndimore — Një vështrim i përgjithshëm

Dispozitat e hartuara në mbrojtje të pensionistëve ndryshojnë ndjeshëm nga njëri vend tek tjetri, në varësi të mbulesës që ofrohet nga sigurimet shoqërore të vendit dhe sistemet bazë shtetërore të pensioneve. Në disa vende, pensionet financohen gjerësisht me skema të financimit paraprak, ndërsa në vende të tjera financohen kryesisht nga sistemet publike jo të financuara të pensioneve. Gjithashtu, në disa vende, shteti ofron përfitime që shpesh i nënshtrohen testimit të mjeteve, të cilat nuk klasifikohen fare si pensione, ose ofrojnë mbështetje për të moshuarit në formën e të mirave materiale ose shërbimeve, qoftë falas qoftë me çmime të subvencionuara.

³⁰ Doc .M.Sc.Drita Luzo “Drejt qëndrueshmërisë të sistemit të pensioneve nëShqipëri” Tiranë, 2017 fq. 36

Pensionet nganjëherë përshkruhen si sistem me tri shtresa, ku shtresa e parë përfaqëson sistemet universale bazë statusore shtetërore të pensioneve, shtresa e dytë janë pensionet suplementare të punës dhe e treta janë sigurimet personale dhe kursimet e tjera. Këto tri shtresa janë të ndërlidhura dhe ndërvarura nga njëra-tjetra, në atë shkallë sa që do të ishte më e saktë të flisnim për tri segmente të një shtrese të vetme më shumë sesa për tri shtresa të veçanta. Edhe në ato raste kur madhësia relative e secilit sistem është shumë i ndryshëm në vendet e Evropës Perëndimore mund të supozohet që individët në rrethana të ngjashme duan prej tyre të ofrojnë të njëjtat standarde jetese. Ndryshimet në pritshmëritë e individëve për standardet e jetesës si pensionistë në lidhje me të ardhurat e mëparshme duken të jenë shumë më të vogla sesa dallimet në modelin dhe strukturën e sistemeve të Evropës Perëndimore që ofrojnë pagesa pensionesh.

Në të gjitha vendet e Evropës Perëndimore, sistemi i sigurimeve shoqërore ofron një pension bazë statusor që financohet mbi baza vjetore përmes buxhetit nga kontributet ose taksat. Kjo formë financimi, pa financime paraprake njihet ndryshe si sistemi i bazuar në numrin e kontribuuesve ekzistues. Rregullat ndryshojnë, por në shumicën e vendeve, të drejtat e pensioneve përcaktohen mbi bazën e viteve të kontributeve të paguara gjatë punësimit aktiv të një punëmarrësi, si edhe mbi shkallën/shumën e këtyre kontributeve. Në disa vende e drejta për një pension bazë varet nga koha e qëndrimit në atë vend.

Sistemet e pensioneve suplementare të punës ndryshojnë ndjeshëm nga njëri vend tek tjetri. Kontributi i tyre në totalin e sigurimeve shoqërore është i ndryshëm, në varësi të një morie faktorësh, të cilët nuk do të diskutohen këtu. Megjithatë, në përgjithësi, shkalla e këtij kontributi lidhet me nivelin e mbrojtjes statusore, ndonëse përfituesit jo gjithmonë mund të presin që pensioni i tyre i punës të kompensojë boshllëkun e krijuar nga mbrojtja statusore. Për të siguruar dhe ofruar një zëvendësim të përshtatshëm të të ardhurave, sistemet e pensioneve të punës zakonisht janë subjekt i një legjislacioni të favorshëm, në veçanti të një trajtimi më të favorshëm tatimor.³¹

³¹ Skemat e pensionit për shërbimin civil http://www.sigmaweb.org/publications/Alb_SP10_97.pdf
25.05.2020

Nuk ka një vijë të qartë ndarëse midis shtresës së parë dhe asaj të dytë. Në disa vende, si p.sh. në Francë, pensioni suplementar i punës është me gjithë kuptimin e fjalës një pension i shtresës së parë, duke qenë se financohet nga një sistem i bazuar në numrin e kontribuuesve ekzistues, me pjesëmarrje të detyrueshme mbi një nivel të caktuar të të ardhurave. Në Spanjë dhe në Itali nuk ka pothuajse fare sisteme shtesë. Në shumë vende të tjera, si p.sh. në Gjermani, Holandë dhe në Mbretërinë e Bashkuar, sistemet e pensioneve të punës financohen përmes formave të ndryshme të financimit paraprak.

Pjesëmarrja në një sistem pensionesh mund të jetë i ndryshëm në grupet e përzgjedhura që punojnë për një punëdhënës të vetëm deri në të gjithë krahun e punës së një vendi, që mbulohen përmes marrëveshjeve gjithëpërfshirëse kolektive të një sistemi të detyrueshëm pensionesh. Sistemet e pensioneve mund të aplikohen për një sektor të tërë të tregut të punës, si p.sh. për sektorin publik, ose mund të jenë të kufizuara për disa profesione të caktuara. Për sa i takon sektorin publik, ose së paku një pjesë të tij si p.sh. shërbimit civil, mund të mos ketë vetëm sistemin e vet të pensioneve të punës, por gjithashtu mund të jetë i përjashtuar nga sistemi bazë i pensioneve të shtetit. Ky është rasti i Gjermanisë dhe Francës. Në Mbretërinë e Bashkuar, nëpunësit civilë mund të zgjedhin sisteme të tjera, të ndryshme nga sistemi i pensioneve për shërbimin civil.

Natyra afatgjatë e premtimeve për pensionet nënkupton faktin që financat e shëndosha janë bazë për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së sistemit të pensioneve. Praktikisht, ka dy teknika kryesore financimi, të cilat janë skemat me financim paraprak dhe të bazuara në numrin e kontribuuesve ekzistues, 13 si edhe një sërë variacionesh dhe kombinimesh të këtyre teknikave. Dallimi kryesor midis tyre qëndron në periodizimin e kostove të pensionit. Skemat me financim paraprak që zbatohen zakonisht në një vend të caktuar janë ato që zakonisht inkurajohen — ngandonjëherë madje edhe që rekomandohen — apo që shkurajohen nga autoritetet. Sistemi i bazuar në numrin e kontribuuesve ekzistues është tipik për sistemin e pensionit statusor të shtresës së parë, por nuk përdoret shumë shpesh për pensionet e punës të shtresës së dytë.³²

³²Skemat e pensionit për shërbimin civil http://www.sigmaweb.org/publications/Alb_SP10_97.pdf

2.3.Reforma e pensioneve në disa shtete

Mbijetesa e politikave dhe programeve të mirëqenies sociale, në shumë vende të botës, varet nga fakti nëse fluksi hyrës i të ardhurave tatimore në buxhetin e shtetit, nga kontribuuesit aktualë, është i mjaftueshëm për të balancuar fluksin dalës për përfituesit aktualë.

Në një botë të pandryshueshme, parimi i financimit Pay-As-You-Go është më se i qëndrueshëm nëse përcaktohen tarifat e përshtatshme tatimore dhe normat e duhura të përfitimit. Por, për fat të keq, bota nuk është asnjëherë e pandryshueshme dhe efektet e rënieve të ndryshme ekonomike, të papunësisë, të daljes së parakohshme në pension dhe të rritjes së jetëgjatësisë, të rritjes së pritshmërisë në normën e inflacionit dhe të rritjes marramendëse të kostove të shërbimeve, të gjitha këto e kanë minuar këtë sistem duke e çuar atë drejt shkatërrimit total.

Njerëzit e moshuar nga ky tension financiar ndihen veçanërisht të kërcënuar. Duke qenë se ata varen nga pensionet shtetërore si edhe nga kujdesi mjekësor shtetëror, ata konsumojnë shumicën e përfitimeve që vijnë nga ky sistem, ndërsa personat që janë në moshë për punë (dhe punëdhënësit e tyre) kontribuojnë për pjesën më të madhe të të ardhurave të tij. Paratë e tyre siç hyjnë dalin dhe nuk ka asnjë fond rezervë që të garantojë pagimin e kontributeve në të ardhmen. Pra s'ka se si të moshuarit të mos ndihen të shqetësuar.

Një panoramë e tillë çon shumë shpejt në përfundimin se aty ku munden, shumë vende po përpiqen të zëvendësojnë apo të paktën të modifikojnë sistemin e vjetër “PAY AS YOU GO” mbi pensionet dhe sigurimet shoqërore, me të tjera skema të ndërtuara mbi parimet e financimit të llogarive individuale. Kjo skemë po përqafohet jo vetëm nga vendet e ish-Bllokut Lindor por edhe nga ato në Lindjen e Largët dhe në Amerikën Latine, ndërkohë që ekonomitë e zhvilluara si Australia, Zelanda e Re dhe madje dhe vetë Danimarka kanë përparuar në këtë drejtim³³ Në këtë nënkapitull do të analizohen disa shembuj të politikave të pensioneve të zbatuara nga qeveritë e vendeve të zhvilluara dhe të disa vendeve në zhvillim për të trajtuar disa nga problemet fiskale që lindin nga ndryshimet demografike. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe

³³ Skema e pensioneve në Shqipëri dhe parashikimet aktuale
Nga M.Sc. Aida-Guxho-Fakulteti-i-Ekonomise-Tiranë, 2014 fq.25

Anglia janë zgjedhur për të përfaqësuar shtetet e zhvilluara dhe ku plakja e popullsisë është problematike. Hartuesit e politikave në këto vende po tentojnë të zgjidhin problemet në skemën e pensioneve, duke transformuar sistemin PAYG në sistemin e financuar DC. Sistemet e pensioneve në Australi dhe Zelandën e Re janë zgjedhur sepse sistemet e tyre publike të pensioneve aplikojnë në një shkallë të gjerë sistemin DC. Përfitimet janë të paqëndrueshme në varësi të normës së kthimit të investimit të skemave DC. Gjithashtu do të analizohet edhe sistemi suedez i pensioneve, i cili është një sistem alternativ që pretendohet se është financiarisht i qëndrueshëm.

Në SHBA, ideja për të zëvendësuar një pjesë të skemës publike aktuale të pensioneve PAYG, me llogaritë individuale të daljes në pension (proponuar fillimisht nga administrata Klinton) ka shkaktuar një debat të gjerë. Në vitin 2005 gjatë administratës Bush u themelua komisioni për rritjen dhe forcimin e mbrojtjes sociale. Ky komision arriti në përfundimin që duhet të ofrohen llogaritë personale të skemës DC dhe pjesëmarrja në këtë skemë duhet të jetë vullnetare. Kjo do të thotë se nëse një individ do të zgjedhë skemën e re DC, ai duhet të heqë dorë nga disa përfitime që janë pjesë e skemës tradicionale të pensioneve.

Në Mbretërinë e Bashkuar planet e para pensionale kanë qenë skemat profesionale të aplikuara për herë të parë në shekullin e 18-të, shumë kohë para vendeve të tjera evropiane. Skema e parë e pensioneve në sektorin publik është krijuar në vitin 1712 dhe kjo u bë e mundur pas publikimit të tabelave nga një shoqëri për sigurimin e jetës. Skema moderne e pensionit shtetëror filloi në vitin 1948 dhe ka pësuar disa ndryshime në vitin 1975, duke krijuar dy lloje pensionesh. I pari është pensioni bazë minimal dhe bazohet në kontributet që një person derdh në sistemin kombëtar të sigurimeve. Nëse një individ merr të ardhura më shumë se paga minimale e përcaktuar me ligj, atëherë automatikisht kontributet mbi këtë pagë shkojnë për llogari të pensionit të tipit II, që ndryshe quhet llogari pensionale, e cila bazohet në të ardhurat. Në vitin 1980, qeveria konservatore e Thatcherit ndërmori një sërë reformash në fusha si: rritja e moshës së pensionit, ulja e shkallës së zëvendësimit, indeksimin e pensionit shtetëror me indeksin e inflacionit. Sistemi i pensioneve të Anglisë konsiderohej si një nga sistemet më komplekse. Qeveria laburiste e Blair propozoi një skemë të financuar me llogari individuale pensionale.

Australia dhe Zelanda e Re aplikojnë skemën DC të pensioneve. Në Australi pjesëmarrja në sistemin e financuar të pensioneve është e detyrueshme për çdo person që punon. Masa e kontributit është 9 për qind e pagës dhe e drejta për pension lind në moshën 55 ose 60 vjeç. Përveç kësaj qeveria ofron edhe një pension minimal pleqërie (mean-tested pension) për çdo person mbi 65 vjeç, pavarësisht faktit nëse ka derdhur kontribute apo jo. Ky pension është 25 për qind e pagës mesatare të meshkujve për një pensionist dhe 40 për qind për një çift pensionistësh. Kjo do të thotë se, rreth 80 për qind e popullsisë në moshë pensioni përfitojnë këtë pension (mean -tested pension). Kjo skemë pensionesh është relativisht e re. Zelanda e Re ka aplikuar një skemë të financuar DC.

Warren dhe Oguzoglu, (2009:31) në studimin e tyre për reformën e pensioneve paraqitën sistemin e të ardhurave për pensionet në Australi. Ky sistem përbëhet nga:

Të ardhura nga pensioni që paguhen kur individi është në moshë pensioni (65 vjeç për burrat). Mosha e daljes në pension për gratë është duke u rritur dhe do të bëhet 65 vjeç në vitin 2014

Shtylla e dytë e skemës me kontribute të përcaktuara DC është e detyruar për punëdhënësin që të paguajë 9% të pagës së kualifikuar. Punonjësit me paga të ulëta përfitojnë kontribute nga qeveria deri në 1500\$ në vit.

Shtylla e tretë që i takon skemës së kursimeve për pension - përfshin skemën formale, por edhe investime direkte të çdo lloji. Përveç kësaj, programe specifike (bonuse për shtyrjen e pensionit apo sistemi australian i kompensimit të taksave) janë të hartuara në mënyrë të tillë që të inkurajojë individët të punojnë përtej moshës zyrtare të pensionit. Sistemi i mirëqenies sociale (ku bëjnë pjesë: pagesa e invaliditetit, pagesa e papunësisë si edhe pensionet për ushtarakët) është pjesë e sistemit të përgjithshëm si alternativë e mundshme pensioni. Në 30 vitet e fundit shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për personat mbi 50 vjeç, ka pësuar rënie. Raporti shqyrton kontributin që mund të ketë dhënë sistemi i të ardhurave pensionale për këtë situatë.

1) Suedi

Në 1998, Suedia prezantoi një skemë “kontributesh imagjinare”. Pensioni shtetëror financohet nga kontributi për sigurimet shoqërore që arrin deri në 18.5% të të ardhurave nga të cilat 16% shkojnë për skemën publike. Edhe pse pensionet e këtij viti paguheshin nga kontributet e këtij viti, autoritetet e sigurimeve shoqërore hapin një llogari imagjinare për çdo individ në të cilin regjistrohen të gjitha kontributet e tij.

Mbi këtë llogari zbatohet një normë imagjinare interesi që pasqyron rritjen mesatare të të ardhurave. Pensioni i një personi bazohet në totalin e këtyre “të ardhurave imagjinare” dhe në pritshmëritë për jetëgjatësinë dhe rritjen e ardhshme të outputit. Ekziston një rrjet sigurimi për personat që kanë pasur të ardhura të ulëta gjatë jetës së tyre, si dhe për periudhat në të cilat ata janë marrë me rritjen e fëmijëve. 2.5% që ngelet nga kontributet e një personi shkojnë në një skemë kapitalizmi të kursimit qoftë kjo e menaxhuar publikisht apo privatisht. Individi zgjedh nëse do të dalë në pension para kohe apo pasi mbush moshën e daljes në pension, dhe masa e pensionit që do të përfitojë rregullohet në bazë të këtyre preferencave.

Në këtë mënyrë Suedia ka një skemë me kontribut të përcaktuar, i ndërthurur me një rrjet të programesh të mirëqenies. Ai është një sistem i menaxhuar publikisht, por që është në analogji me sistemin konkurrencial në Kili, i cili bazohet në llogari individuale, të menaxhuara privatisht. Secila metodë u jep njerëzve mundësi për të zgjedhur. P.sh., në rast se ata preferojnë një trade-off ndërmjet kohëzgjatjes së pensionit dhe standardeve të jetesës gjatë pleqërisë së tyre, u paraqiten kostot e aktualizuara të këtyre vendimeve.³⁴

³⁴ Skema e pensioneve në Shqipëri dhe parashikimet aktuale
Nga M.Sc. Aida-Guxho-Fakulteti-i-Ekonomise-Tiranë, 2014 fq. 27

2) Itali

Në Itali, reforma e sistemit të pensioneve (1992-1996 dhe 1998-2001) dhe krijimi i hapësirave të nevojshme të krijimit të instituteve private, krijoi përmirësime tejet të ndjeshme, ku para funksionimit të sistemit shumë kolonësh shpenzimet për mbajtjen e sistemit publik tentonin të rriteshin nga 15.2% e GDP në 23.3% të GDP. Sistemi i ri ka sjellë jo vetëm uljen e shpenzimeve nga buxheti shtetëror, por aktualisht, rritja vjetore e të ardhurave të një pensionisti, rezulton në 30%, krahasuar me 14% në sistemin e mëparshëm. Po kështu, rezulton se koha e punës (historiku i kontributeve), me sistemin e ri është në 66.8%, krahasuar me 80% të periudhave më të qëndrueshme me sistemin e vjetër. Këto shifra, krijuan kushtet për parashikimin e një strategjie të re zhvillimi në Itali.

3) Gjermani

Në Gjermani, reforma e sistemit ka nisur në vitin 2000. Kjo reformë prezanton një ndryshim të ndjeshëm që në periudhën afatmesme të realizimit të saj. Në Korrik të vitit³⁵ 2002, statistikatat tregojnë se në Gjermani kanë përfunduar kontrata individuale me institute private rreth 2.5 milion subjekte. Nga vjeshta e po atij viti dhe deri në fundin e vitit 2003, rreth dy të tretat e të punësuarve (afër 18.5 milion individë), kanë kontraktuar për sigurim në kontrata kolektive në fondet e kapitalizuara, të menaxhuara privatisht.

Sipas parashikimeve të qeverisë gjermane, rritja e të ardhurave në kushte pensioni për një individ do të rezultojë në parametrat e synuar, ku nga 71.7% të pagës që përfitohet në pension në vitin 1998, do të arrijë në 86% në vitin 2030 (2% më e lartë se në ShBA, e cila po kalon së fundi në reformën e sistemit pensional). Po kështu, parashikohet të ketë

³⁵ Schmähl, W. Fundamental Decisions for the reform of pension systems. International Social Security Review, 1999, Vol. 52, No. 3, pp. 45–55.

edhe një ulje të ndjeshme të kontributeve, deri në 19.5% të të ardhurave në kohë pune nga 25% që rezultonte mesatarja e kontributit mujor para reformës.³⁶

2.4.ZHVILLIMI HISTORIK I FONDEVE INVESTUESE TEK NE DHE NË BOTË

Fondet investuese në botë ekzistojnë më shumë se 100 vite. Në bursat botërore ato janë lojtarët më serioz dhe 70 deri në 80% të transaksioneve i kryejnë pikërisht ato. Për 100 vite sa edhe ekzistojnë fondet, me të gjitha ngritjet dhe rëniet të bursave botërore, rritja mesatare vjetore arrin 12-15%, që tregon faktin se në kohë afatshkurta dhe afatgjate letrat me vlerë sjellin fitim më të madh. Harxhimet për këtë lloj investimi janë më të vogla. Nëse nevojiten mjete, përmes kërkesës për blerje të aksioneve (një pjese ose të gjitha aksioneve), së bashku me fitimin, DUF më së voni në afat prej 7 ditëve paguhen mjetet, me çka mjetet janë likuide. Mjetet janë trashëguese. Fondet e para investuese në Maqedoni janë paraqitur relativisht vonë dhe në vitin e parë nga puna e tyre vërejtën rezultate negative. Sipas ekspertëve shkaqet për këtë ishin mos-informimi i publikut për mënyrën e funksionimit të tyre, mosinteresimi i investitorëve të huaj si dhe kriza globale financiare e cila tërësisht i ndryshoi rregullat e lojës në këtë sektorë. Themelimi i fondeve investuese është indikatorë kryesorë se tregu është në majë dhe se do të ndodhë rënie.

Fondi i parë i hapur në histori ishte themeluar në vitin 1924, pesë vite para se tregu të pësojë rënie. Fondi i parë i hapur në Izrael ishte formuar në vitin 1979. Pas katër viteve i tërë sistemi bankar në Izrael ishte shembur dhe ishte nacionalizuar. Fondi i parë investues në Maqedoni është formuar 2-3 vite para se të shembet tregu global. Fondet investuese janë si temperatura e lartë në trup të sëmurë. Nga të dy fondet investuese në vend kanë qëndrim se ky biznes ka perspektivë dhe se ende do të zhvillohet, meqenëse tregu maqedonas i kapitalit ende është interesant. Tregues më i mirë i gjendjeve në këtë sektor është ajo që investimi në fondet investuese në Maqedoni është një euro për kokë banori, në Serbi gjashtë euro, në Kroaci 550 euro, ndërsa në Slloveni madje 1.300 euro për kokë banori. Fillimi për fondet investuese nuk është edhe aq i lehtë, nën një për shkak se as bursa e Maqedonisë nuk ka histori të gjatë të ekzistimit (nga viti 1996), por edhe

³⁶ Skema e pensioneve në Shqipëri dhe parashikimet aktuale Nga M.Sc. Aida-Guxho-Fakulteti-i-Ekonomise-Tiranë, 2014 fq.28

për shkak të faktit se në Maqedoni privatizimi nuk ishte realizuar me vauçerë, prandaj nuk ishin themeluar fonde privatizuese në fillimet e viteve të 90-ta,³⁷ kështu që puna e fondeve të para investuese në vend ballafaqohet edhe me problemin e njohurive të pamjaftueshme për rrolin e tyre dhe mundësive të investitorit të thjeshtë.

Fondet investuese janë të njohur mes investuesve meqenëse ata u ofrojnë nevoja dhe qëllime elementare – pensionim të rehatshëm, arsimim më të lartë për fëmijët e tyre dhe standarde të përmirësuara jetësore. Duke marrë parasysh plakjen e popullatës në nivel botërorë, fondet investuese i'u dalin përballë nevojave pensionale dhe e rrisin kursimin privat. Më shumë se 80 milion njerëz investojnë në fondet investuese. Ajo d.m.th. se vetëm në ShBA investohen trilionë dollarë.

Numri i fondeve investuese nga viti 1990 e këndeje është rritur në mënyrë rapide. Numri më i madh i fondeve investuese është në SHBA, Japoni dhe në Francë. Sipas rregullës zhvillimi i fondeve investuese lidhet me vendet që kanë treg të zhvilluar, në të cilat ata përjetuan ekspansionin e tyre. Fondet në ekonomitë tranzitore janë në fazë të ngritjes dhe zhvillimit. Edhe pse shumë nga ata si Çekia, Sllovenia, Polonia, Kroacia të njëjtat i kanë tanimë dhjetëra vite, prapëseprapë ata ende zhvillohen. Analiza e fondeve investuese në vendet në tranzicion bazohet në karakteristikat bazike që i posedojnë fondet vauçerike të këtyre vendeve. Respektivisht, si rezultat i zgjedhjes së modelit të privatizimit masiv me dhënien e vauçerëve qytetarëve, paraqitet nevoja nga institucionet financiare që ndërmjetësojnë mes pronarëve të vauçerëve dhe kompanive që duhej të privatizohen.

Republika e Çekisë ishte lider mes vendeve të bllokut të mëparshëm lindor në procesin e transformimit të ekonomisë së tregut. Ajo ishte arritur me programën pionere të privatizimit masiv i cili filloi në vitin 1992 dhe vazhdoi me valën e re në vitin 1994. Deri në vitin 1996 ishin privatizuar 96% të ndërmarrjeve shtetërore. Zhvillimi i ardhshëm i fondeve investuese në vendet në tranzicion varet nga zhvillimi i tregut të kapitalit, në varësi nga rregullat ligjore.

³⁷ Svetlana Atanasova "Reformat nëistemin pensional dhe fondet pensionale si inivisorë institucional" Shtip, 2011.fq.15

Fondet investuese janë institucione të specializuara të cilat kryejnë grumbullim kolektiv të mjeteve me qëllim të investimit të tyre në letra me vlerë ose instrumente tjera financiare. Rëndësia e fondeve investuese është ajo se ata janë shumë të suksesshëm në grumbullimin e kapitalit relativisht të imët nga persona privat dhe juridik dhe mandej atë kapital e investojnë në portfolio të investimeve të zgjedhura me kujdes, kryesisht në letra me vlerë. Për dallim nga investitorët e vegjël privat, fondet konsiderohen për investitorë të informuar, meqenëse kanë më shumë njohuri për funksionimin e tregjeve financiare dhe të kapitalit dhe për arsye se menaxhohen nga menaxher profesional. Edhe pse në fillim janë paraqitur në ShBA, në 30 vitet e fundit zhvillohen me tempo të përforcuar në shumë vende të zhvilluara të botës. Mungesa e fondeve në një treg në shumë aspekte paraqet anë të dobët në atij tregu. Aspekti më i madh është se nuk ekziston mekanizëm përmes së cilit do të animohen mjetet e lira private nga investuesit e vegjël dhe ato do të investohen në portfolio të caktuar të investimeve. Kur ato mungojnë, investuesit privat shkojnë vet në tregun e kapitalit dhe blejnë aksione, duke mos bërë paraprakisht analizë të mirë. Në investime e tilla të tyre mund të gabojnë dhe të investojnë mjete në shoqëri pa vlerë. Ndjekja e tregut në mënyrë kompetente kushton të holla, ajo nuk është falas. Për ate nevojitet njohuri dhe përkushtim, që kontribuon për zvogëlimin e rrezikut të investimit. Nuk mund çdo individ të investojë aq shumë në dijen e vetë që të mund në mënyrë të arsyeshme të jetë i lirë nga rreziku për investimin e vetë. Nga ana tjetër fondet investuese kanë menaxher profesional të cilët menaxhojnë në mënyrë kompetente me portfolion e investimeve, respektivisht me ato aksione ose prona në të cilat kanë investuar. Ajo nuk do të thotë se edhe ata nuk mund të gabojnë.

Puna e fondeve investuese në vendet në tranzicion është mjaft interesante për kërkuesit dhe studiuesit për shkak të ngjashmërive të tyre në sferën e ekonomisë me kushtet që ekzistojnë në R. e Maqedonisë, fondet investuese në këto vende ishin themeluar gjatë procesit të privatizimit. Pikërisht karakteristikat e fondeve dhe njohurit e veçanta të disa vendeve në tranzicion janë lëndë e hulumtimit e këtij punimi dhe me ndihmën e tyre iu dha përgjigje pyetjes se vallë dhe çfarë fonde investuese do të themeloheshin në Republikën e Maqedonisë. Nënkuptohej se munden dhe historia e industrisë financiare është e mbushur me shembuj të tillë, por prapë kanë të vendosur më shumë mekanizma që të menaxhojnë më suksesshëm me rrezikun prej atyre që i disponojnë investuesit mesatar individual. Domethënë beneficionet janë të mëdha kryesisht për investuesit e

vegjël. Ajo iu jep të drejtë këtyre fondeve investuese që të konfirmojnë se formojnë fond për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Prapëseprapë bëhet fjalë për sektor privat dhe sa do që sektori privat të jetë ose dëshiron që të paraqitet i përgjegjshëm para shoqërisë, në fund të ditës ai patjetër duhet të realizojë profit nga puna për të mbijetuar në afat të gjatë. Prandaj, mbase ata kuptuan se krijohet masë e mjaftueshme kritike për tregti, e ofertës dhe e kërkesës, ndërsa filloi të krijohet edhe masë kritike e dijes, që do e lehtësonte punën profitabile të fondeve investuese të formuara në Maqedoni, respektivisht se ka ardhur koha për atë. Në të njëjtën kohë kishte edhe disa zëra se edhe shteti do të kyçet me shumë të caktuar në kapitalin fillestar në disa fonde, gjë që nuk është keq, meqenëse shteti në atë mënyrë e liron hyrjen e fondeve të reja në treg dhe ndërmerr pjesë të rrezikut.

2.5.NEVOJA PËR REFORMA NË SISTEMIN PENSIONAL NË VENDET NË TRANZICION

Nevoja për reforma në sistemin pensional në vendet në tranzicion imponohet nga më shumë faktorë. Kryesisht ato janë dy: fondet pensionale shtetërore për shkak të rrjedhës së zvogëluar të kontributeve dhe me kohë filluan të bëhen të paaftë për pagesë (paaftësia e sistemeve pensionale shtetërore që me kohë dhe në afat të gjatë të i kryejnë obligimet dhe të punojnë në mënyrë normale), ndërsa nga ana tjetër shtypja demografike nga plakja e popullatës filloi të i vënë në pikëpyetje pensionet e gjeneratave të ardhshme. Nga e prezantuara më lartë mund të përfundohet se arsyet për reforma në sistemin pensional në vendet në tranzicion janë reflektuar nga dy aspekte edhe atë financiar dhe demografik.³⁸

³⁸ Svetlana Atanasova "Reformat në sistemin pensional dhe fondet pensionale si inivisorë institucional" Shtip, 2011.f1 17.

2.6.REFORMAT PENSIONALE

Pyetja thelbësore për stabilitetin e çdo sistemi pensional është siguria sociale e pensionistëve. Sistemet pensionale të shteteve kryesisht janë formuar kur popullata ka qenë më re. Në momentin kur sistemet pensionale filluan të piquen, kushtet e volitshme për financim aktual stagnuan, me ç'rast shkalla e natalitetit filloi të bie ndërsa kualiteti i jetesës vazhdoi me kushtet e përmirësuara për jetë. Me zhvillimin e ekonomisë globale edhe ndryshimet të cilat ndodhën tek disa vende të cilat gjendeshin në tranzicion, u zvogëlua shkalla e punësimit dhe një pjesë e ndërmarrjeve që çoi në rritjen e numrit të papunësuarve. Këto ndryshime demografike si ndryshime financiare shpien te nevoja e reformave te sistemet e deritanishme pensionale.

2.7. Sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë: reformat dhe struktura e tij

Republika e Maqedonisë përgjatë periudhës transitore pësoi në reforma pensionale dhe të sistemit pensional me qëllim të konsolidimit të fondit pensional dhe sigurimit të mjeteve për pagesat e pensioneve. Sistemi pensional si pjesë e sistemit financiar vazhdon të mbetet përgjegjës për sigurimin e mjeteve financiare dhe për sigurimin social për pensionistët ekzistues dhe ato të ardhshëm, rrjedhimisht mobilizimin e mjeteve dhe sigurimin e pensioneve për personat që plotësojnë kushtet ligjore për dalje në pension .

Sipas një këndvështrimi historik sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë ekziston më shumë se 60 vjeç, e që gjatë gjithë kohës përmirësohet dhe zhvillohet duke tentuar të sigurojë një qëndrueshmëri financiare afatgjate. Ndryshimet më të rëndësishme të këtij subjekti janë bërë në vitin 1995 deri 1997, 2000 dhe 2006, ku njëherit me ndryshimin e fundit të ligjit për sigurim pensional dhe invalidor u vendosën bazat e financimit kapital të sigurimit pensional dhe invalidor. Megjithatë, duke ndjekur simetrikisht praktikat ndërkombëtare dhe njëkohësisht në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtarë dhe Bankën Botërore, në vitin 2006 në

Republikën e Maqedonisë u ndërmorën disa reforma të rëndësishme në drejtim të përmirësimit të sistemit pensional.³⁹

Pra, nga 1 janar i vitit 2006 filloi implementimi i sistemit të reformuar pensional ku rolin kryesor vazhdon të luaj Fondi për sigurim pensional dhe invalidor. Ky i fundit, duke ndjekur formën procedurale bën thirrjen, kontrollin dhe kryerjen e transferit të kontributeve për sigurimin pensional dhe invalidor në llogaritë personale të siguruesve (e që janë të siguruar në fondet private pensionale), realizimin e së drejtës për sigurim pensional dhe invalidor dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social (Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë).

Të gjitha reformat e ndërmarra parametrike kishin për qëllim racionalizimin e sistemit financiar ekzistues dhe njëkohësisht përgatitjen e sistemit me financim shtesë, përkatësisht me komponentin e financimit kapital. Reformat në fjalë përfshinë: rritjen e moshës së daljes në pension, llogaritjen e pensioneve të bazuar në pagat (nga gjithsej përvoja), indeksimin e pensioneve, uljen e normës së zëvendësimit dhe krijimin e një sistemi pensional me më shumë shtylla që do të ofrojë mënyrë të kombinuar të financimit dhe diversifikimit të rreziqeve ekonomike dhe demografike. Mbi të gjitha, reformat e ndërmarra duhej të mundësonin

funksionimin e sistemit pensional në tre shtylla, edhe atë: shtylla e parë që përfshinë sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratave, shtylla e dytë sigurimin pensional të detyrueshëm me financim kapital dhe shtylla e tretë sigurimin pensional vullnetar në bazë të kursimit të kapitalizuar individual.

Për rrjedhojë, në shtyllën e parë dhe të dytë nga sistemi i detyrueshëm pensional përfshihen të gjithë të punësuarit në bazë të marrëdhënies së punës dhe kryerjes së veprimtarisë, e në shtyllën e tretë përfshihen të gjithë personat që ndajnë mjete aq sa dëshirojnë - vullnetarët. Sa i përket menaxhimit të mjeteve që grumbullohen nga pagesat e kontributeve, ligjërisht me mjetet që grumbullohen në shtyllën e parë qeverisën Fondi për sigurim pensional dhe invalidor, kurse me mjetet që grumbullohen në dy shtyllat tjera menaxhojnë kompanitë private pensionale (KB

³⁹ Svetlana Atanasova "Reformat nëistemin pensional dhe fondet pensionale si inivisorë institucional" Shtip, 2011.fq.36

Shoqëria e parë pensionale dhe NLB Fondi i ri pensional që në mars të vitit 2018 mori emrin e ri Shoqëria e pensioneve Sava sh. a Shkup23).

Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë mundëson realizimin e sigurimit pensional dhe invalidor konform ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, e në mënyrë të veçantë rregullon të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor për të gjithë siguruesit e Republikës së Maqedonisë. Po ashtu, në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor zbatohet politika e zhvillimit të sigurimit pensional dhe invalidor, ndërmerren masat për përmirësimin e të njëjtit, përcaktohen të drejtat për shfrytëzimin e pensionit minimal dhe maksimal, realizimin e pensionit të pleqërisë, invalidor dhe familjar, kompensimin me të holla në rastet e dëmtimeve fizike dhe të drejtat tjera që dalin nga sigurimi pensional dhe invalidor (Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë)

2.8.SISTEMI PENSIONAL PAGUAJ DHE KALO

Në vendet e Evropës Lindore dhe të Mesme, ku gjatë kohë zotëronte mënyra socialiste e rregullimit të organizimit pensional, kryesisht mbizotëronte qasja sociale. Pagesa e pensioneve ndaj pensionistëve tanimë të regjistruar kryhej në bazë të kontributeve të grumbulluara për sigurim pensional nga personat e punësuar aktiv gjatë momentit. Në këtë mënyrë pagesa e pensioneve quhet princip i solidaritetit të gjeneratave ose i njohur edhe si pay-as-you-go, i cili nënkupton princip të sigurimit pensional solidar. Në socializëm dhe periudhën post-socialiste pensionet e (pleqërisë, invaliditetit dhe familjare) financoheshin sipas principit të njëjtë dhe nga burimi i njëjtë i mjeteve, d.m.th. nga fondet pensionale – invalidore. Koha e pensionimit në vendet e Evropës Lindore dhe të Mesme ishte më e shkurt se në vendet e zhvilluara. Në shumë vende të Evropës Lindore dhe të Mesme kushtet për pension ishin të tilla që çdo mashkull mundej të pensionohej kur të i plotësonte 60 vite dhe me 25 vite stazh pune, ndërsa femra mundej të pensionohej pas plotësimit të 50 viteve, ndërsa ndonjëherë edhe me re varësisht nga numri i fëmijëve. Gjithashtu, ekzistonin mundësi edhe pensionim të parakohshëm, prandaj në këto vende u paraqitën pensionist të ri të cilët mundeshin edhe më tutje të punojnë dhe njëkohësisht të jenë shfrytëzues të pensioneve shtetërore. Sistemet pensionale para reformës ishin krijuar për rialokimin e të ardhurave, ndërsa lidhja mes kontributeve dhe shumave e të

ardhurave pensionale ishte e dobët. Pensionet në këtë periudhë llogariteshin në bazë të përqindjes fikse nga të ardhurat e referencës së punëtorit për minimum vite. Karakteristikat e këtilla japin strukturë relativisht të qëndrueshme të pensioneve, por përsëri ekzistonin më shumë privilegje siç është mosha më e re e pensionimit dhe pensione më të mëdha për ata profesione të cilat shteti i nxiste. Në një numër të madh të vendeve privilegjet që miratoheshin nuk kishin të bëjnë vetëm për punëtorët e profesioneve të rëndësishme strategjike ose të rrezikshme, por edhe për tërë degë të industrisë (udhëheqësia dhe menaxhmenti i xeheve, xehetarët) edhe ata ishin financuar me kontributet që paguheshin në emër të gjithë punëtorëve, me ç'rast paraqitej rialokim negativ.

Adaptimet e lartësisë së pensioneve nuk ishin të mjaftueshme për kyçjen e ndikimeve të inflacionit ose rritjes nominale të rrogave, që çoi deri tek pabarazia e pensionistëve të vjetër dhe të ri, e gjithë ajo si rezultat i asaj që sa më gjatë pensionisti të kishte pranuar pension, aq më shumë pensioni bëhej më joadekuat në lidhje me harxhimet aktuale për jetesë.⁴⁰

2.9.Shkaqet e reformës së Sistemit Pensional

Shkaqet të cilat kishin ndikuar në reformimin e Sistemit Pensional të Kosovës, mund të jenë si në vijim:

Shkaku i parë- i reformës së Sistemit Pensional ishte konteksti politik, i cili kishte rezultuar me integrimin e dhunshëm të Sistemit Pensional të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës brenda Sistemit Pensional të Republikës Socialiste të Serbisë.

Shkaku i dytë- ishte shkëputja e sistemit politik të Kosovës nga RS e Serbisë, bashkë me të edhe shkëputja e Sistemit Pensional të Kosovës nga Sistemi Pensional i RS Serbisë, duke e shmangur përfundimisht praktikën e ish Sistemit Pensional të RSFJ, apo Sistemit Pensional PAYG.

. Shkaku i tretë- ishte disejnimi i modelit të Reformës së Sistemit të ri Pensional të Kosovës, sipas praktikave më të avancuara në vendet e ndryshme të Botës, të bazuar në mendimet dhe në

⁴⁰ Svetlana Atanasova "Reformat nëistemin pensional dhe fondet pensionale si inivisorë institucional" Shtip, 2011.fq 38

rekomandimet e autoriteteve të Bankës Botërore (të ekspertëve të Institutit të Bankës Botërore- “Reformës Pensionale të gjeneratës së dytë”) dhe të OECD.

Shkaku i katërt- është hulumtimi i perspektivës së zgjidhjeve të reja për përmirësimin e mëtejshëm të Sistemit Pensional, në mënyrë që ai të bëhet sa më funksional dhe me i qëndrueshëm.

Shkaku i pestë- është standardizimi i Sistemit Pensional të Kosovës me sistemet pensionale të vendeve të Unionit Evropian, si dhe pjesëmarrja në tregjet e zhvilluara të kapitalit financiar.

Analizimi i shkaqeve në studim, ka për qëllim të ndriçojë faktorët të cilët e kishin kushtëzuar prishjen e Sistemit të vjetër Pensional, dhe të faktorëve të cilët ndikojnë në ndërtimin e qëndrueshmërisë së Sistemit të ri Pensional.⁴¹

2.10. Reforma e Sistemit Pensional në Kosovë

Pas vitit 1999, në Kosovë ishte vendosur Misioni i OKB në bazë të “Rezolutës 1244”, i quajtur UNMIK, si administratë e përkohshme e cila kishte për detyrë, që ndër të tjera të organizojë edhe Sistemin Ekonomik të Kosovës me konceptin e ekonomisë së tregut të lirë.

Kështu që autoritetet kompetente të UNMIK-ut, kishin ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për të organizuar Sistemin Pensional në Kosovë. Sistemi i ri Pensional në Kosovë është ndërtuar mbi bazën e një filozofie sipas Estella James, World Bank dhe Sarah Brooks (Duke University, 2001), e cila është përdorur dhe ka dhënë prova të qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional në vendet e Amerikës Latine, në veçanti në Chile (1981), Zvicër dhe në Mbretërinë e Bashkuar.

Thelbi i kësaj filozofie është ndërtimi i Sistemit Pensional, si entitet financiar i pavarur, jo profitabil, i themeluar për të; rregulluar mbledhjen e kontributeve të kursyera në mënyrë të detyrueshme dhe vullnetare, administruar kontributet pensionale individuale të definuara, ruajtur vlerën e kontributeve pensionale (portfolios individuale), qeverisur në mënyrë të matur, të kujdesshme, të besueshme dhe profesionale, menaxhuar me kujdes dhe përgjegjësi të lartë profesionale deri në momentin e përfitimit të pensioneve nga pronarët e portfoliove- përfituesit pensional. Bartës i disajnit të Sistemit të ri Pensional në Kosovë ishte USAID sipas John

⁴¹ Reforma e Sistemit pensional në Kosovë dhe qëndrueshmëria e tij Nexhmedin Shaqiri-Tirane, Nentor 2018.fq.73

Gubbels, David Snelbecker, Lena Zezulin (2007), i cili kishte angazhuar këshilltarët e vet. profesional (Barents Group), gjithashtu në këtë proces ishin përfshirë edhe përfaqësuesit (ekspertët) e UNMIK-ut, të UE, FMN, Bankës Botërore, DFID dhe të ILO.

Para se të vendoset se si të organizohet Sistemi Pensional, janë zhvilluar shumë konsultime, debate rreth modelit, reformës së organizimit të Sistemit Pensional, i cili do të zhvillohej në Kosovë, ashtu që pas shqyrtimit të shumë varianteve rreth modelimit të Sistemit të ri Pensionale ishte konkluduar se:

Së pari- ishte e nevojshme të bëhet një prerje e plotë financiare e Sistemit të vjetër Pensional të Kosovës, e cila në vitin 2001 kishte rezultuar me gjendje boshe (zero), sepse Fondi i vjetër Pensional ishte transferuar në Serbi dhe ishte përvetësuar nga ana e Serbisë, ndërsa gjendja e transferuar e mjeteve financiare të Fondit Pensional të Kosovës ishte e pa njohur për autoritetet e UNMIK dhe të IPVQ të Kosovës. Kështu që Serbia i kishte bllokuar këto mjete financiare, nuk përgjigjej dhe nuk bashkëpunonte me UNMIK-un për ta kthyer këtë fond në Kosovë. Andaj, kjo çështje kishte mbetur si variant i ardhshëm për negociim të autoriteteve politike të Kosovës me autoritetet përkatëse të Serbisë, në mënyrë që të ktheheshin ato mjete financiare në Kosovë dhe shfrytëzimi i tyre të destinohej për shpagimin e pensioneve për përfituesit e merituar

Së dyti- pikënisja e implementimit të Sistemit të ri Pensional në Kosovë të fillon në vitin 2002 nga niveli zero, por që do të ndihmohet fillimisht nga USAID, për të mbuluar shpenzimet themelore të ngritjes së kapaciteteve të Fondeve të reja Pensionale në Kosovë

Se treti, Sistemi i reformuar Pensional ishte disajnuar në bazë të praktikave më të mira, të cilat ishin aplikuar në vendet e ndryshme të Botës.

Reforma e sistemit pensional (John Gubbels, David Snelbecker, Lena Zezulin , 2007)⁷³ në Kosovë fillon në vitin 2002, me aplikimin e Rregullores mbi Pensionet Nr 2001/35 nga UNIMK-u, e cila e ka definuar Sistemin Pensional si Sistem Pensional me model Shumë Shtyllor (të kompozuar nga tri shtylla⁷⁴), si dhe e ka ridefinuar moshën për të fituar të drejtën për pension (65 vjet moshë për të dy gjinitë).⁴²

⁴² Reforma e Sistemit pensional në Kosovë dhe qëndrueshmëria e tij Nexhmedin Shaqiri-Tirane, Nentor 2018.fq.76

2.11. Qëllimet themelore të reformës së Sistemit Pensional në Kosovë

Plakja e popullsisë është bërë një nga faktorët që përcakton planet dhe nismat e reformës së pensioneve. Raporti i Parlamentit të BE-së konstaton se "... ndryshimi demografik po ushtron presion mbi elementet e sistemeve të pensioneve të financuara nga shteti (PAYG), të cilat janë pjesë thelbësore e çdo sistemi pensionesh në BE "⁴³

Qëllimet themelore të Reformës së Sistemit Pensional në Kosovë janë:

Shmangja e sistemit të vjetër PYGO

Krijimi i Sistemit të ri të Pensioneve, që e mbulon të gjithë popullsinë e moshuar të Kosovës e cila mbush moshën 65 vjet jetë.

Adresimi i nevojave e të gjitha grupeve të popullsisë

Zgjidhja e përgjithshme që e bën sistemin pensional të qëndrueshëm në periudha afatgjate (që përballon ndryshimet demografike dhe që nxit zhvillimin e ekonomisë së tregut

Adresimi i shqetësimeve etnike (lejohen të marrin pjesë në Sistemin e ri Pensional të gjithë qytetarët rezident të Kosovës në kushte të barabarta, pavarësisht nga përkatësia etnike).

Promovimi i zhvillimit ekonomik (promovimi i investimeve të kursimeve të kontributeve pensionale, promovimi i zhvillimit të tregut të punës, promovimi i zhvillimit të tregjeve të kapitalit financiar)

Parandalimi i rënies së papritur të të Ardhurave të Individëve pas daljes në pension, në ish Sistemin e vjetër të Pensioneve të KSA Kosovës

Parandalimi i rënies të papritur të të Ardhurave të Individëve dhe varfërimit të vazhdueshëm të tyre, pas mbushjes së moshës (65 vjeçare) së pleqërisë

⁴³ Selatin Kllokoqi- Pensionet në Kosovë – Sfidat dhe mundësitë, Prishtinë 2018.fq.5

1) Baza konceptuale e ndërtimit të Sistemit Pensional në Kosovë

Baza konceptuale e ndërtimit të Sistemit Pensional në Kosovë, mbështetet në;

braktisjen përfundimtare të sistemit të vjetër pensional PAYG,

- ndërtimin e Sistemit të ri Pensional (modeli shumë shtyllor),
- standardizimin e modelit të Sistemit të ri Pensional, krahasuar me modelet më të avancuara në vendet e OECD,
- respektimin e të drejtave themelore universale të njeriut,
- mbulueshmërinë e barabartë të gjithë banorëve rezident të Kosovës, duke adresuar plotësimin e nevojave për të gjitha grupet e popullsisë, përfshirë të gjitha grupet etnike të Kosovës.
- përfshirjen e gjërë të popullatës dhe të kontribuuesve të detyrueshëm e vullnetar, për të përfituar pensione nga komponentët e Skemave Pensionale private dhe publike, përmes politikave të Fondeve Pensionale dhe të detyrimeve buxhetore,
- -qasjen e barabartë për të gjithë banorët rezident të Kosovës, të cilët e mbërrijnë moshën e pleqërisë 65 vjeçare, të cilëve iu mundësohet që të përfitojnë pensione nga të gjitha skemat pensionale, nëse ata kanë bërë derdhje të kontributeve të tyre pensionale në skemat pensionale përkatëse (Fondet Pensionale),
- respektimin e të drejtës së pronës- pensioneve,
- synimin për zbutjen e varfërisë dhe zvogëlimin e shpenzimeve, që ndërlidhen me mbështetjen sociale në Kosovë,
- vetë-qëndrueshmërinë ekonomike dhe në stabilitetin financiar të Sistemit Pensional (të hyrat nga kontributet e definuara individuale dhe me kosto efektive, përfitimet nga investimet sipas lartësisë së shumës së portfolios individuale dhe të gjendjes kualitative për pagesën e pensioneve)
- stabilitetin makroekonomik dhe socio-ekonomik,
- shëndetshmërinë financiare, sigurinë dhe likuiditetin e mjaftueshëm financiar,
- përgjegjësia profesionale në administrim të saktë dhe koordinim të operimeve të nevojshme financiare, raportimeve lidhur me gjendjen e aseteve pensionale,
- barazimin e të dhënave lidhur me derdhjen e kontributeve pensionale me bizneset, Administratën Tatimore të Kosovës dhe Bankën Qendrore të Kosovës,

- administrimin efikas dhe përpunimin e të dhënave lidhur me kursimet e kontributeve pensionale, llogarive individuale dhe i pensioneve, për të gjithë përfituesit e pensioneve të merituar
- , kursimin e kontributeve pensionale të identifikuar në portofoliot individuale të kontribuuesve,
- besueshmërinë e lartë të publikut në Sistemin Pensional, të shprehur përmes rritjes së vazhdueshme të kursimeve të kontributeve pensionale,
- qasjen e kujdesshme e Fondeve Pensionale në investimin e mjeteve të tyre, bën që rreziku i likuiditetit të jetë i ulët,
- ndershmërinë e lartë të qeverisjes me asetet e Sistemit pensional,
- përkushtimin e organeve qeverisëse të Sistemit Pensional të Kosovës në përpilimin e politikave respektive, me qëllim të realizimit të objektivave lidhur me ruajtjen e stabilitetit financiar të Fondeve Pensionale
- , përfaqësimin profesional në organet qeverisëse dhe mbrojtja e interesave të kontribuuesve me qëllim të uljes së rrezikut sistematik të ndërlidhur me mbajtjen e llogarive individuale të kontribuuesve pensional, si një siguri dhe garanci për sigurimin e kursimeve të kontributeve pensionale,
- sigurimin e aseteve të Fondeve Pensionale në kompanitë e sigurimit, me qëllim të rritjes së nivelit sa më të lartë të sigurimit të kursimeve pensionale, si një masë e 79 domosdoshme për të mbajtur besimin e publikut për sigurinë e kursimeve të kontributeve pensionale,
- -përgjegjësinë fiduciare të organeve qeverisëse të Fondeve Pensionale apo përgjegjshmëria e autoriteteve qeverisëse dhe të menaxhimit, në lidhje me kualitetin e politikë-bërjes dhe ekzekutimin e vendimeve të nevojshme për zhvillimin e skemave pensionale, duke e ruajtur apo sforcuar e stabilitetin financiar,
- - mbrojtjen nga rreziqet e brendshme dhe të jashtme, ndërlidhet me krizat politike dhe ekonomike, të cilat mund të lëndojnë integritetin financiar të Sistemit Pensional dhe të ekonomisë në përgjithësi, si rreziqe potenciale, të cilat mund të vijnë nga zvogëlimi i rritjes ekonomike, mbështetjes së kufizuar të sistemit financiar, kulturës së pamjaftueshme për menaxhimin e rrezikut në institucionet financiare dhe në agjentët e tjerë ekonomik, veçanërisht rrezikun e kursit të këmbimit dhe të likuiditetit, si dhe

mundësitë e kufizuara që kanë autoritet publike për të aplikuar masa financiare anti-krizë, e të ngjashme në vend,

- përgatitjen dhe përshtatjen e infrastrukturës financiare, - mbikëqyrjen sistematike nga institucioni financiar rregullator dhe mbikëqyrës (Banka Qendrore e Kosovës), duke rishikuar nevojën për funksionim sa më eficient ndërinstitucional dhe për të bërë mbikëqyrje “ex-ante” dhe ndërhyrje “ex-post”,
- kompletimin e kuadrit ligjor, për të përmbushur kushtet e operimeve të përshtatshme me kapital financiar dhe të likuiditetit, për të ruajtur gjendjen e synuar të bilancit, si dhe të marrëdhënieve që rregullojnë qeverisjen dhe menaxhimin e Sistemit Pensional, - promovimin e zhvillimit ekonomik nga ana e Sistemi Pensional, shumën e kursimeve të kontributeve pensionale, investimin e aseteve të Fondeve Pensionale, shkallën e të punësuarve, lëvizjet në tregun e punës, potencialin financiar të akumuluar të Fondeve Pensionale, mundësitë për zhvillimin ekonomik të vendit, etj.,
- promovimin e zhvillimit të tregjeve të kapitalit financiar,
- racionalizimin (minimizimin) e shpenzimeve operacionale dhe të menaxhimit, - kapitalizimin e aseteve përmes investimeve direkte në tregjet e kapitalit financiar, 80
- krijimin e portfoliove të definuara individuale të kontribuuesve pensional, - shpagimin e anuiteteve pensionale,
- shmangien e rreziqeve e financiare, - pavarësinë e entiteteve pensionale, - transparencën
- përballë publikut, kontribuuesve, përfituesve të pensioneve dhe autoriteteve politikë-bërës, institucioneve të ndryshme private dhe publike, bëhet komunikimi efektiv, i besueshëm dhe i ndërsjellët,
- ndikueshmërinë në sistemin makroekonomik përballë ndryshimeve demografike, në punësim, në të ardhura personale, konsum, etj., në periudha afat gjata,
- rivlerësimin e objektivave dhe formave të zhvillimit të veprimtarisë financiare të Sistemit Pensional në të ardhmen, me qëllim të sigurimit të ruajtjes së vlerës kualitative të aseteve pensionale, si dhe të kapitalizimit të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, - përmirësimin e vazhdueshëm të funksionalizimit të Sistemit Pensional. - etj.

Dizajnimi apo modelimi i strukturës së sistemit pensional (Chlon- Dominczak, 2003)⁷⁵ në Kosovë është bërë mbi bazën konceptuale e cila në vete përmban: cilësitë e modelit, mënyrën e

rregullimit ligjor dhe kornizën e akteve tjera normative, infrastrukturën e përpunimit të dhënave (TI), të cilat e bëjnë këtë sistem funksional, të qëndrueshëm dhe të sigurt⁴⁴.

2.12. REFORMA E PENSIONEVE NË SHQIPËRI

Reformat e ndjekura në Shqipëri kanë nisur nga viti 1993 dhe janë bërë disa. Fakti që kemi disa reforma në dy dekada tregon në një farë mënyre se të gjitha përpjekjet e realizuara nuk kanë çuar në një zgjidhje përfundimtare të problematikës së pensioneve në vend. Sigurisht kjo nuk është në përgjegjësi të vetëm profesionistëve që merren me këtë, por edhe për shkak të ndryshimeve të kushteve dhe rrethanave demografike dhe ekonomike të vendit. “Stacionet” e reformave në pensione janë prezantuar edhe te kapitulli i hyrjes kur u parashtruan ligjet kryesore për sigurimet shoqërore. Në vitin 1993 filloi reforma e parë në sistemin e pensioneve. Ajo bazohej në unifikimin e dy skemave të ndryshme të sigurimeve shoqërore (të punësuarit në shtet dhe në kooperativa) për të garantuar të njëjtat kushte për të gjithë individët aktivë në punë. Reforma e dytë në 2002 kishte si synim ndryshimin e parametrave duke u bazuar në parashikimet demografike ku pritej një rritje në raportin e varësisë së popullsisë së moshuar. Reforma e tretë e vitit 2005 kishte të bënte me përshtatjen e sistemit të sigurimeve shoqërore me ekonominë e tregut, pra u dha mundësia e privatizimit edhe të këtij sistemi. Së fundi, reforma e vitit 2014 apo reforma e katërt ishte një domosdoshmëri. Kjo reformë ka për qëllim të kthejë sistemin e pensioneve në një skemë të qëndrueshme, zhvillimi i tregut privat të pensioneve, zhvillimi i tregut financiar, diversifikimi i riskut, mbrojtje më e mirë për qytetarët dhe diversifikim i barrës sociale në të ardhmen. Kjo gjë do të realizohet përmes rritjes së moshës së daljes në pension dhe ndryshimeve në kontribute.⁴⁵ Çfarë duhet reformuar tek sistemi aktual PAYG (formula PAYG (formula e pensioneve, norma e kontributit, politika e indeksimit, evazioni, zona urbane - rurale

⁴⁴ Reforma e Sistemit pensional në Kosovë dhe qëndrueshmëria e tij Nexhmedin Shaqiri-Tirane, Nentor 2018. Fq.77-80

⁴⁵ Abel, A. dhe B.D. Bernheim (1991): Fiscal policy with impure intergenerational altruism. *Econometrica* 59, 1687-1711.

etj). z Data e reformave (si për kolonën e 1 dhe për prezantimin e kolonës së 2) z Mosha e hyrjes për pjesëmarrësit në kolonën e 2 & Ndarja e Kontributeve ndërmjet dy kolonave.⁴⁶

1.) Arsye për reformimin e sistemit të pensionit

Arritja e “qëndrueshmërisë”, ka qenë objektivi kryesor që hartuesit e politikave kanë synuar kur kanë ndërmarrë reformimin e sistemit të pensioneve. Rëndësia e arritjes së qëndrueshmërisë afatgjatë të sistemeve të pensionit dhe sfidat e mëdha me të cilat përballen, ka bërë të domosdoshme që hartuesit e politikave duhet të miratojnë një përkufizim më të plotë të qëndrueshmërisë. Duke parë nga e ardhmja, politikë-bërësit duhet të sigurojnë jo vetëm që presioni mbi kufizimet po menaxhohet si duhet, por edhe sistemi e pensioneve mbetet në fuqi dhe është në gjendje për të arritur qëllimet që pritet. Politikë-bërësit duhet të jenë në gjendje të ndajë ndikimin e reformave në zbutjen e varfërisë dhe në funksion të uljes së konsumit, në veçanti për grupet me të ardhurat e ulëta dhe/ose karrierë të pjesshme, së bashku me ndikimin që reformat kanë në madhësi relative e transfertave midis brezave, si në aspektin e pasurisë neto të pensioneve që rrjedh për gjeneratat e ardhshme dhe normat e kontributeve të nevojshme për të financuar këto transfertat.

Qëllimi kryesor i një sistemi pensioni duhet të jetë sigurimi i përfitimeve, të përshtatshme, të përballueshme dhe të qëndrueshme gjatë pleqërisë (Holzmann & Hinz, 2005). Bankat synojnë të realizojnë të gjitha këto dhe arsyeja e madhe e përfshirjes së Bankës në reformat e pensioneve është për shkak të implikimeve fiskale, kryesisht tek sistemet me përfitim të përcaktuar, edhe pse ndonjëherë mund të përfshihen edhe përfitimet e asistencës sociale për të moshuarit. Sistemet rrallëherë janë të projektuara që në fillim të ekzistencës së tyre në mënyrë të përkryer, pasi me plakjen e popullsisë dhe ndryshimet në kontributin e fuqisë punëtore, sistemet fillojnë të shfaqin probleme.

⁴⁶ Dr. Slawomir Solarz-Fushata e ndërgjegjësimi të publikut si një element i reformës së Pensioneve. Tiranë, 9 Shkurt, 2009, fq.5

Reformat e pensioneve janë përpjekur dhe synojnë të rrisin mbulimin si një mjet për të garantuar sigurinë për personat e moshuar, për një segment të gjerë të popullsisë, por shumica e përpjekjet për rritjen e mbulimit nuk kanë qenë të suksesshme.⁴⁷

Por, për shkak se ka pak shembuj të suksesshëm, qeveritë janë kthyer tek pensionet e asistencës sociale, si një mjet për të siguruar mbështetje për personat e moshuar të cilët nuk janë të mbuluara nga programet me kontribut social, në vend të gjenden zgjidhje për të zgjeruar mbulimin. Këto programe ndihmash sociale, në disa raste, janë të përfshira brenda asistencës së përgjithshme sociale dhe në raste të tjera, ata ekzistojnë si programe më vete, ose janë të lidhura me sistemin kontributiv të pensioneve. Vendet me sisteme me kontribut të përcaktuar që me vështirësi krijojnë kthime nga investimet, hasin shumë vështirësi nëse një numër i konsiderueshëm i të moshuarve bie nën nivelin e varfërisë. Mbikëqyrja dhe rregullimi i përshtatshëm i këtij lloji të fondit të pensionit dhe të sistemeve të pensioneve vullnetare duhet të bëhet së bashku me fleksibilitetin në investimin e aseteve, në mënyrë që fondet e investimeve të furnizojnë një kthim të mjaftueshëm për punëtorët që sigurojnë kontribute. Në disa raste, qeveritë i shohin rezervat e fondit të pensionit si një burim të gatshëm për financimin e çfarëdo investimi të motivuar politikisht që ata dëshirojnë të bëjnë. Përmirësimet në funksionimin e tregjeve të kapitalit mund të jenë të nevojshme përpara se fondet e pensioneve të mund të ofrojnë mbështetjen e duhur në pleqëri.

2.) Llojet e reforma në sistemet e pensioneve dhe pasojat e shpërndarjes

Arsyeja kryesore, deri tani, për reformat e sistemeve të pensionit ka qenë për të adresuar ndikimin fiskal, reformat janë përqendruar kryesisht në përmirësimin e deficitit fiskal. Nga pikëpamja e shpërndarjes, ky është fokusi i duhur duke pasur parasysh mbulimin jo të plotë dhe potencialin për shpërndarjen regressive të të ardhurave nga grupet e pambuluara me të ardhura të ulëta tek grupet me të ardhura dhe mbulim më të lartë. Çdo reformë që ul deficitin fiskal do të jetë e dobishme nga një perspektivë shpërndarje. Reformat e pensioneve mund të grupohen në të paktën katër kategori të ndryshme: reformat parametrike, të cilat përfshijnë ndryshime në parametrat e sistemit aktual të pensioneve; reforma sistematike, të cilat përfshijnë futjen e një lloji të ri të sistemit të pensioneve për të zëvendësuar apo plotësuar sistemin ekzistues; reforma

⁴⁷ Reformimi i sistemit të pensioneve, problemet dhe sfidat-Doktoratura-Landi-Gushi-Tirane, Tetor 2018

rregullatore, të cilat përfshijnë ndryshime në rregullat e investimeve për fondet që kanë asete, të cilat mund të investohen; dhe reformat administrative.

3.) Reformat parametrike

Sistemet e pensioneve mbështetet në tri nëngrupe të parametrave: parametrat e kontributeve, parametrat e përfitimit, dhe kushtet për marrjen e pensionit. Shumë reforma parametrike përfshijnë ndryshime në të tre nëngrupet. Secili nga këto nëngrupe parametrash ka ndikim distributiv midis kontribuuesve dhe përfituesve. Reforma duhet të ndikojë edhe në qëndrueshmërinë fiskale të sistemit të pensioneve, dhe qëndrueshmëria fiskale ndikon në rishpërndarjen nga jashtë sistemit të pensioneve në kontribuuesit dhe përfituesit e sistemit të pensioneve.⁴⁸

Parametrat kontribut – të ardhura zbatohen si për sistemin me përfitim të përcaktuar dhe në sistemet me kontribut të përcaktuar, si dhe tek sistemet vullnetare. Megjithatë, ndikimi në qëndrueshmërinë fiskale kryesisht ndodh në sistemet me përfitim të përcaktuar. Parametrat përfshijnë:

Normat e kontributeve - Rritja e normave të kontributeve ul në mënyrë të qartë pagat që punëtorët çojnë në shtëpi, si dhe përfitimet neto që punëtorët marrin

nga sistemi i pensioneve. Rritja e kostove të punës mund të zvogëlojë ose të shkaktojë stagnim në nivelin e punësimit në sektorin formal. Këto kanë një ndikim negativ tek punëtorët, por mund të jenë të nevojshme për të ruajtur bilancin fiskal. Normat e kontributeve mbi 15 për qind kanë të ngjarë të kenë ndikim negativ në tregun e punës.

Pagat që janë subjekt i kontributeve - Rritja e tavanit të pagave që janë subjekt i kontributeve, një tjetër masë e zakonshme, që ka tendencë të ketë ndikim pozitiv në shpërndarje nëse punëtorët me pagë më të lartë paguajnë më shumë nga të ardhurat e tyre në fondin e pensioneve, edhe pse në terma afatgjatë ata do të marrin gjithashtu përfitime më të larta. Kështu, ndërkohë që mund të ketë një efekt pozitiv rishpërndarës në afat të shkurtër, do të ketë pak ndikim në afat të gjatë

⁴⁸ Po aty

përderisa përfitimet e individëve me të ardhura më të larta do të rritet, veçanërisht nëse përfitimet e larta afatgjata nuk janë të qëndrueshme nga ana fiskale.⁴⁹

2. Parametrat e përfitimit përfshijnë: - Norma e mbledhur (shkalla e përfitimit për vit shërbimi) - Ulja e normës së mbledhur në mënyrë të qartë përkeqëson pozitën e pensionistëve dhe ul normën e tyre neto të kthimit nga sistemi, por kur sistemi shkon drejt deficitit, ajo ndihmon për të shmangur transferimet nga grupi i të rinjve dhe njerëzve që nuk mbulohen nga sistemi. - Periudha mesatare për pagat - Periudha mesatare e pagave idealisht do të ishte mbi pagat e gjithë jetës, e cila e lidh në mënyrë më të mirë kontributin mesatar të paguar me përfitimin mesatar. Kalimi drejt periudhës mesatare të pagës ka tendencë të jetë progresiv, pasi punonjësit që fitojnë të ardhura të larta do të fitojnë pensione bazuar në këto të ardhura. - Rivlerësimi i pagave - Pagat duhet të rivlerësohet në bazë të rritjes mesatare të pagave në mënyrë që të sigurojnë stimuj për punëtorët për të kontribuar gjatë viteve të tyre të hershme. Kjo mund të mendohet si një mjet për të siguruar normën e kthimit të kontributeve. Rivlerësimi i pagave në raport me rritjen mesatare të pagës është i nevojshëm për t'u dhënë punëtorëve një normë kthimi të kontributeve të tyre që është i barabartë me rritjen e pagave. Rivlerësimi më i ulët i pagave, mundet teorikisht, të çojë në qëndrueshmëri më të madhe fiskale, por zakonisht rezulton në më shumë evazion, pasi punëtorët fitojnë normë kthimi të ulët për kontributet e hershme dhe kjo minon qëndrueshmërinë fiskale. - Indeksi i pensioneve pas daljes në pension - Indeksi i pensioneve pas daljes në pension në mënyrë ideale duhet të ndërmerret në lidhje me inflacionin për të mbrojtur fuqinë blerëse të pensionistëve pas daljes në pension. Mungesa e rezultateve të indeksimit në marrjen e pensionit tek të moshuarit në moshë krijon më pak mbrojtje sesa tek të moshuarit, të cilët sapo kanë dalë në pension dhe mund të jenë në gjendje për të punuar akoma. Gratë, të cilat në përgjithësi jetojnë më gjatë se burrat, janë gjithashtu në disavantazh në mënyrë disproporcionale nga mungesa e indeksimit, pasi pensionet e tyre në të vërtetë do të shpërndahen mbi një numër më të madh vitesh. Indeksi i rritjes së pagave është në thelb i papërballueshëm për shumicën e vendeve dhe jo i justifikueshëm nga këndvështrimi që pensionistët nuk kanë nevojë për të rritur konsumin e tyre gjatë viteve të pensionit, duke supozuar se shpenzimet shëndetësore janë mbuluar, pavarësisht se si ndryshon paga mesatare në raport Reformimi i sistemit të pensioneve, problemet dhe sfidat. 50 me pensionin. Indeksi i pensioneve pas daljes në pension është një

⁴⁹ Po aty

çështje edhe në sistemet me përfitim të përcaktuar dhe në sistemet me kontribut të përcaktuar si dhe e përfitimeve jo kontributive. - Pensioni minimal - Niveli i pensionit minimal është vendosur mjaft lart në shumë vende, ndonjëherë aq i lartë apo edhe më i lartë se minimumi i pagës. Duke pasur parasysh se punëtorët me paga minimale japin kontribute nga pagat e tyre, kanë familje për të mbështetur dhe paguajnë tatimet nga të ardhurat, ndërsa pensionistët nuk japin kontribute, kanë më pak anëtarë në familje për të mbështetur dhe zakonisht nuk paguajnë asnjë taksë për të ardhurat, nuk ka kuptim t'ju jepet pensionistëve më shumë se paga neto që ata kanë fituar kur ata ishin në punë. Ulja e pensionit minimal mund të çojë disa pensionistë në varfëri, por kjo duhet të jetë e balancuar kundrejt qëllimit për të kufizuar transferimet jashtë sistemit dhe për të inkurajuar derdhjen e kontributeve lidhur me përfitimet. Pensioni minimal ndikon në të dy sistemet me përfitim të përcaktuar dhe kontribut të përcaktuar, si dhe në përfitimet jo kontributive, të cilat janë një formë e pensionit minimal.

3. Kushtet për përfitim përfshijnë: - Moshën e daljes në pension - Në mënyrë ideale, moshja e daljes në pension do të rritet me rritjen e jetëgjatësisë dhe aftësinë e popullsisë më të vjetër për të punuar me rritjen e moshës, duke kufizuar përfitimet e pensioneve për ata njerëz që janë konsideruar shumë të vjetër për të punuar. Qëllimi i sistemit të pensioneve është të sigurojë një mesatare prej 15 vjet në pension. Në shumicën e rasteve, duke ngritur moshën e pensionit mund të zvogëlohet numri i individëve me të ardhura të ulëta të cilët kontribuojnë për pension. Barazimi i moshës së Reformimi i sistemit të pensioneve, problemet dhe sfidat. 51 pensionit për burra dhe gra ka tendencë të jetë pro grave, pasi ajo në thelb ngre nivelet e pensionit për shumicën e grave. Ndryshimet në moshën e pensionimit ndikojnë në të dy sistemet, si ato me kontribut të përcaktuar dhe ato me përfitim të përcaktuar, por gjithashtu edhe sistemet me kontribut vullnetar dhe pa kontribute. Në sistemet me përfitim të përcaktuar dhe ato pa kontribute, ndryshimet në moshën e daljes në pension përmirësojnë qëndrueshmërinë fiskale, ndërsa, në rastin e sistemeve me kontribut të përcaktuar dhe sistemet vullnetare, ngrenë nivelin e pensioneve. - Vitet e shërbimit të nevojshme para marrjes së pensionit - Rritja e numrit të viteve të nevojshme para se një individ mund të marrë një pension të plotë në mënyrë të ngjashme mund të diskriminojë individët me të ardhura të ulëta, të cilët në përgjithësi kanë karrierë pune më të shkurtër, por përsëri, dallimet në popullsinë e mbuluar nuk mund të jenë aq të mëdha dhe ky problem mund të adresohet duke siguruar pensione të pjesshme. - Vlerësimin e mjeteve në dispozicion - Në rastin e përfitimeve pa kontribut, shtetet shpesh vlerësojnë mjetet në dispozicion të individëve për të ulur koston fiskale dhe për të përcaktuar kushtet kualifikuese për përfitim.

Këto dy mënyra reduktojnë numrin e përfituesve, duke ulur transferimin nga forca e punës tek të moshuarit. Në pothuajse të gjitha rastet, reformat parametrike, veçanërisht ato në sistemet me përfitime të përcaktuara, do të reduktojnë nivelin e pensioneve dhe kështu potencialisht të rriskuarit më të moshuarit nga varfëria ose të kërkojnë kontribute më të mëdha nga punonjësit, duke rriskuar edhe pjesën tjetër të popullsisë nga varfëria. Pavarësisht kësaj, këto masa janë ende thelbësore për ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit të pensionit. Reformimi i sistemit të pensioneve, problemet dhe sfidat. Pa këto masa, sistemi i pensioneve do të kalojë krizën fiskale të tij në sektorë të tjerë, do inkurajojë përdorimin e inflacionit për të mbuluar shpenzimet e deficitit ose do të fillojnë të grumbullojnë borxhe. Asnjë nga këto mundësi nuk ka pasojë pozitive për shoqërinë. Akumulimi i borxheve është veçanërisht i dëmshëm për individët të cilët kanë arritur moshën e pensioneve dhe papritmas e gjejnë veten pa përfitime. Qëndrueshmëria e sistemit të pensioneve bëhet edhe më shumë një çështje sociale, kur mbulimi me pension nuk është i plotë dhe burimet fiskale duhet të nxirren nga pjesa tjetër e popullsisë, zakonisht nga individët me të ardhura të lartë. Për më tepër shumë masa përmirësojnë pasojat e rishpërndarjes së sistemeve të pensioneve dhe rregullojnë pasojat negative të paqëllimshme. Ato mund të bëjnë sistemet e pensioneve më të drejtë duke lidhur drejtpërdrejt pensionin e përfituar me kontributin e derdhur dhe një perceptim më i lartë i drejtësisë mund të përmirësojë përmbushjen e kontributit.⁵⁰

“Mbrotjtja sociale në nivel lokal, gjegjësisht nevojat e qytetarëve jo gjithmonë kushtojnë shumë për shkak se ajo nuk është institucion por përkrahje dhe ndihmë për qytetarët dhe varet nga ajo se si ato jetojnë dhe për çka kanë nevojë. Prandaj edhe i theksuam dhe i veçuam planet vepruese. Komuna duhet të dijë se cilat i ka grupe në rrezik, se a ka në vendbanimet ose vendet më të larguara persona të moshuar për të cilët askush nuk kujdeset, a ka persona me invaliditet të cilët askush nuk i ka përfshirë në ndonjë proces, a ka fëmijë pa prindër të cilëve në çfarë do mënyrë duhet t’u ndihmohet. Jo gjithmonë janë të nevojshme shërbimet të llojit të ndonjë institucioni si që është shtëpia për persona të moshuar, çerdhja fëmijërore etj. Kjo nuk është proces. Shteti më nuk e bën këtë, komunat duhet ta bëjnë. Është i nevojshëm participim aktiv dhe bashkëpunim,

⁵⁰ Reformimi i sistemit të pensioneve, problemet dhe sfidat-Doktoratura-Landi-Gushi-Tirane, Tetor 2018

dhe të gjithë këtë ta bëjmë në interes dhe për të mirën e qytetarëve (Spasovska, ndihmës udhëheqës i Sektorit për mbrojtje sociale në MPPS).”⁵¹

Mendoj Me reformën e sistemit pensional dhe zbatimin e sistemit pensional me shumë shtylla, si një sistem i kombinuar i sigurimit rrjedhës, publik dhe privat, me financim kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë, pritet që të sigurohet stabilitet afatgjatë të sistemit dhe sigurisë në realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, përmes realizimit të përfitimeve afatgjata për personat që marrin pjesë në sistemin pensional, për vetë sistemin pensional, si dhe efekte shtesë mbi ekonominë. Në aspektin e personave sigurohet një siguri më e madhe në realizimin e pensionit, i cili do të financohet nga më shumë burime, ashtu që do të realizohet edhe ndarja e rreziqeve. Njëherazi, me reformën arrihet një transparencë më e madhe dhe informim i anëtarëve të fondeve pensionale. Reforma duhet që të orientohet drejt zbatimit të sistemit pensional solvent, si edhe rritjen e kursimeve dhe nxitjen e investimit të popullsisë dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik.

⁵¹ Svetlana Trbojeviq, Instituti për punë sociale dhe politikë sociale -Decentralizimi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë – Gjendja faktike, sfidat dhe mundësitë në nivel lokal-Shkup 2012 fq.33

2. ANALIZË KOMPARATIVE E SISTEMEVE TË PENSIONEVE

1.1. ANALIZA EMPIRIKE TË SJELLJES SË DALJES NË PENSION

Në diskutimin teorik që bëhet shpesh theksohet se efekti negativ nga pensionet publike për kursimin personal në një model të pastër të ciklit të jetës mbështetet në disa supozime të rëndësishme. Shumë studime dështojnë në gjetjen e evidencave empirike për një efekt negativ në kursimin agregat, kurse te tjerë përpiqen të hetojnë mbi arsyen për këtë rezultat. Një shpjegim i mundshëm, i cili është studiuar në disa shkrime të veçanta, është duke reduktuar ofertën për punë ose pensionin e parakohshëm. Kjo gjetje u theksua në fillim nga Feldstein (1974), dhe studimi i tij bëri të mundur të ngrihej një degë e veçantë e literaturës mbi këtë temë, në të cilën ne do të përqendrohemi në vijim.

Siç është theksuar në diskutimin teorik, futja e një skeme pensioni PAYG (pay-as-you-go) do të sillte rritjen e të ardhurave për agjentët e brezit të vjetër për sa kohë përfitimet e tyre do të kalonin kontributin e tyre në sistem. Nga standardi i teorisë së konsumit e dimë se kjo rritje në të ardhurat mund të çojë në më shumë konsumim të mallrave ose kohë të lirë (ose të dyja), nëpërmjet hapësirës së mbetur të harkut të jetës. Një kohë e lirë më e madhe nënkupton ose një moshë më të ulët të daljes në pension, ose më pak ofertë pune gjatë periudhës së daljes në pension (duke supozuar se pensionistët në një farë mase vazhdojnë të punojnë pas daljes në pension). Sa më i lartë efekti në kohën e lirë (dhe më i vogël efekti mbi konsumin) aq më i vogël është efekti në kursimin agregat nga sistemi i sigurimeve shoqërore.

Përveç të qenit një shpjegim për efektet në kursimin e munguar, pensioni i parakohshëm (dhe sjellja e daljes në pension në përgjithësi) është një temë interesante më vete. Nga një pikëpamje teorike vendimi i daljes në pension mund të shihet si një pjesë e një problemi planifikimi dinamik në bazë të pasigurisë dhe të informacionit jo të plotë, si dhe disa faktorë mund të jenë me rëndësi kur duam të shpjegojmë sjelljen e individit. Dalja në pension do të varet nga faktorë të tillë si sistemi i taksave, funksionimi i tregut të punës, sistemet e kujdesit shëndetësor, vitet e pritshme të jetës etj. Prandaj përbën sfidë modelimi teorikisht i kësaj sjellje dhe po kështu formimi i testeve gjithëpërfshirëse empirike. Interesi i madh ndaj kësaj teme duhet të shihet në

lidhje me uljen e moshës së daljes në pension pleqërie që është vërejtur në shumë vende perëndimore gjatë dekadave të fundit, shpesh e lidhur me rritjen e përfitimeve nga sigurimet sociale.⁵²

Republika e Maqedonisë është shtet demokratik, social në të cilën të gjithë para ligjit janë të njëjtë, ndërsa një ndër vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë ndër të tjerash është edhe respektimi i principeve demokratike dhe të drejtave të njeriut.⁵³

Secili ka të drejtë në punë, zgjedhje të lirë të punësimit, mbrojtje gjatë punës dhe në sigurim material gjatë kohës të papunësisë së përkohshme. Secili, në kushte të barabarta, e ka të arritshëm çdo vend pune. Secili i punësuar ka të drejtë në përfitim përkatës.⁵⁴

Sistemi pensional maqedonas është pjesë e sigurimit social të Republikës së Maqedonisë (RM) dhe ka strukturën në vijim:

- Sigurimi mbi bazën e solidaritetit të gjeneratave (d.m.th. shtylla e parë),
- Sigurimi i detyruar i financimit kapital pensional (d.m.th. shtylla e dytë),
- Sigurimi vullnetar i financimit kapital pensional (d.m.th. shtylla e tretë).

Kjo strukturë është rezultat i reformës rrënjësore të sistemit pensional, që u hartua për disa vjet, ndërsa korniza e saj ligjore është vendosur në vitin 2000. Ekzistojnë katër ligje dhe një numër më i madh aktesh nënligjore, të cilat e rregullojnë sistemin pensional në Republikën e Maqedonisë. Ato janë: Ligji i sigurimit pensional dhe invalidor, Ligji i sigurimit të detyruar pensional me financim kapital, Ligji i sigurimit vullnetar pensional me financim kapital, Ligji i pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi pensional me financim kapital dhe më shumë akte nënligjore të cilat e rregullojnë sferën adekuate.

Sistemi pensional në Republikën e Maqedonisë ekziston prej shumë vitesh, ka një përfshirje të madhe të fuqisë punëtore dhe sigurimit të pensioneve për të siguruarit. Por ndryshimet socio-ekonomike në Republikën e Maqedonisë në fillimin e viteve 90-të kanë pasur ndikim në sistemin pensional, i cili u përball me vështirësi financiare në punën e vet. Ato u shkaktuan nga lëvizjet e

⁵² Drejt qëndrueshmërisë të sistemit të pensioneve në Shqipëri-Drita-LUZOKLLAPI-Tiranë, 2017,fq38

⁵³ MTSPShkup, shtator viti 2008
<http://www.mtsp.gov.mk>

⁵⁴ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Veriut <https://sobranie.mk/>

pavolitshme në ekonomi që ndikuan në reduktimin e numrit të të siguruarve aktivë dhe të pagesave të reduktuara të kontributeve nga njëra anë dhe rritjes së numrit të pensionistëve nga ana tjetër. Shpenzimet për pensionet patën një rritje të vazhdueshme.

Një faktor tjetër që ka ndikim të madh mbi sistemin pensional është edhe faktori demografi k. Kryesisht plakja e popullsisë, që është një trend botëror, do të thotë se njerëzit jetojnë më gjatë për shkak të kushteve të mira të jetesës dhe shërbimeve të mira shëndetësore, por njëherazi ulet numri i të sapolindurve, d.m.th., më pak persona të rinj. Si rezultat i këtij faktori pjesëmarrja e të moshuarve në popullsinë e përgjithshme është gjithnjë e më e madhe.

Projektimet e Njesisë aktuale të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë (FSPIM) tregojnë se ky trend do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Si një tregues i zakonshëm i plakjes së popullsisë përdoret raporti i popullsisë së moshuar (në moshë mbi 65 vjeç) në popullsinë që ka aftësi pune (e moshës nga 18 deri në 64 vjeç). Në Grafikon 2.1 tregohet numri i këtyre dy grupeve të popullsisë dhe raportit mes tyre.

Me qëllim të përballimit të këtyre situatave të mundshme, u zbatua reforma bazike në sigurimin pensional dhe invalidor në vendin tonë, me të cilën u soll edhe sistemi pensional me tre shtylla, me formë të kombinuar financimi të pensioneve të ardhshme dhe me diversifikim të rreziqeve demografi ke dhe ekonomike, me qëllim sigurimin e një pensioni të sigurt për gjeneratat aktuale dhe ato të ardhshme të pensionistëve dhe stabilitet afatgjatë të sistemit pensional.

Shtylla e parë financohet në bazë rrjedhëse (PAYG), që do të thotë se me kontributet nga të siguruarit aktualë paguhen pensionet e pensionistëve të tanishëm. Kjo shtyllë funksionon sipas parimit të të ashtuquajturve pensione të definuara, përkatësisht përmes tij sigurohen pensionet sipas një formule të definuar paraprakisht për përllogaritjen e pensioneve. Nga shtylla e parë paguhet një pjesë e pensionit të pleqësisë, pensioni invalidor, pensioni familjar, si dhe shuma më e vogël e pensionit.

Shtylla e dytë dhe e tretë nënkuptojnë zbatimin e sigurimit pensional me financim kapital në të cilin bëhet kapitalizmi i kontributeve të paguara në emër dhe në llogari të anëtarit

Këto dy shtylla funksionojnë sipas parimit të ashtuquajtur kontribute të definuara, përkatësisht tek këto dy shtylla paraprakisht është përcaktuar niveli i kontributit që paguhet, ndërsa pensioni konfirmohet më pas, varësisht shumës së akumuluar. Nga shtylla e dytë paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë. Nga shtylla e tretë sigurohet mbrojtja/kompensimi financiar gjatë kohës së pleqërisë, invaliditetit dhe në rast vdekje të të siguruarit.

Me reformën e sistemit pensional dhe zbatimin e sistemit pensional me shumë shtylla, si një sistem i kombinuar i sigurimit rrjedhës, publik dhe privat, me financim kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë, pritet që të sigurohet stabilitet afatgjatë të sistemit dhe siguri në realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, përmes realizimit të përfitimeve afatgjata për personat që marrin pjesë në sistemin pensional, për vetë sistemin pensional, si dhe efekte shtesë mbi ekonominë. Në aspektin e personave sigurohet një siguri më e madhe në realizimin e pensionit, i cili do të financohet nga më shumë burime, ashtu që do të realizohet edhe ndarja e rreziqeve. Njëherazi, me reformën arrihet një transparencë më e madhe dhe informim i anëtarëve të fondeve pensionale. Reforma duhet që të orientohet drejt zbatimit të sistemit pensional solvent, si edhe rritjen e kursimeve dhe nxitjen e investimit të popullsisë dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik.⁵⁵

Këto janë dy dispozita që janë përfshirë në aktin më të lartë juridik dhe politikë të vendit tonë - Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Të drejtat e tilla janë të normuara dhe si të tilla sjellin detyrime për të gjitha organet dhe institucionet e Republikës së Kosovës karshi qytetarëve të saj. Normat e tilla janë njëkohësisht edhe detyrime për organizim të sjelljeve të vetëdijshme të secilit qytetarë ndaj tjetrit pa marrë parasysh çdo lloj dallimi individual ndërmjet tyre. E drejta e pensionit si një e drejtë e fituar absolute duhet të gëzojë edhe mbrojtje absolute nga të gjitha institucionet kompetente. Mohimi i një të drejte të tillë, është mohim i mbrojtjes së dinjitetit të qytetarëve të cilët për shumë vite kontribuan në ndërtimin e vendit.

Në praktikë kjo çështje nuk është e rregulluar vetëm me ligje sistimore dhe me kushtetuta të shteteve por edhe me norma të së drejtës ndërkombëtare. Fatkeqësisht Kosova nuk ka ligje të mjaftueshme dhe akoma nuk ka ndërtuar një sistem pensional të konsoliduar edhe pse ka kaluar një dekadë, që nga konstituimi i institucioneve demokratike të Kosovës. Gjatë gjithë kësaj periudhe kjo shtresë e shoqërisë (pensionistët) është nëpërkëmbur deri në padurim.

Në krahasim me vendet e rajonit, në Kosovë ekziston një problem jo shumë tipik me vendet tjera, që është informaliteti i skajshëm. Sektori privat pothuajse tërë veprimtarinë e tij e ka “gri”, dhe ka të lajmëruar vetëm një pjesë të kufizuar të punëtorëve, ashtu siç është në trend edhe ikja nga pagimi i taksave.

⁵⁵ Vështrim i shkurtër i situatave dhe trendëve në botë në sferën e pensioneve, me theks tek fi nancimi kapital i sigurimit pensional Dr. Bulent Dervishi, Mentor Jakupi, Dr. Tome Nenovsk-Shkup, Prill 2017

Po ashtu si në as një vend tjetër të rajonit, kontribuuesit në fondin e ish Federatës Jugosllave, në Kosovë paguhen me një pension tejet simbolikë gjë e cila atyre nuk u mundëson të jetojnë as për së afërmi një jetë dinjitoze. Në secilën nga vendet e rajonit pensionet janë të paktën dyfishi i këtyre që sot marrin pensionistët Kosovarë, prej të cilëve shumë nga ta kanë edhe mbi 45 vite të përvojës së punës.

Në Kosovë shtylla I dhe II e sistemit pensional janë tërësisht të ndara, dhe pensionistët aktual nuk marrin asnjë cent nga kontribuuesit aktual, gjë e cila nuk është e njëjtë me shtetet fqinje. Është e domosdoshme që të veprohet shumë shpejt për këtë pjesë të marginalizuar të shoqërisë që të paktën tani pas kaq shumë vitesh t'i sigurojmë një pension i cili do t'i bënte ata të ndihen komod në vendin për të cilin ata punuan me aq shumë mund.⁵⁶

Kjo analizë ka për qëllim që të ofrojë të dhëna mbi gjendjen dhe bazën aktuale legale, si dhe të ofrojë të dhëna të mjaftueshme mbi nevojën dhe format që duhen aplikuar në Kosovë me qëllim të ndërtimit të një sistemi pensional të qëndrueshëm, dhe të pranueshëm për qytetarët e Kosovës. Ky punim është ndarë në disa shtylla: fillimisht një përshkrim mbi gjendjen aktuale dhe bazën legale që e mbulon këtë fushë, pastaj mungesa e ligjeve të cilat kompletojnë sistemin pensional në Kosovë, shembujt dhe praktikatat e mira në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm pensional, format e sistemeve pensionale që duhet aplikuar në Kosovë si dhe në fund janë nxjerrë disa rekomandime konkrete, për veprimet që duhen ndërmarrë nga institucionet kompetente për të përmirësuar pozitën e pensionistëve në Kosovë.

Në Kosovë Sistemi Pensional për shkak të një mori arsyesh politike dhe sociale është i organizuar në tri shtylla kryesore. Në organizim të tillë ka ndikuar baza legale e pa unifikuar si dhe nevoja për të bërë zgjidhje ad hoc varësisht prej paraqitjes së situatave të presionit nga grupe të caktuara të shoqërisë

Shtylla I – Përfshinë pensionet bazë, pensionet e parakohshme dhe të veçanta, për kategoritë të cilat nuk kanë kontribuar në fondin pensional.

⁵⁶ Ndërtimi i sistemit pensional në Kosovë <http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/publikime/sistemipensional.pdf>

Shtylla II – Kursimet pensionale në llogari individuale të cilat janë të obligueshme, përkatësisht kontributet në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, ku punëdhënësi dhe punëmarrësi kontribuojnë me nga 5% secili.

Shtylla III - Janë kursimet suplementare, pjesë kjo e liberalizuar për fondet private, në Kosovë (aktualisht kemi vetëm një).

Në kuadër të shtyllës së parë, e cila përfshinë kategorinë e cila financohet nga buxheti i shtetit janë të përfshirë

1. Sistemi pensional i moshës apo bazik,
2. sistemi pensional i moshës të cilët kanë kontribuar në fondin pensional të kaluar (të gjithë ata që kanë kontribuar mbi 15 vite),
3. Pensionet për persona me aftësi të kufizuara,
4. Pensionet e parakohshme për ish minatorët e kompleksit Trepça dhe
5. Pensionet e veçanta për ish pjesëtarët e TMK-së (pension ky familjar),⁵⁷

- Pensionet e ulëta

Në shtyllën e parë të sistemit pensional të Kosovës, ka vetëm dy kategori për sa i përket shkallës së pensioneve. Pensionet e moshës janë në vlerë 45 euro dhe pensionet për personat të cilët dikur kanë kontribuar në fondin pensional mbi 15 vite, dhe të cilët marrin shumë prej 80 eurove. Që të dy këto kategori janë larg standardit të jetës në Kosovë, dhe as për se afërmi nuk i përmbushin nevojat e këtyre pensionistëve të cilët, përveç jetës së kushtueshme për ushqim dhe shërbime publike kanë nevoja të shtuara për shërbimet medicinale, të cilat në të shumtën e rasteve duhet të kryhen në sektorin privat, ku çmimet janë astronomike.

Shkallëzimi i pensioneve Pavarësisht kohës që një kontribuues ka kapitalizuar mjete në fondin e kaluar pensional dhe pavarësisht lartësisë së pagës, çdo person që ka mbi 15 vite përvojë punë ka të njëjtin pension. Kjo është e pa drejt ndaj atyre kategorive që kanë pasur paga të larta dhe për personat që kanë kontribuar për shumë vite, pasi ata të gjithë janë barazuar me po të njëjtin shumë. Është e domosdoshme që krahas rritjes edhe shuma e pensioneve të përshkallëzohet edhe

⁵⁷ Po aty

më tutje, duke i kategorizuar më mirë të gjithë ata pensionist, varësisht prej lartësisë së pagës që kanë pasur dhe varësisht prej përvojës së punë.

- Pastrimi i listave të pensionistëve

Një numër i madh i personave të cilët vdesin, familjarët e tyre nuk i lajmërojnë ata dhe pensionet për ta vazhdohet të merren edhe më tutje nga familjarët e tyre. Ministria ka aplikuar një formë të lajmërimit çdo gjashtë muaj në Bankën Komerciale ku ata duhet të nënshkruajnë një deklaratë në mënyrë që të vërtetohet se ata janë të gjallë. Po ashtu zyrtar të ministrisë hetojnë rastet e vdekjes se personave për të pastruar listat, duke i përcjellur njoftimet për vdekje, përkujtimet në gazeta etj. Kjo ka shtuar shpenzimet për Ministrinë e linjës dhe po ashtu ka komplikuar jetën pensionistëve të cilët në shumë raste presin me ditë të tëra para bankave komerciale për të nënshkruar deklaratat në mënyrë që të mos suspendohen nga lista e përfituesve të pensioneve. Certifikatat e vdekjes nuk nxirren me kohë nga familjarët e po ashtu nuk ka një koordinim të duhur ndërmjet dy ministrive për të azhurnuar ato lista. Certifikatat e vdekjes nxirren me procedura burokratike dhe po ashtu duhet paguar taksë për to, kjo ndikon që familjarët të shtyjnë nxjerrjen e një certifikate të tillë, ndërsa për buxhetin e shtetit kjo është barrë shtesë e cila duhet hetuar dhe gjetur për të evituar pagesat e mëtutjeshme.

- Mosha e pensionimit për të dy gjinitë

Legjislacioni ynë aktual ka përcaktuar moshën 65 vjeçare si moshë e pensionimit për të dyja gjinitë, ndërkohë bazuar në praktikat dhe legjislacionin e vendeve të rajonit dhe më gjerë kjo moshë dallon, ku gjinia femërore gëzon pensionim para moshës 65 vjeçare.⁵⁸

b. Shtylla e dytë

- Shuma e kontributeve

Kosova ka përqindjen më të ulët të kontributeve në rajon, kjo ndikon që edhe masa e përgjithshme e mjeteve që ka Trusti nën administrim të jetë më e vogël sesa që kanë vendet e rajonit. Vendet si Kroacia dhe Bullgaria të cilat reformën e sistemit pensional e kanë filluar

⁵⁸ Po aty

pothuajse në të njëjtën kohë me vendin tonë, kanë arritur që shumën e mjeteve të kapitalizuara ta kenë shumë të lartë në krahasim me ne. Kroacia e cila ka filluar reformën në vitin 2002 tani ka rreth 4.9 miliard euro të kapitalizuara, kurse Bullgaria e cila ka filluar reformën në vitin 2000 ka të kapitalizuara rreth 3 miliard. Kurse Kosova ka ngelur në shifrat 495 milion euro.

- Kombinimi i fondeve

Kosova është i vetmi vend në rajon ku kontribuuesit aktual nuk paguajnë mjete edhe për gjeneratën e pensionistëve të tanishëm¹⁰. Duke e marrë për bazë edhe vjedhjen e fondit të kaluar nga shteti serb, dhe pa mundësinë e gjetjes së një zgjidhje tjetër, Kosova ka nevojë më shumë se cili do vend tjetër që gjenerata të ndihmoj aq sa është e mundur pensionistët aktual.

c. Shtylla e tretë

Qeveria e Kosovës dhe Banka Qendrore, duhet të shtojnë masat për të siguruar se operatorët privat suplementarë nuk do t'i tjetërsojnë paratë e kontribuuesve për të mos ardhur deri të ndonjë mashtrim i atyre që me vetë dëshirë vendosin të kontribuojnë nga paga e tyre në këta operatorë.

Mungesa e ligjeve të cilat kompletojnë sistemin pensional në Kosovë.

Mungesa e legjislacionit i cili ka ardhur si pasojë e përkushtimit minimal të klasës politike në vend, ka sjellë si rezultat që Kosova edhe më tutje të mos ndërtojë një sistem pensional që bazohet në vlera dhe standarde ndërkombëtare. Me qëllim të ndërtimit të këtij sistemi të qëndrueshëm dhe kredibil, institucionet e Kosovës duhet të miratojnë një pako të ligjeve të cilat e rregullojnë gjithë sistemin pensional në vend. Kompleksiteti i kësaj çështjeje nuk mund të rregullohet vetëm me Ligjin për Pensionet, por kësaj i nevojiten edhe ligjet tjera përcjellëse të cilat normojnë të drejtat e pensionistëve invalidor, stazhin e beneficuar, kategoritë që gëzojnë pensionimin suplementar etj.⁵⁹

⁵⁹ Po aty

Reforma pensionale që duhet aplikuar në Kosovë

Me qëllim të krijimit të një sistemi pensional të mirëfilltë tri-shtyllësh, reformimi i sistemit aktual pensional në Kosovë duhet të jetë një ndër prioritetet e institucioneve të Kosovës me qëllim që tranzicioni në mes sistemit të vjetër pensional dhe sistemit të llogarive kursyese që po ndërtohet në Kosovë të jetë sa më i lehtë dhe i padëmshëm për shtesat e caktuara të shoqërisë.

Kosova përkundër problemeve me modelin e saj të pensioneve në thelb nuk ka nevojë të ndryshoj shumë për sa i përket shtyllës së dytë dhe aq më pak shtyllën e tretë. Nevojat më të mëdha e njëkohësisht edhe pakënaqësitë të cilat sa vinë e shtohen janë me shtyllën e parë, përkatësisht me pensionet e moshës për personat të cilët kanë kontribuar në fondin e kaluar të pensioneve. Tek shtylla e parë e pensioneve, është e domosdoshme që të rishikohet baza legale me qëllim që të caktimit të kontributit shtesë në tregun e punës. Përveç pagesave aktuale të cilat janë obligative në trust në llogarinë e secilit, çdo i punësuar dhe punëdhënës duhet të paguajnë nga një përqindje shtesë në një fond të posaçëm që do të shkonte në favor të shtyllës së parë.⁶⁰ Përkrahja sociale në Kosovë është e orientuar kryesisht drejt ndihmës monetare mujore për familjet e varfra, për personat me aftësi të kufizuar, përfshirë edhe fëmijët, për pensionistët të cilët e gëzojnë të drejtën e pensionit sipas ligjit në fuqi dhe për kategoritë e invalidëve të luftës dhe familjeve të dëshmorëve. Këto grupe të përmendura janë trajtuar si kategori sociale edhe përmes politikave qeveritare, duke qenë se në aktualitetin e Kosovës vërtet mund të konsiderohen si grupet shoqërore më të brishta. Diversifikimi i këtyre kategorive, do të mund të bënte këto ndihma më efikase, sidomos për shkak të faktit se nga kategoria e familjeve të varfra, që mbulohen me Skemën e Ndihmës Sociale, mund të dalin kategori të tjera si të papunët që jetojnë në varfëri ekstreme, të papunët me shkollim të ultë dhe me shkathtësi profesionale të ulët etj.⁶¹

⁶⁰ Ndërtimi i sistemit pensional në Kosovë <http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/publikime/sistemipensional.pdf>

⁶¹ Valon Murati, Qerkin Berisha - SKEMAT SOCIALE DHE PËRSHTATSHMËRIA E TYRE ME REALITETIN KOSOVAR- Prishtinë, 2010, fq.10

3.2.SISTEMI I PENSIONEVE NË SHQIPËRI

Në enciklopedi të ndryshme¹³⁾ përkufizimi i fjalës " pension" është një marrëveshje që u ofrohet të punësuarve për të përfituar të ardhura të rregullta kur nuk janë më marrëdhënie punësimi. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në zbatim të neneve 30 - 42, të kreut të III-të, të Ligjit Nr.. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, iu paguan përfitime personave të siguruar, si më poshtë vijon:

1. Pension të plotë pleqërie;
2. Pension të reduktuar pleqërie;
3. Pension të pjesshëm pleqërie;
4. Pension si nënë me shumë fëmijë;
5. Pension të plotë invaliditeti;
6. Pension të reduktuar invaliditeti;
7. Pension të pjesshëm invaliditeti;
8. Pension familjar;
9. Pagesë për vdekje

Duke vazhduar studimin tonë do të ndalemi tek grupimet e pensioneve:

Vëmë re se 3 janë kushtet të cilat ligji I sigurimeve kërkon :

1. Mosha
2. Vitet e punës
3. Shkëputje të marrëdhënieve financiare në qendra pune.⁶²

Ka edhe pengesa/barriera të tjera që lidhen me shtyrjen e moshës së daljes në pension.

Shpërblimi për shtyrjen e moshës së daljes në pension është sa gjysma e gjobës që vendoset për individët të cilët zgjedhin të dalin në pension deri në 3 vjet përpara mbushjes së moshës për të dalë në pension.⁶³

⁶² "Sistemet e pensioneve "PUNOI : ESMA PECA fq.23

⁶³ Shqipëria rishikimi i Sistemit të Sigurimeve Shoqërore <http://documents1.worldbank.org> fq.25

Në fillim, mosha e daljes në pension për shumicën e popullsisë ishte 60 vjeç për burrat dhe 55 për gratë dhe një moshë më e ulët për kategori të veçanta tek 50 vjeç për burrat dhe 45 për gratë. Këto kategori të veçanta po hiqen gradualisht, ndërsa mosha e daljes në pension është rritur në 65 vjeç për burrat dhe 60 për gratë. Në vitin 2013 këto mosha tashmë në Shqipëri janë arritur nga shumica e të punësuarve dhe do të arrihen gradualisht për kategori të veçanta të punësuarish. Moshat e daljes në pension po rriten me 6 muaj në vit, sipas tabelave të mëposhtme. Në të gjitha rastet, duhet të kesh 35 vite punë për ta përfutur një pension të plotë. Pensionet e parakohshme jepen me 15 vite punë.

Gjatë gjithë këtyre 20 vjetëve jemi mësuar të dëgjojmë vetëm për rritje të pensioneve. Duket sikur kërkesa për ushqime, veshje, ilaçe e me radhe, me rritjen e pensioneve është plotësuar me mire. Në fakt nuk është krejt kështu. Inflacioni i periudhës ka qenë aq i lartë sa pensionet e sotme rezultojnë realisht më të ulëta se sa ata të vitit 1990. Pensionet shqiptare deri në vitin 2007 nuk kanë qenë realisht në nivelin e vitit 1990. Përlllogaritjet e ekspertëve kanë nxjerre se vetëm në vitin 2014 pensionet do të kenë vlerën reale të vitit 1990. Sipas të dhënave zyrtare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore pensioni minimal real i vitit 2004 ka qenë sa 86 për qind e pensionit minimal real të vitit 1990. Kjo vetëm për qytetin, pasi në fshat shifrat janë edhe më të ulëta. Skema e pensioneve në vendin tonë do të pësojë ndryshime. Ekspertët e Sigurimeve Shoqërore kanë menduar të ndryshojnë skemën aktuale të pensioneve duke e përshtatur atë me vendet e tjera të zhvilluara të botës që operojnë sipas sistemit me disa shtylla. Sistemi i quajtur shumë-shtyllash, i cili do të aplikohet edhe në vendin tonë, është i përbërë prej tri shtyllash kryesore. Tri shtyllat e reja, të propozuara për ndryshimin e skemës së pensioneve, do të jenë efektive vetëm pas disa vitesh. Ministria e Financave, si iniciatore e reformës, nuk ka përcaktuar ende kushtet, por një gjë është e sigurt që, brezi i popullsisë që aktualisht merr pension, nuk do të përfitojë nga reforma.

Skema aktuale është e bazuar në sistemin solidar. Pra, paratë që mbahen nga paga e një të punësuarit nuk shërbejnë për pensionin e tij, por për pagesën e të moshuarve që tashmë kanë dalë në pension. Kjo skemë sigurohet edhe me mbështetjen e buxhetit të shtetit dhe i ka të përcaktuara pensionet maksimale dhe minimale në qytet dhe fshat. Sipas specialistëve, por edhe nga studimi

ynë,dhe Bankës Botërore, skema aktuale e pensioneve paraqet probleme e për këtë arsye është propozuar sistemi tjetër, ai me tri shtylla:⁶⁴

Shtylla zero është për të moshuarit, pavarësisht nëse ata kontribuojnë apo jo. Në disa vende kjo shtyllë aplikohet vetëm për të moshuarit e varfër dhe në disa të tjera për të gjithë të moshuarit mbi një moshë të caktuar. Qëllimi i kësaj kolone është të ofrojë një nivel të ardhurash bazë për të gjithë të moshuarit.

Shtylla e parë është sistemi i pensioneve me kontribut që aktualisht ekziston në Shqipëri. Ky është një sistem publik i bazuar në solidaritet, por ku pensioni varet nga vitet dhe niveli i kontributit.

3. Shtylla e dytë ka hyrë në disa vende si një sistem kursimesh, ku punonjësve dhe punëdhënësve u kërkohet të vendosin një përqindje të pagës në llogari të specializuara kursimesh, të cilat pastaj investohen. Pasi del në pension punonjësi përfiton kontributin dhe interesat e krijuara nga ky sistem. Kjo shtyllë mund të menaxhohet në mënyrë publike apo private dhe nuk mbështetet në sistemin e solidaritetit.

4. Shtylla e tretë është e ngjashme me shtyllën e dytë, por punonjësit dhe punëdhënësit mund të bëjnë vullnetarisht kontribute shtesë në mënyrë që të rrisin nivelin e pensionit të tyre të ardhshëm. Sistemi aktual i pensioneve në Shqipëri fokusohet kryesisht në reduktimin e varfërisë dhe ka një strukturë të ngjeshur të përfitimeve të pensionit në krahasim me gamën e gjerë të kontributeve të paguara në sistem.

Maqedonia është modeli më i suksesshëm në rajon. Ajo ndan kontributin prej 21 % të pagës në 14 % për skemën shtetërore dhe 7 % për skemën private. Në këtë mënyrë çdo individ, që del në pension, përfiton nga të dyja skemat. Ngritja e pensioneve minimale prej më pak se 100 eurosh në Shqipëri do të bëhet e mundur me aplikimin pikërisht të tri skemave, siç ndodh në pjesën më të madhe të vendeve të BE dhe të rajonit.

Një rast interesant është ai i Kosovës.

⁶⁴ Po aty fq.26

Në vitin 2002, u vendos që pagesat e pensionistëve të sotëm në Kosovë, të mbulohen totalisht nga buxheti i shtetit, ndërsa kontributet e të punësuarve të sotëm, të menaxhohen nga një fond pensionesh, në llogari individuale. Në këtë mënyrë paratë mbetin pronë vetjake e kontribuuesit dhe ky i fundit do të marrë për pension atë që ka kursyer gjatë jetës, plus interesat. Kjo skemë bën që çdo i punësuar të jetë i interesuar të paguajë sigurime shoqërore, pasi nuk ka transferuar nga të varfrit te më të varfrit. Edhe pse pronë private, mandati i këtyre kursimeve është specifik – ato mund të përdoren vetëm për pension. Fondi i pensioneve i investon kontributet dhe ia shton interesat kontribuuesit.⁶⁵

Ekzistojnë dy lloje kryesore të sistemeve shoqërore: ai i bazuar në transfertë (PAYG) dhe sistemi i investuar. Sistemi i bazuar në transfertë është program shtetëror që financohet nga tatimet ose kontributet që mblidhen nga popullata dhe u transferohen grupeve të veçanta në popullatë. Sipas kësaj skeme punëtorët financojnë pensionistët. Në Kosovë sistemi i transferit është eliminuar. Të ardhurat e përgjithshme të Buxhetit të Kosovës financojnë pensionin bazë. Për të financuar këtë nuk janë fuqizuar tatime të tjera në të ardhura; prioritet i strategjisë ka qenë që të mbahen tatimet në paga të ulëta kështu që punëtorët kosovarë të jenë konkurrentë dhe të mos ketë nxitje për tu fshehur në ekonominë gri. Fjala “e investuar” i shkon secilit program në të cilin paratë mblidhen dhe ruhen në llogari përgjatë periudhës kohore, të cilat investohen në tregje të kapitalit për të siguruar të ardhura në të ardhmen.

Dallimi kryesor mes sistemit tipik të bazuar në transfertë dhe sistemit të investuar është se paratë e grumbulluara nën sistemin e investuar kursehen dhe investohen në vend se të shpenzohen menjëherë. Sipas sistemit të investuar kontributet transferohen në llogaritë individuale të pjesëmarrësve, investohen në portofole financiare, dhe akumulohen përgjatë kohës së punësimit të pjesëmarrësit duke fituar përqindje nga investimi. Paratë e mbledhura janë të sigurta dhe plotësisht të ndara nga buxheti shtetëror.

Ky sistem është më transparent ndaj pjesëmarrësve se lejon definimin e qartë të drejtave në pronësi mbi kontributet dhe të akumuluarat. Kur pjesëmarrësit pensionohen, pensioni i tyre do të varet nga kontributet që ata i kanë bërë në llogarinë e tyre. Në Kosovë, sistemi i tillë do të

⁶⁵ Po aty fq.44

përfaqësohet nga Llogaritë Individuale të Kursimeve Pensionale që mirëmbahen nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).

Sistemi i pensioneve në Shqipëri i ka përmbushur funksionet e tij themelore gjatë tranzicionit dhe tani vuan nga disa probleme të mprehta që e bëjnë reformimin e tij të domosdoshëm. Së pari, skema jep përfitime të ulëta për disa kategori dhe, ç'është më e rëndësishmja, përfitimet do vazhdojnë të ulen edhe më shumë në rast se skema nuk reformohet. Së dyti, skema karakterizohet nga elementë të theksuar padrejtësie sepse disa grupe kontribuuesish përfitojnë pensione shumë të larta dhe kontribuojnë shumë më pak se të tjerët. Është e natyrshme që sistemet e pensioneve të kenë një farë rishpërndarjeje tek më të varfrit apo kategoritë e tjera. Gjithsesi, nëse rishpërndarja është shumë e lartë skema e pensioneve mund të konsiderohet e padrejtë dhe pjesëmarrja në të nis e bie. Së treti, skema e pensioneve vuan nga një deficit i lartë që e bën atë financiarisht të papërballueshme. Së katërti, ndonëse të gjithë të moshuarit janë të mbuluar nga skema falë punësimit të plotë gjatë komunizmit, një pjesë e madhe e popullsisë në moshë pune sot është e pa siguruar për shkak të papunësisë së lartë por edhe informalitetit⁶⁶

Ky model mund të adaptohet edhe në Shqipëri.

Shqipëria është në pozicionin e lakmueshëm të të qenit një vend me moshë të re dhe ku numri i popullsisë parashikohet të rritet gjatë gjithë periudhës së simulimit në krahasim me shumë nga fqinjët e saj, të cilët parashikojnë rënie drastike të numrit përkatës të popullsisë. Sigurisht që ritmet e rritjes së popullsisë do të ngadalësohen, por gjithsesi do të vijojnë të mbeten pozitive.

⁶⁶ DOKUMENTI I POLITIKAVE TË PENSIONEVE-Prill 11, 2014,fq.5.<https://shtetiweb.org/wp-content/>

Përfundime dhe rekomandime

Termi pension në këtë studim i referohet pagesës periodike që një pensionist merr për arsye se ka punuar për një periudhë të caktuar kohe dhe ka arritur moshën e detyruar me ligj për ta përfutur këtë pagesë.

Nisur nga fakti që shkalla e papunësisë është shumë e lartë, sidomos tek grup-moshat e reja, personat e intervistuar janë kundër rritjes së moshës së pensionit apo barazimit të moshës së daljes në pensionin midis burrave dhe grave.

Shumica e personave të intervistuar janë në favor të pensionit social, duke iu dhënë kështu mundësinë për të pasur një pension minimal edhe personave që nuk kanë derdhur kontribute. Në RMV e kemi të drejtën e pensionit social me vlerë 6000 denar.

Objektivat e sistemit pensional shpesh herë ngatërrohen me mbrojtjen sociale e cila po ashtu trajton sfidat e varfërisë, cenueshmërisë dhe përjashtimeve sociale, ndonëse ekzistojnë dallime thelbësore mes pensionit dhe mbrojtjes sociale në aspekt të administrimit dhe financimit.

Në aspekt të financimit pensionet financohen në mënyra të ndryshme përmes kontributit në një skemë pensionale ose hapjes së një llogarie bankare si formë kursimi, që do luajë rolin e pensionit në moshën e pleqërisë

Popullsia e RMV do të vazhdojë të ulët edhe për disa vite si pasojë e një rritjeje natyrore të ulët dhe një shkalle emigracioni të lartë. Nga ana tjetër në vitet e ardhshme parashikohet një rritje e indeksit të moshës së vjetër, që do të thotë se do të rritet përqindja e popullsisë mbi 65 vjeç. Kjo do të vijë si pasojë e një shkalle lindshmërie të ulët dhe e rritjes së jetëgjatësisë. Shkalla e ulët e lindshmërisë do të thotë ulje e numrit të kontribuuesve në të ardhmen dhe rritja e indeksit të moshës së vjetër do të thotë rritje e numrit të pensionistëve në vitet në vazhdim. Pavarësisht se sot mund të themi se në RMV ka një popullsi me moshë relativisht të re, në dekadat e ardhshme, parashikohet se do të fillojë të jetë prezent fenomeni i plakjes së popullsisë.

Kjo është një skemë pensionesh e aplikuar në disa vende, duke përfshirë edhe RMV , e cila bazohet në faktin që kontributet e paguara sot nga ata që punojnë, shkojnë për të paguar ata që sot janë në pension. Ky term është sinonim i skemës PAYG (pay-as-you go - paguaj ndërsa shkon) e njohur ndryshe si skema plotësisht e financuar.

Nisur nga eksperiencia e vendeve të tjera, si edhe nga sugjerimet e Bankës Botërore, një nga mënyrat e reformimit të sistemit do të ishte ngritja e sistemit shumë shtyllësh. Në këtë sistem, shtylla e parë do të kontribuonte për zbutjen e varfërisë dhe është publike. Shtylla e dytë, është e

detyrueshme dhe mund të jetë private ose publike dhe garanton të ardhurat për moshën e tretë.

Shtylla e tretë është vullnetare, për të gjithë ata persona që do të donin të kontribuonin më shumë, në mënyrë që të kenë të ardhura më të larta në moshën e pleqërisë.

Reformat pensionale në shtetet në zhvillim ndodhën gjate viteve 90 - ta e këndej, kishin të bëjnë me inkorporimin e shtyllës së dytë si rrjedhojë e presioneve të shumta nga: plakja e popullsisë, reduktimi aktiv i forcës punëtore, inkuadrimi i vonshëm i të rinjve në tregun e punës, efektiviteti i ulët i pensioneve vullnetare private, rritja graduale e moshës së daljes në pension, vendosja e një lidhje mes kontributeve dhe pagesave të përfitimeve, shfrytëzimi i privilegjeve të pensioneve të hershme, dalja e parakohshme në pension, etj.

Republika e Maqedonisë (si shtete në tranzicion) përgjatë periudhës transitore pësoi në reforma pensionale dhe të sistemit pensional. Këto reforma kishin për qëllim konsolidimin e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor dhe sigurimin e mjeteve për pagesat e pensioneve, për personat që plotësojnë kushtet ligjore për dalje në pension.

Përpos Shoqërisë së pensioneve Sava sh.a Shkup me shtyllën e dytë menaxhon edhe KB Shoqëria e parë pensionale. KB Fondi i parë i hapur dhe i detyrueshëm pensional Shkup është themeluar dhe menaxhohet nga ana e KB Shoqërisë së parë pensionale SHA Shkup. Po ashtu, përbehet nga mjetet e gjeneruara prej kontributeve të anëtarëve të kësaj Shoqërie.

Karakteristikë kryesore e Shoqërisë së pensioneve Sava sh.a Shkup dhe KB Shoqërisë e parë pensionale mbetet menaxhimi privat dhe konkurrues që mundëson menaxhimin e fondeve pensionale, investimin e kontributeve të paguara dhe diversifikimin e rreziqeve nga investimet e bëra (përfshirë edhe diversifikimin ndërkombëtar).

Skemat pensionale të shtyllës së parë janë skema të pafinancuara ku anëtarët kanë llogari individuale të kontributeve të përcaktuara, kurse skemat me kontribute të përcaktuara - të financuara, kontributet e anëtarëve të vendosura në llogaritë individuale nuk janë të “financuara”, pra, mjetet e akumuluar në llogaritë individuale të anëtarëve nuk investohen në instrumentet e tregjeve financiare, por janë të lidhura me normën e rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto, ose me normën e rritjes së të ardhurave mesatare kombëtare (me variabla jofinanciare).

Shtylla e dytë sigurohet nga kompanitë në formën e skemave ose planeve pensionale profesionale, pra, fondet e pensioneve profesionale financohen nga fondi i mjeteve pensionale të grumbulluara nga kontributet ose shpërblimet e paguara nga punëdhënësi dhe punonjësi, si dhe nga kthimi i investimeve nga kontributet e investuara.

Shtylla e tretë e sistemit pensional e Republikës së Maqedonisë paraqet mënyrën e re të sigurimit pensional me financim kapital në bazë të kontributeve të përcaktuara vullnetarisht. Kjo shtyllë, për dallim nga sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital përfshinë personat të cilët dëshirojnë të sigurojnë një volum të lartë të sigurisë materiale.

REKOMANDIME

- Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet monitorimit dhe stimulimit të kontribuuesve të zonave rurale, kjo sepse skema e re e reformuar nuk është shumë atraktive për ta. Arsyet të tjera që do të çonin në uljen e numrit të kontribuuesve në skemën rurale janë: niveli i ulët i produktivitetit në fshat dhe kultura e dobët në drejtim të derdhjes së kontributeve për sigurimin e pleqërisë. Administrata qendrore, e zyrave të punës dhe ajo e sigurimeve shoqërore duhet të koordinojnë dhe bashkërendojnë punën për stimulimin e fermave bujqësore dhe përmirësimin e njohurive lidhur me përfitimet e pensionit.
- Rekomandohet që për shkak të impaktit të madh që do ketë reforma në skemën aktuale ekzistuese PAYG të kryhet me faza dhe jo e menjëhershme.
- Reformat pensionale paraqesin një kategori dinamike dhe të vazhdueshme që haset si në shtetet e zhvilluara, në zhvillim ashtu edhe në shtetet në tranzicion. Reformat pensionale synojnë realizimin e së drejtës për sigurimin pensional dhe invalidor për të gjithë gjeneratat, realizimin afatshkurtër dhe afatgjatë të aftësisë paguese, përforcimin e besueshmërisë së publikut dhe stimulimin e zhvillimit të tregjeve të kapitalit, gjegjësisht inkurajimin e rritjes ekonomike.
- Rritja e moshës së daljes në pension dhe sfida për të ekuilibruar punën dhe pensionin kundrejt ndryshimit të ciklit jetësor dhe rolit social ekonomik cilësohet si një nga rekomandimet e pashmangshme. Mirëpo, në rastin e Republikës së Maqedonisë fillimisht duhet analizuar trendi i punësimit dhe parashikimet për të njëjtën, respektivisht nëse ky trend është në harmoni me ndryshimet demografike, përfshirë edhe strukturën e punësimit për të vlerësuar gatishmërinë ekonomike për aprovimin e kësaj reforme

pensionale po aq të nevojshme. Nëse kjo e fundit e aprovon rritjen e moshës së daljes në pension, atëherë implementimi duhet vijuar në dy mënyra, edhe atë: përmes zgjerimit gradual të kufirit të moshës së daljes në pension, përkatësisht indeksimin e moshës me muaj të caktuar për çdo vit; dhe rritjes së kufirit të moshës së daljes në pension përshtatur me jetëgjatësinë, pra në çdo 5-6 vite të rritet kufiri i pensionimit për një vit dhe kështu të arrihet pragu 70 vjeç deri në vitin 2030.

- Përqendrimi në zbatimin e strategjisë për zhvillimin demografik 2008-2015 të Ministrisë për punë dhe politikë sociale, përmes përmirësimit të kapitalit njerëzor, zvogëlimit të pabarazive rajonale demografike dhe rritjes së kohezionit social. Për më tepër, zbatimi i strategjisë në fjalë do të mundësojë rritjen graduale të natalitetit, respektivisht rritjen e forcës punëtore dhe gjenerimin më të madh të të hyrave nga kontributet për sigurim pensional dhe invalidor, e me këtë përmbushjen e objektivit kryesor të sistemit pensional - pagesën e pensioneve.
- Lidhjes më të mirë midis kontributeve dhe pensioneve .
- Përmirësimi i metodave për të evidentuar, kontrolluar dhe dënuar rastet e moszbatimit ligjor .
- Sistemi pensional në Maqedoni në aspektin fiskal dhe afatmesëm është i paqëndrueshëm – ka konkluduar Banka Botërore në raportin e fundit. Më tej thuhet se edhe pse Maqedonia ka bërë masa të shëndosha reformuesere në vitet e fundit, prej të cilëve disa janë vlerësuar si mjaft të suksesshme, siç është eliminimi i shkallës së ulët të pensionimit dhe vendosjen e kufizimeve të moshës tek pensioni i përgjithshëm invalidor, megjithatë, sistemi pensional në Maqedoni ka pak gjasa të ballafaqohet me problem e popullatës që po plakët në mënyrë të shpejtuar.

Bibliografia

- Abel, A. dhe B.D. Bernheim (1991): Fiscal policy with impure intergenerational altruism. *Econometrica* **59**, 1687-1711.
- Dervishi-Agjensioni për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional Republika e Maqedonisë-**Shkup, Prill 2017.fq.8**
- Dr. Slawomir Solarz-Fushata e ndërgjegjësimit të publikut si një element i reformës së Pensioneve. **Tiranë, 9 Shkurt, 2009**
- ILO (2013), Strategjia e Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Sigurime Shoqëror për të gjithë: të ndërtojme nivele minimale të mbrojtjes shoqërore dhe sisteme të plotë të sigurimeve shoqërore: permbledhja e sintezes / Zyra Nënrajonale e ONP për Evropën Qendrore dhe Lindore. – Budapest: ILO, **2013**
- Merita(Vaso)Xhumari Procesi dhe institucionet e Politikës Sociale Tiranë, Dhjetor **2014**
- Ministria për punë dhe politikë sociale e Republikës së Maqedonisë. (2008). Strategjia për zhvillimin mografik të RM-së, **2008 - 2015**.
- M. Valon Murati , Qerkin Berisha -SKEMAT SOCIALE DHE PËRSHTATSHMËRIA E TYRE ME REALITETIN KOSOVAR-Prishtinë, **2010,fq.10**
- N. Dajmond, P . “ Reformat e Pensionit “ **Shkup, 2013**
- Selatin Klllokoqi- Pensionet në Kosovë – Sifidat dhe mundësitë, Prishtinë 2018.fq.5
- Schmähl, W. Fundamental Decisions for the reform of pension systems. *International Social Security Review*, **1999, Vol. 52, No. 3, pp. 45–55**.
- Svetllana Trbojeviq, Instituti për punë sociale dhe politikë sociale -Decentralizimi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë – Gjendja faktike, sfidat dhe mundësitë në nivel lokal-**Shkup 2012**
- Vjollca-Sulejmani-Asani –Teformat e pensionit në RM-së **Tiranë 2018**

TEKSTET LIGJORE

- Ligji për sigurim pensional dhe invalidor („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.98/2012)
- Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.15/2013)
- Ligji për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.142/2008)
- **Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr. 20/2015)**
- Ligji për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë . (n.d.). Republika e Maqedonisë.
- Ligji Nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar)
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e Veriut <https://sobranie.mk/>

BURIMET NGA INTERNETI

- Ministria e punës, familjes, çështjeve sociale dhe mundësive të barabarta. (n.d.). Retrieved from <http://www.mddsz.gov.si>. **22.10.2020**
- N.d.). RetrieveKB Shoqëria e parë pensionale SHA Shkup: <https://www.kkbprvo.com.mk/> **22.09.2020**
- Kb fodi i parë i hapur dhe i detyrueshëm pensional-Shkup <https://www.kbprvo.com.mk/> **15.09.2020**
- Shqipëria rishikimi i Sistemit të Sigurimeve Shoqërore <http://documents1.worldbank.org>
- DOKUMENTI I POLITIKAVE TË PENSIONEVE- Prill **11, 2014,fq.5.** <https://shtetiweb.org/wp-content/>
- MTSPShkup, shtator viti 2008 <http://www.mtsp.gov.mk>

- Strategjia për zhvillimin demografik të Republikës së Maqedonisë, **2008 - 2015**. Ministria për punë dhe politika sociale. <http://www.mtsp.gov.mk/>.
- Ministria e Punës, familjes, çështjeve sociale dhe mundësive të barabarta. (n.d.). Retrieved from <http://www.mdds.gov.si>. **17.09.2020**